



Republika e Kosovës
Republika Kosovo - Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština - Assembly

T R A N S K R I P T

**I MBLEDHJES PLENARE TË KUVENDIT TË REPUBLIKËS SË KOSOVËS,
E MBAJTUR MË 9 QERSHOR 2016**

**SA PLENARNE SEDNICE SKUPŠTINE REPUBLIKE KOSOVA,
ODRŽANE 09. JUNA 2016. GODINE**

**QERSHOR - JUN
2016**

Rendi i ditës

1. Koha për deklarime jashtë rendit të ditës,
2. Koha për pyetje parlamentare,
3. Miratimi i procesverbalit nga seanca e mëparshme,
4. Shqyrtimi i Projektligjit nr. 05/L-093 për ratifikimin e Konventës për heqjen e kërkesës për legalizim të dokumenteve zyrtare të huaja (5 tetor 1961),
5. Shqyrtimi i Projektligjit nr. 05/L-097 për ratifikimin e Marrëveshjes për hua ndërmjet Republikës së Kosovës dhe Bankës Evropiane për Rindërtim dhe Zhvillim për rehabilitimin e rrugëve rajonale,
6. Shqyrtimi i Projektligjit nr. 05/L-098 për ratifikimin e Marrëveshjes financiare ndërmjet Qeverisë së Republikës së Kosovës dhe Bankës Evropiane për Investime për projektin e rehabilitimit të linjës hekurudhore 10,
7. Shqyrtimi i dytë i Projektligjit nr. 05/L-010 për Agjencinë Kosovare për Krahësim dhe Verifikim të Pronës,
8. Shqyrtimi i dytë i Projektligjit nr. 05/L-083 për falimentimin,
9. Shqyrtimi i dytë i Projektligjit nr. 05/L-079 për investimet strategjike në Republikën e Kosovës,
10. Zgjedhja e tre (3) anëtarëve të Bordit për Ankesa të Medieve,
11. Shqyrtimi i Propozim-vendimit të Qeverisë së Republikës së Kosovës për emërimin e anëtarëve të Komisionit për Mbrojtjen e Konkurrencës,
12. Shqyrtimi i Propozim-vendimit për caktimin e pagës së Auditorit të Përgjithshëm të Republikës së Kosovës,
13. Shqyrtimi i raportit të punës së Agjencisë Kosovare të Privatizimit për vitin 2015,
14. Shqyrtimi i raportit të punës së Zyrës Rregullatore për Ujësjellës dhe Kanalizim për vitin 2015,
15. Propozimi i GP të Listës serbe për zëvendësimin e anëtarit në Komisionin për Mbikëqyrjen e Agjencisë së Kosovës për Inteligjencë.

Dnevni red

1. Vreme za deklarisanja van dnevnog reda,
2. Vreme za parlamentarna pitanja,
3. Usvajanje zapisnika sa prethodne sednice,
4. Razmatranje Nacrta zakona br. 05/L-093 o ratifikaciji konvencije za povlačenje zahteva za legalizaciju stranih zvaničnih dokumenata, (5. oktobar 1961),
5. Razmatranje Nacrta zakona br. 05/L-097 o ratifikaciji sporazuma o zajmu između Republike Kosova i Evropske banke za obnovu i razvoj, za rehabilitaciju regionalnih puteva,
6. Razmatranje Nacrta zakona br. 05/L-098 o ratifikaciji Finansijskog sporazuma između Republike Kosova i Evropske banke za investicije za projekat Rehabilitacija železničkog pravca 10,
7. Drugo razmatranje Nacrta zakona br. 05/L-010 o kosovskoj Agenciji za upoređivanje i verifikaciju imovine,
8. Drugo razmatranje Nacrta zakona br. 05/L-083 o falimentaciji,
9. Drugo razmatranje Nacrta zakona br. 05/L-079 o strateškim investicijama u Republici Kosovu,
10. Izbor tri (3) članova Borda za žalbe medija,
11. Razmatranje Predloga - odluke Vlade Republike Kosova za imenovanje članova Komisije za zaštitu konkurencije,
12. Razmatranje Predloga odluke za određivanje plate za Generalnog revizora Republike Kosova,
13. Razmatranje Izveštaja rada Kosovske agencije za privatizaciju za 2015. god.,
14. Razmatranje Izveštaja rada Kancelarije regulatora za vodovod i kanalizaciju za 2015. god,
15. Predlog PG Lista srpska za zamenu člana u Komisiji za nadzor Kosovske agencije za inteligenciju.

Mbledhjen e drejtoi nënkryetari i Kuvendit, z.Xhavit Haliti.

KRYESUESI: Të nderuara zonja deputete,

Zotërinj deputetë,

Të nderuar përfaqësues të Qeverisë,

I hap punimet e seancës plenare të Kuvendit të Republikës së Kosovës sipas rendit të ditës të përgatitur nga Kryesia e Kuvendit në marrëveshje me kryetarët e grupeve parlamentare.

Fillojmë me pikën e parë të rendit të ditës:

1. Koha për deklarime jashtë rendit të ditës

I dini rregullat. A është dikush në emër të Grupit Parlamentar të PDK-së, sepse jeni paraqitur shumë. Në qoftë se jo, do t'ua jap me radhë, nuk ka në emër të grupit.

Atëherë, fjalën e ka zonja Demi.

LABINOTË DEMI-MURTEZI: Faleminderit për fjalën, kryesues!

Më lejoni që në fillim të përgëzoj gjithë besimtarët e Kosovës, besimtarët myslimanë për muajin e shenjtë të Ramazanit.

Javën e kaluar, Ministria e Punëve të Jashtme organizoi për të pestën herë me radhë konferencën ndërkombëtare ndërfetare “Interfaith Kosova”.

Pjesëmarrës të shumtë nga vendet e ndryshme shpalosën përvojat e tyre për mënyrën e jetesës në harmoni të plotë ndërfetare.

Për çdo pjesëmarrës kosovarë këto paraqitje përngjanin me përditshmërinë tonë, ngase secili nga ne në një formë ose tjetër i ka shërbyer tolerancës fetare dhe e ka jetësuar atë.

Kjo tolerancë, ose më mirë të themi bashkëjetesë jona ndërfetare, ka traditë të gjatë dhe bazë të shëndoshë.

Komunitetet fetare asnjëherë nuk kanë qenë shkaktarë të problemeve as fqinjësore, e as tendencioze publike.

Klerikët fetarë dhe qytetarët tanë janë gjithmonë bashkë me kremtet e njëri-tjetrit, në mbështetjen dhe fuqizimin e politikave dobiprurëse për kultivimin e vazhdueshëm të kësaj harmonie ndërfetare, por mbi të gjitha, janë gjithmonë prezentë në aktivitetet humane solidarizuese për nevojat dhe të mirat e qytetarëve.

Edhe prijësit e institucioneve tona me të drejtë mburren me tolerancën fetare në vend dhe besimtarët e të gjitha besimeve në Kosovës kanë konsideratë për të mirën e përgjithshme dhe imazhin e mirë të vendit.

Kur flasim për tolerancën fetare, ndërfetare dhe ndëretnike, kjo është meritë e plotë e qytetarëve të të gjitha besimeve, një shembull ideal për punë dhe bashkëpunim edhe te klasa jonë politike. Kjo dëshmon pjekurinë, kulturën dhe qytetarinë tonë karshi situatave të rënda dhe tendencioze.

Vendi ynë është shtet i ri dhe ende shumë i brishtë për t'u trajtuar me standarde të dyfishta, varësisht nga momenti i caktuar.

Mosha jonë e re dhe transicioni pas luftës nuk ka penguar që t'i bashkëngjitemi vendeve të tjera në luftë kundër terrorizmit global, i cili terror në vazhdimësi u mveshet myslimanëve.

Në gjithë këtë padrejtësi që po bëhet myslimanët e Kosovës asnjëherë nuk u dekurajuan për të vazhduar devotshmërinë e tyre dhe përkushtimin e madh të ruajtjes së traditës sonë kombëtare e fetare, duke qenë shembull individual e kolektiv të vlerave të mirëfillta kulturore integruese evropiane, mbi të gjitha paqedashës.

Në vazhdimësi përkushtimi ynë si qytetarë të të gjitha besimeve dhe dëshira jonë e madhe është zbatimi i ligjeve të vendit në fuqi si dhe respektimi i plotë i të drejtave dhe e lirive të njeriut. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Fjalën e ka zonja Gaxherri.

BESA GAXHERRI: Faleminderit, kryesues!

Kolegë deputetë, ministra,

Para se të ngre çështjen në lidhje me shëndetësinë në Kosovë, dua të tërheq vëmendjen e kryetarit të Kuvendit dhe Kryesisë së Kuvendit që seancat duhet të mbahen me rregull, të mos lejojnë të grumbullohet rendi i ditës në këtë formë, siç është sot dhe seancën e kaluar, por vërtet të respektohet Rregullorja dhe të kemi seanca të rregullta.

Sot do të ngre çështjen e problematikave të shumta në shëndetësi. Të gjithë e dimë që vërtet shëndetësia në Kosovë nuk funksionon ashtu si duhet, kemi probleme të të gjitha llojeve, shpeshherë mbulohen problemet me mungesë të buxhetit, por skandalet të cilat janë ditët e fundit janë krejtësisht të paarsyeshme dhe të patolerueshme.

Ditë më parë dëgjuam nga mediat skandalin e lëshimit të certifikatave të shëndetësisë, edhe kjo ishte për një ambulancë, për një mjek në Gjilan, por ju lutem, ne e dimë që këto gjëra ndodhin në të gjitha qytetet e Kosovës, pra në tërë Kosovën.

Skandali tjetër që pashë prapë dje në media është në spitalin e Gjakovës.

Dje lexova që në spitalin e Gjakovës operohet pacientja në këmbën e djathtë, në vend të këmbës së majtë. Sqarimi nga doktorët e këtij operacioni ishte se u ngatërrua këmba e pacientes, normalisht një arsyetim tepër banal, më banal i mundshëm që kemi dëgjuar ndonjëherë.

Unë kam qenë, thotë doktori, në anën e djathtë të shtratit dhe pacientja është ankuar se ka dhimbje në anën e djathtë.

Çka është më shqetësuese, ata pas operacionit nuk e kanë marrë veshë fare se kanë gabuar e kanë ndërhyrë në këmbën e shëndoshë, derisa djali i pacientes iu ka treguar se ndërhyrja ose operacioni është bërë në këmbën e gabuar. Shtrohet pyetja, çka kanë bërë këta mjekë në këmbën e djathtë, në këmbën e shëndoshë. E kanë dëmtuar edhe atë dhe cilat janë masat që janë marrë për këta mjekë.

Lexova që masat janë 6 muaj heqje të licencës për katër mjekë, 3 muaj nga bordi i etikës së Ministrisë së Shëndetësisë dhe 3 muaj nga Komisioni etik i spitalit të Gjakovës.

Unë sot bëj pyetje, përveç apelit që vërtet ne kemi përgjegjësi nga votuesit që të merremi seriozisht me punë, edhe me gjëra të tilla. Por, unë e shtroj pyetjen çka duhet bërë më shumë një mjek që vërtet t'i pezullohet licenca tërësisht.

Andaj, me këtë rast ftoj edhe Komisionin Parlamentar për Shëndetësi, ministrin dhe të gjithë mekanizmat e shëndetësisë që vërtet të përkushtohemi me seriozitet edhe të përmirësojmë këtë sektor kaq të ndjeshëm, të nevojshëm për qytetarët e vendit. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Në emër të Grupit Parlamentar të “Vetëvendosjes”, zoti Visar Ymeri e ka fjalën.

VISAR YMERI: Faleminderit!

Qytetarë të Republikës së Kosovës,

Tash e sa kohë ne të gjithë po përballemi me dy lloj uzurpimesh të territorit, të tokës e të pronës në Kosovë.

Në njërën anë, ky regjim i koncesionarëve që i krijojnë Zajednicë Serbisë, i fal toka Malit të Zi, ndërsa në anën tjetër, pjesën e mbetur e ndajnë mes vete.

Kjo është e vërteta e këtij vendi, vendi i cili do të duhej të ishte Republikë e qytetarëve, por u shndërrua në plaçkë të pushtetarëve.

Tash e 17 vjet pas filluan aksionet e policisë. Kemi parë këto ditë, këto javë e këto muaj një sërë arrestimesh, bastisjesh e çlirimesh të pronave të uzurpuara, e tjera.

Këto prona të uzurpuara, të stërshitur, natyrisht që janë hajni e kulluar e pasurisë së popullit të Kosovës.

Opinionin publik u detyrua të përqendrohet te dy emra të përveçëm: Në njërën anë Azem Syla, në anë tjetër Bedri Selmani.

Kështu po mëtohet të krijohet përshtypja se lufta kundër krimit e korrupsionit paska filluar të marrë hov.

Çlirimi i pronave të uzurpuara e arrestimi i uzurpatorëve natyrisht që është i domosdoshëm.

Por, të mos mendojmë se ky është luftim i krimit. Kjo fushatë më shumë i ngjanë shpëlarjes së kryekriminelit.

Krimi e korrupsioni luftohet nga koka, e jo nga bishti. E kokën e tij e kemi në krye të Kuvendit. Kadri Veseli po sillet sikur ky e inicioi këtë luftë kundër krimit e korrupsionit. Sikur ky e nxiti çlirimin e pronave të uzurpuara.

Pra, po do të paraqitet sikur ky po e shpëton Kosovën. Çfarë ironie!

Koka e SHIK-ut që e ka zaptuar, uzurpuar, e kapur Republikën e Kosovës, tash po paraqitet sikur shpëtimtari i saj.

Nuk ka rrezik më të madh për një vend se sa instalimi i kreut të nëntokës në krye të shtetit. Dhe, aq më e rrezikshme bëhet kur po ky ka bashkëpunëtorë të shumtë gjithandej nëpër institucione, sikur për shembull, në Qeveri.

Tash e 1 vit e gjysmë të kësaj qeverie krejt çfarë kemi parë është intensifikimi i kapjes së shtetit nga Isa Mustafa, po ashtu me shokë.

Bashkëpunimin në uzurpim që kishte ndodhur në terren tash e shumë kohë e kanë instaluar edhe në Qeveri dhe, a është e çudit kjo? Mua nuk më çudit aspak, sepse e vërteta e plotë e Kosovës së pasluftës është fakt e vërteta e Fondit të 3% dhe e fondit “Vendlindja Thërret”.

Vjedhja e këtyre fondeve nga Isa me shokë e Kadriu, po ashtu me shokë, e kanë pamundësuar edhe demokracinë, edhe zhvillimin, edhe tregun në Kosovë.

Kjo klikë kriminelësh duhet luftuar e duhet ndalur. Këtë do ta bëjmë këtu në Kuvend, jashtë tij, bashkë me juve qytetarët, çdo kund dhe në çdo kohë.

Pra, edhe një herë po e përsëris, kriminelët nuk do të fitojnë. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Fjalën e ka zoti Nenad Rashedi, në emër të grupit.

NENAD RAŠIĆ: Hvala puno, predsjedavajući!

Na ime radi se o, na žalost mi nemamo toliko često sednice u zadnje vreme pa delovaće kao da sam odavno već pričao o tome, ali u stvari na zadnji sednici sam pričao takozvanom uputstvu 7/2016 administrativno uputstvo koje je usvojen od strane Ministarstva za rad i socijalno staranja, a radi se o proširivanju kriterijuma za dobijanje bazične penzije, i ja sam tad rekao da je to uputstvo apsolutno protiv zakonito, i pozvao sam i premijera, i ministra finansije, koje vidim da je tu i ministar za rad, a to protiv zakonito uputstvo povuku.

I to na žalost se nije desilo, i ja još jednom ću da potenciram da objasnim šta kaže zakon.

U zakonu ima dva osnovna i najbitnija kriterijuma kako se dobija takozvana osnovna penzija. A to je da imate ličnu kartu Kosova i da imate državljanstvo. 65 godina starosti je naravno preduslov da bi došlo do toga, prema tome to su dva osnovni kriterijumi.

Ne trebate ništa više osim tih kriterijumi da ispuni. Što je najbitnije, u zakonu se ne kaže, recimo ukoliko postajao deo u kome kaže, dodate kriterijumi će biti regulisani administrativnom uputstvom koji izdao Ministarstvo za rad, onda tako nešto bi možda ne bi bilo osnovano, ali možda bi moglo da ima neko opravdanost. Ovako, osim tih kriterijumima, ništa drugo nije potencirano i naglašeno da treba ostoјati da bi dobili osnovnu bazičnu penziju.

E šta se sad dešava? To administrativno uputstvo se implementira, i to na jedan vrlo agresivan način, i to na terenu izgleda mnogo gore nego što je na papiru. Na terenu predstavnici Departmana za penzije idu od kancelarije do kancelarije, i kažu čak svojim službenicima. Nijedan drugi dokument, osim plaćenog poreza, nemojte priznati, i kad god onih pitaju; jer možemo dobiti Odluku napismeno, ne, ne, ne, ne možete, ali nijedan drugi dokument, osim plaćenog poreza, nemožete priznati.

Šta nam je raditi, rekao da prošli put stvarno sa dobrim iskrenim namenama hteo da sprečimo dalju eskalaciju i dalju diskriminaciju, na žalost u međuvremenu, nije se ništa desilo, čak se pogoršalo.

Pošto je ovo naglašavam opet protivzakoniti akt, koju svakom slučaju podriva ustavna prava svakog građanina, a u ovom slučaju građana koji su obuhvaćenim tim zakonom, ili građani koji imaju prava da aplikaciju za bazične penzije, mi nemamo drugo rešenja osim da us podršku mojih kolega se 10 poslanika potpisnika, kako i sam na zakon nalaže da podnesem žalbu Ustavnom Sudu, koji će ne sumnjam, u ovom slučaju proveriti ustavnost, ili što bi rekao, neustavnost ovog dela, i samim tim vratimo na početnu fazu.

Još jednom molim, pošto ministar financije tu, da još nije kasno, još možemo ispraviti nepravdu, ovo što je uradili mislim da je bila tehnički greška, koji verovatno posledica niste bili svesniji, niste dobro prostudirali zakon, i da opet ljude naše, odnosno penzioneri is poštujemo da ne dođe do dalje eskalacija.

Još jednom vam ponavljam, u Zakonu o penzijama jasno stoji koji su kriterijumi da bi dobili osnovnu penziju.

Administrativno uputstvo nikad ne može dopuniti zakon, a Ustavni sud po na čelu ima obavezu da poverava zakonske i podzakonske akte, da li su u skladu za Ustavom, odnosno sa pravima koje sam Ustav daje bilo kojem grupacije građana.

Još jednom molim, pošto je ministar Financije tu, da još nije kasno, još možemo ispraviti nepravdu. Ovo što ste uradili mislim da je bila jedna tehnička greška o kojoj oko verovatnih posledica niste bili svesni, niste dobro postudirali zakon, i da opet naše ljude, odnosno penzionere ispoštujemo, da ne dođe do dalje eskalacije.

Još jednom vam ponavljam, u zakonu o penzijama jasno stoji koji su kriterijumi da bi dobili osnovnu penziju - Administrativno uputstvo nikad ne može dopuniti zakon. A Ustavni sud, po načelu ima obavezu da proverava zakonske i podzakonske akte dali su u skladu sa Ustavom, odnosno sa pravima koje sam Ustav daje bilo kojoj grupaciji građana, a u ovom slučaju naravno i našim najstarijim penzionerima. Hvala!

KRYESUESI: Faleminderit! Zonja Blerta Deliu e ka fjalën.

BLERTA DELIU-KODRA: Faleminderit, zoti Haliti!

Të nderuara kolege dhe kolegë deputetë,

I nderuar Kabinet qeveritar,

Të nderuar qytetarë të Republikës së Kosovës,

Përfaqësues të medieve,

Para disa ditësh, familjarët e të të vrarëve të fshatit Rezallë e kanë dorëzuar në Prokurorinë Speciale një kallëzim penal kundër ushtrisë dhe policisë serbe. Po ashtu, është ngrehur edhe padi individuale dhe direkte ndaj dy gjeneralëve serbë të ushtrisë, Lubisha Diković dhe Dejan Rangjelović. Në mesin e dëshmitarëve, të cilët i kanë dorëzuar edhe dëshmitë e tyre, janë edhe dy dëshmitarë okularë, të dy të mbijetuar të masakrës së Rezallës, të cilët kanë ofruar dëshmi që flasin për krimin që është kryer në atë kohë në atë fshat.

Ajo e cila duhet edhe sot në këtë seancë të theksohet është se informatat të cilat përmenden në kallëzimin penal janë po ashtu, të paraqitura edhe nga Fondi për të Drejtën Humanitare në Beograd.

Të nderuar kolege dhe kolegë deputetë,

Ndonëse Kosova është vonuar në padi karshi shtetit serb, mendoj se nisma si kjo janë të mirëseardhura nëpërmjet së cilave qytetarët e Kosovës me mjete ligjore kërkojnë përgjegjësi individuale karshi krimeve të kryera nga serbët në Kosovë. Si deputete e përkrah këtë nismë të bashkëfshatarëve të mi të fshatit Rezallë dhe po ashtu inkurajoj që edhe qytetarët tjerë, të cilët kanë dëshmi dhe fakte të argumentuara t'i dorëzojnë ato në Prokurori dhe në institucionet e drejtësisë, deri në kohën kur drejtësia do të vihet në vend.

Institucionet e drejtësisë dhe EULEX-i duhet që të tregohen të përgjegjshme dhe efikase në trajtimin e rasteve të tilla, në ngritjen e përgjegjësisë, në ngritjen e kallëzimeve penale, në dënimin e krimit dhe gjenocidit serb në masakra, e këtu dua të përmend edhe masakrën e Burgut të Dubravës për të cilën për 10 vjet me radhë janë deponuar dhe janë ngritur kallëzime penale, por që fatkeqësisht nuk ka pasur asnjë rezultat. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Zoti Armend Zemaj e ka fjalën.

ARMEND ZEMAJ: Faleminderit, zoti nënkryetar!

Të nderuar kolegë deputetë,

Kabinet qeveritar,

Të pranishëm,

Unë dola ta shpreh një shqetësim, i cili është edhe shqetësim ligjor, sa i përket vendimit të Gjykatës Kushtetuese për dhënien e pëlqimit të vendimit nga Dhoma e Posaçme rreth pronave që kanë të bëjnë në dy ndërmarrjet shoqërore “Apiko” dhe “Iliria” në aspektin pronësor të saj.

Një çështje e cila është debatuar edhe në Kuvendin e Republikës së Kosovës, e cila nuk e ka pas vëmendjen qoftë të të gjithë deputetëve, qoftë të të gjitha grupeve politike, edhe sot e kësaj dite është treguar që institucionet qendrore dhe lokale nuk kanë qenë të vëmendshme sa u përket këtyre problematikave. Andaj, qytetarët e Deçanit, jo vetëm ata që e kanë të drejtën pronësore e

historike, por edhe të tjerët në plotësi e kanë parë këtë pjesë të Deçanit si e vetmja arterie për zhvillim ekonomik dhe të krijimit të kushteve më të mira për jetesë të banorëve të asaj pjese.

Ne mendojmë, pa marrë parasysh se është krijuar një kulturë, qoftë legale, qoftë edhe politike, që të mos interpretojmë dhe të mos i kontestojmë vendimet e Gjykatës Kushtetuese, por është shumë e padrejtë mënyra se si ka ardhur deri te ky vendim i tillë. E para, asnjëherë nuk është dhënë, nuk është dëshmuar verifikimi i së drejtës pronësore mbi të gjitha kur kemi të bëjmë me një marrëveshje, apo me një kontratë, e cila është arritur në vitin 1997 ndërmjet Manastirit dhe Kuvendit të Republikës së Serbisë të asaj kohe, si kuvend i regjimit të Slobodan Milosheviqit.

Unë besoj që kjo çështje duhet të jetë edhe temë, sepse do të ketë edhe raste të tjera në Kosovë edhe është një precedent i keq që vendimet e asaj kohe sot vërtetohen qoftë nga Dhoma e Posaçme e Gjykatës Supreme, qoftë edhe nga Gjykata Kushtetuese e Republikës së Kosovës.

Besoj që kjo duhet të debatohet, duhet të rishikohet në formën e mundshme, sepse besoj atë që e shprehin qytetarët, atë që e shprehin institucionet lokale dhe ajo që është parë nuk mund të implementohet dhe nuk mund të zbatohet në praktikë. Kjo do t'u bëjë dëm interesave të përgjithshme të Kosovës, interesave të përgjithshme të qytetarëve të Deçanit dhe, mbi të gjitha, do ta prishë edhe harmoninë e krijuar, qoftë atë historike ndërmjet Manastirit dhe banorëve shqiptarë të Deçanit, duke mos e kontestuar asnjëherë raportin e mirë ndërmjet tyre.

Ky shqetësim është dashur që të jetë shumë serioz. E kemi parë edhe në legjislaturën e kaluar kur është debatuar që Kuvendi i ka ikur kësaj...

(Ndërprerje nga regjia)

KRYESUESI: Faleminderit! Fjalën e ka zonja Kadaj-Bujupi.

DONIKA KADAJ-BUJUPI: Faleminderit!

Të nderuar kolegë deputetë,

Kur e filluam legjislaturën e vitit 2007, më kujtohet që qytetarëve të Republikës së Kosovës dhe nga kjo foltore, po ashtu, ishte thënë që Kosova do të bëhej “Luginë e silikonit”, që për 100 ditët e para të pavarësisë do t'i kemi 100 njohje, që për një kohë shumë të shkurtër do të jemi anëtar në OKB.

Për të vazhduar me premtimin famoz për vizat të presidentit të gazit në vitin 2010, që Kosova do të ketë liberalizim të vizave brenda 18 muajsh. Rrjedhimisht, po i bie që kjo do të duhej të kishte përfunduar në vitin 2018. Për të vazhduar me 200 mijë dhe 150 mijë vende pune dhe po ashtu me ushtrinë dhe anëtarësimin në NATO. Sot, 17 vjet pas mbarimit të luftës, pas 8 vjetëve të pavarësisë, Kosova jo që nuk arriti të anëtarësohet në OKB, mirëpo ç'është më e keqja dhe sot e kësaj dite Kosova me këtë regjim në krye nuk po arrin ta shtrijë sovranitetin e shtetit dhe sundimin e ligjit as deri në Mitrovicë.

Kombinati më i madh metalurgjik “Trepça” nuk ka status të qartë dhe një pjesë dirigjohet nga Beogradi. Gjithashtu, qytetet veriore janë ende jashtë legjislacionit të shtetit tonë. Nga të gjitha këto premtime përgjatë viteve, ky koalicion i nisur në vitin 2007, i shkëputur për pak, sa për ta

mashtuar një pjesë të elektoratit të LDK-së dhe i ribërë përsëri, ka mbajtur vetëm një premtim: negociatat me Serbinë, të cilat fillimisht i deklaroi si bisedime teknike, e të cilat çdo herë në fakt ishin politike dhe të cilat e rrezikuan sovranitetin e vendit, duke i marrë gradualisht shumë të drejta që madje edhe në kohën e UNMIK-ut i kishim.

Vit pas viti tkurrej territori e pakësohej sovraniteti dhe shkuan deri aty sa deshën ta pranojnë një shtet të ri brenda shtetit, ta krijojnë një Bosnjë të re, ku do të bllokohej çdo progres dhe ku prosperiteti i vendit do të mbetej dëshirë. Përgjatë kësaj kohe, deputetët dhe qytetarët bashkë rezistuan dhe i ndalën këto dy marrëveshje. Ndërsa, ky regjim vazhdoi të ushtrojë dhunë ndaj të njëjtëve për t'i ringjallur. Mirëpo, asnjëherë nuk foli për marrëveshjen e tretë, së cilës i ka ardhur koha që të zbatohet tani në qershor të vitit 2016. Ajo është marrëveshja, apo çlirimi i një simboli të vuajtjes së shumë njerëzve - Urës së Ibrit - e cila e ndau Mitrovicën dhe e cila me marrëveshjen e 26 gushtit do të duhej që të lirohej tani gjatë këtij muaji.

Sot kur ka ardhur koha të zbatohet ky obligim, ministria...

(Ndërprerje nga regjia)

KRYESUESI: Faleminderit! Fjalën e ka zoti Zenun Pajaziti. Jo, e ke kryer! Të lutem, largohu nga foltorja! Nuk ke të drejtë ta thyesh Rregulloren! Shko në vend ulu, të lutem! Dhe, mësohuni që ta zbatoni Rregulloren të gjithë njësoj! Unë edhe LDK-së nuk ia dhashë fjalën, e as të PDK-së.

S'kam si të të dënoj tash, se s'ka dënim për shkelje të Rregullores.

Fjalën e ka Zenun Pajaziti.

ZENUN PAJAZITI: Faleminderit, kryesues!

Të nderuar kolegë deputetë,

Ministra,

Dëshiroj që për pak ta shtroj një çështje që mund të jetë pak e vonuar. Para pak kohësh ju e dini janë mbajtur zgjedhjet lokale edhe në Preshevë e Bujanoc.

Dëshiroj ta shfrytëzoj rastin si pjesë e këtij Kuvendi që t'u uroj dy kryetarëve të komunave, zotit Shqipërim Arifi, kryetar i Preshevës, dhe zotit Shaip Kamberi, kryetar i Bujanocit, detyrën e tyre të re. Dëshiroj t'i ftoj të gjithë kryetarët e komunave që të bashkëpunojnë sa më shumë dhe sidomos kryetarët e komunave të pjesës lindore që të vazhdojmë bashkëpunimin e shkëlqyer. Siç e dini, drejtuesit e këtyre komunave disa herë në mënyrë të përsëritur kanë adresuar vështirësi të mëdha të funksionimit të tyre dhe mbështetje shumë të limituar ose fare të paktë nga Beogradi. Unë kërkoj po ashtu dhe nga institucionet qendrore të Republikës së Kosovës, nga ministritë e ndryshme përkatëse, pushteti lokal dhe ministritë e tjera që t'u ofrojnë bashkëpunimin e duhur këtyre komunave, zyrtarëve të zgjedhur atje, përfaqësuesve të zgjedhur atje, në mënyrë që vështirësitë e tyre t'i zvogëlojnë në masën sa më të madhe të mundur.

Po ashtu, kërkoj që çështjet që janë të ngritura për sa u përket çështjeve të arsimit dhe bashkëpunimit ndërkufitar të tejkalohen dhe po ashtu i ftoj edhe institucionet e BE-së që ta

shtojnë mbështetjen në këtë drejtim, në mënyrë që qytetarët të lëvizin lirshëm dhe të mos kenë pengesa edhe në kufi, por po ashtu edhe në çështjet tjera që i lidhin me komunat e Kosovës. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Zoti Veton Berisha e ka fjalën.

VETON BERISHA: Faleminderit, kryesues!

Të nderuar kolegë deputetë,

Të nderuar ministra,

Qytetarë të Republikës së Kosovës,

Po ashtu më lejoni që edhe unë të uroj gjithë pjesëtarët e besimit Islam për muajin e shenjtë të Ramazanit!

Çështja e dytë që ndiej dhe obligim moral që ta përshëndes një vendim të nxjerrë, ose një udhëzim të nxjerrë nga Ministria e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë, i cili ka të bëjë me përfshirjen e komuniteteve joshumicë në universitetet publike dhe ky vendim është njëri nga vendimet më të rëndësishme për përfshirjen e komunitetit egjiptian dhe ashkali në sistemin arsimor publik dhe mendoj që është rasti më i mirë që komuniteti ynë ta shfrytëzojë këtë mundësi.

Në anën tjetër, e përshëndes ministrin për këtë iniciativë, i cili vërtet me këtë vendim po i pamundëson shqetësimet dhe çështjet që kishim ne viteve të kaluara dhe, në anën tjetër, kërkoj mirëkuptim dhe kërkoj që ministria ta mbikëqyrë gjithë këtë proces për shkak se po ashtu në bazë të këtij udhëzimi ekzistojnë mundësitë e keqpërdorimit të këtyre të mirave, të cilat na u kanë sjellë, e, në anën tjetër, i ftoj të gjithë ata kandidatë të cilët i takojnë këtyre komuniteteve që t'i shfrytëzojnë këto mundësi, ndërsa në anën tjetër u bëj thirrje të gjithë atyre kandidatëve të cilët nuk u takojnë këtyre komuniteteve që të mos provojnë, sepse vërtet në bazë të këtij udhëzimi ata do të sanksionohen penalisht dhe mendoj që është rasti i fundit që ne ta eliminojmë këtë dukuri.

Dhe, e përshëndes Ambasadën amerikane, OSBE-në dhe Zyrën e Bashkimit Evropian, që vërtet e kanë dhënë një kontribut dhe uroj e lutem që ky udhëzim administrativ të përfillet dhe të jetë në vijë të plotë me interesat e komuniteteve tona.

Çështja tjetër është po ashtu shqetësuese për komunitetin tonë, meqenëse e kemi ministrin e Punëve të Brendshme këtu të pranishëm, ekziston një shqetësim jashtëzakonisht i madh për mospërfshirje të komuniteteve egjiptian dhe ashkali në Policinë e Kosovës. Numri është jashtëzakonisht i ulët dhe çuditërisht thuhet që nuk ka të përgatitur, ndërsa, në anën tjetër, ne kemi shifra, të cilat tregojnë që janë vendosur në pritje rreth 20 pjesëtarë të këtyre komuniteteve.

E mendoj që derisa ata kanë arritur të jenë në pritje, atëherë do ta kishin mundësinë që të jenë pjesë e sistemit të Policisë në Kosovë dhe do të duhej veprim proaktiv që edhe ne të ndihemi barabartë në sistemin e Policisë, sepse besoj që tanimë është një besim i plotë që ne ta ofrojmë këtë shërbim dhe të kemi mundësi të jemi pjesë, e aq më tepër në ato komuna dhe në ato territore ku ne jemi shumicë dhe besimi sigurisht se do të ishte më i madh te qytetarët tanë. E ftoj

ministrin që ta shikojë këtë proces dhe të ndërmarrë veprime të ngjashme, siç merren për komunitetet tjera, që edhe komunitetet tona të jenë të përfaqësuara.

Në anën tjetër, ka policë të tillë të cilët që nga paslufta akoma kanë mbetur në pozicionet e tyre të policit të thjeshtë dhe nuk arrijnë fare të ngritën në grada dhe fare nuk pretendohet dhe nuk tentohet, që të shikohet mundësia që ata policë të cilët kanë qenë të ndershëm, i plotësojnë të gjitha kushtet, normalisht, formale...

(Ndërprerje nga regjia)

KRYESUESI: Faleminderit! Fjalën e ka zoti Glauk Konjufca.

GLAUK KONJUFCA: Deputetë të Kuvendit të Republikës së Kosovës, Ndonëse vendimet e Gjykatës Kushtetuese janë përfundimtare dhe të paankimueshme, megjithatë kjo nuk do të thotë që nuk do të flitet e nuk do të diskutohet për to.

Vetë gjyqtarët e këtij institucioni zgjidhen prej Kuvendit të Republikës së Kosovës, kështu që është më se legjitime, që ne të ngremë shqetësimet tona lidhur me vendimet që ata i marrin. Prandaj, po marr shkas që të flas lidhur me vendimin e Gjykatës Kushtetuese, për t'i shpallur si antikushtetuese dy vendimet e 12 qershorit 2015, të marra prej Kolegjit të Ankesave të Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme. Duke i anuluar këto dy vendime të vitit të kaluar, Gjykata jonë Kushtetuese në të vërtetë ka legjitimuar vendimin e Serbisë së kohës së Milosheviqit, pra të vitit 1997, për t'ia dhënë Manastirit të Deçanit 24 hektarë tokë. Kjo tokë u takon ndërmarrjeve që dikur ishin shoqërore, ndërmarrjeve "Iliria" dhe "Apiko". Në emër të arsyetimit, se Manastirit të Deçanit po i rikthehet një hapësirë tokësore, e cila ishte marrë në vitin 1946, në të vërtetë ajo që po ndodh është legjitimimi i vendimeve të Milosheviqit, që gjatë viteve të '90-ta bëhej me qëllim të korrektimit të vendimeve të Jugosllavisë socialiste e që e kthenin gjendjen e Jugosllavisë së Kralit Aleksandër.

Ju e dini, që edhe pas ardhjes së UNMIK-ut në Kosovë, korniza ligjore e funksionimit të institucioneve të Kosovës ishte e ndërtuar mbi principin e trashëgimisë ligjore, por e cila ishte jodiskriminuese. Vendimi i Milosheviqit i vitit 1997 nuk ka kurrfarë dyshimi që është vendim qartazi diskriminues, sepse ai i shpronëson edhe qytetarët e Republikës së Kosovës, por edhe komunën e Deçanit. Si rrjedhojë, të gjitha këto vendime që janë të kohës së Milosheviqit dhe të viteve '90-ta, ajo që ne duhet, si Kuvend i Republikës së Kosovës, është që të anulohen me shumicë të votave, këtu në Kuvendin e Republikës së Kosovës. Pikërisht për shkak të këtij vendimi të padrejtë të Gjykatës Kushtetuese, kjo ka nxitur një pakënaqësi të gjerë qytetare, ka shkaktuar disa protesta në komunën e Deçanit, ku kanë marrë pjesë edhe zyrtarët komunalë të Deçanit, por edhe deputetë të ndryshëm të Kuvendit të Republikës së Kosovës. Komuna e Deçanit tashmë ka hyrë në grevë dhe ka thënë, se nuk do ta njohë këtë vendim të Gjykatës Kushtetuese.

Vetë fakti që shkaktoi një pakënaqësi kaq të madhe ky vendim, tregon se ishte një vendim shumë i padrejtë.

KRYESUESI: Faleminderit! Zonja Izmaku e ka fjalën.

XHEVAHIRE IZMAKU: Faleminderit, kryesues!

Të nderuar ministra,

Të nderuar kolegë deputetë,

Tema që do të ngre sot unë ka nevojë të ketë vëmendjen e Qeverisë dhe Ministrisë së Punës dhe Mirëqenies Sociale, bashkë me Inspektoratin e Punës, si trupa ekzekutive.

Çështja ka të bëjë me mijëra punëtorë kosovarë të angazhuar në sektorin privat, të cilët sipas shumë informacioneve dhe fakteve, nuk po trajtohen në mënyrë të denjë dhe as afër sipas të drejtës që u takon me ligjet në fuqi. Kategoritë e punëtorëve, për të cilët ka informacione se trajtimi i tyre është joligjor, i takojnë sektorit të ndërtimeve, punëtorët në sektorin e tregtisë, kryesisht marketet e mëdha në vend, ku tani në periudhën e verës punëdhënësit e tyre i detyrojnë të punojnë me orar të tejzgjatur dhe ato ditë as nuk u kompensohen me mjete shtesë financiare dhe as me ditë pushimi.

Mijëra gra dhe vajza, që çdo ditë na shërbejnë pranë arkave, ku ne furnizohemi me ushqime, nuk kanë as karrige në vendet e tyre të punës. Punëtorët në këto markete nga pagat e tyre janë të detyruar të ndajnë gjysmën e saj për të blerë gjërat ushqimore në këto markete dhe të ushqehen po ashtu, aty në kohën e pauzës. Në këto nuk mund t'i hetojmë, sepse numri i inspektorëve për tërë territorin e Kosovës është vetëm 52, në total. Ka të dhëna të sakte, se trajtimi aspak korrekt, po ndodhë edhe me punëtorët në sigurimet fizike, ku pagat po ashtu janë minimale e nën minimale. Trajtimi joligjor po ndodhë edhe me punëtorët e pastrimit, ku ka punëtorë që nuk kompensohen as me pagën minimale, të cilën e kemi caktuar me ligj në këtë vend. Pra, paguhen vetëm me 120 euro në muaj. Objektet hoteliere, ku tani në sezonet e dasmave kanë angazhime më të mëdha.

Andaj, ne si shtet përveçse të kujdesemi për vjeljen e tatimeve në fitim, duhet urgjentisht të mendojmë për shtimin e kapaciteteve në Inspektoratin e Punës. Këta punëtorë, sigurisht se janë të detyruar të përballojnë këto kushte të rënda pune, sepse varet jeta e tyre familjare.

I ftoj inspektorët e punës, që të rrisin vëllimin e punës dhe të veprojnë në ndalimin e të gjitha llojeve të diskriminimit; të ushtrojnë autoritetin e tyre për të bërë ndalimin e punës së dhunshme, ose të detyruar; të interesohen për realizimin e pagesës së barabartë për punëtorë; realizimin e pagës; orarin e punës; realizimin e pushimit ditor, javor; festave zyrtare; rasteve familjare dhe rasteve tjera.

E ftoj edhe vëmendjen e Qeverisë në përgjithësi, të shikojë një mundësi që të rrisë numrin e inspektorëve, posaçërisht në këtë periudhë vere të krijojë një forcë, e cila do të shikonte urgjentisht trajtimin e punëtorëve në këta sektorë, sepse duhet bërë punë. Duke bërë punë të mëdha nuk mund të arsyetohemi, t'i lëmë pambarimisht në dorën e fatit këta njerëz dhe ata shefa që nuk duan të dinë, as për ligjin dhe as për humanen, duhet ta ndjejnë, pra sigurisht, fuqinë e forcës e detyrimit të shtetit. Faleminderit!

KRYESUESI: Zonja Osmani e ka fjalën.

VJOSA OSMANI: Faleminderit!

Dola të reagoj, si shkas i deklaratave të deputetëve të Listës serbe rreth shndërrimit të FSK-së në Ushtri të Kosovës.

Të gjithë ata që kanë pasur dyshime rreth rezultateve të normalizimit dhe sa ka ndikuar kjo në integrimin e komunitetit serb në Kosovë, do të duhej ta krahasonte fjalorin, që deputet e njëjtë, serbë, e kanë pasur në vitin 2008, vinin të lobonin në Kombet e Bashkuara, madje në takime me ambasadorë kinezë e rus, për njohjen e Kosovës. Dhe, po të njëjtit sot thonë që duhet ta pyesin Vuçiqin, në qoftë se duhet të votojnë pro ushtrisë së Kosovës.

Unë dua t'i siguroj këta deputetë, tërë Listën serbe, se shndërrimi i FSK-së në një forcë të armatosur, të ngjashme me vendet e rajonit, nuk varet nga ata, pra nuk varet nga Lista serbe, në fakt, as nga shefi i tyre në Beograd, ky shndërrim nuk varet as nga ndryshimet kushtetuese, ku Lista serbe synon ta shfrytëzojë votën e saj për bllokim. Kjo mund të vërehet qartë nga të gjithë ata që e lexojnë Kushtetutën dhe ta sqarojë pse.

Neni 126 i Kushtetutës sqaron, se kompetencat e ushtrisë përcaktohen me Ligj dhe organizimi i brendshëm i ushtrisë përcaktohen me ligj. E vetmja gjë që përcaktohet në Kushtetutë është emri dhe të gjithë ata që kanë marrë pjesë në hartimin e Kushtetutës e dinë, se me qëllim këto gjëra janë vendosur në Ligj, pikërisht duke e pasur parasysh që një ditë serbët apo pakicat mund ta bllokojnë shndërrimin e FSK-së në ushtri.

Më 29 korrik sekretari gjeneral i NATO-s deklaroi se FSK-ja i ka përmbushur kapacitetet e plota operacionale. Më 2015, për herë të parë Kongresi Amerikan e fton Qeverinë amerikane, që ta ndihmojë Kosovën për anëtarësim në partneritetin për paqe. Pra, liderët tanë me një vit vonesë kanë uruar për këtë gjë, sepse më 6 janar 2015 për herë të parë kjo gjë është përmendur në Defence Authorization Act, që është akti ku edhe përcaktohet qëndrimi amerikan në raport me çështje të sigurisë edhe në vendet tjera të botës.

Çka duhet të ndryshohet sot, që të formohet ushtria? Kreu 2 i Ligjit për FSK-në, konkretisht neni 10.2, që përcakton armatimin dhe neni 14, që përcakton organizimin, natyrisht edhe çështje të tjera, sepse janë një 4-5 ligje, që kanë të bëjnë me shërbimin në FSK dhe çështje tjera operacionale.

Pra, të nderuar deputetë, nëse e duam ushtrinë kjo gjë mund të bëhet gjatë ditës, sepse ushtrinë nuk e bën emri, ushtrinë e bën armatimi, ushtrinë e bën numri, pra edhe neve tash na lejohet ta rrisim atë nga 2 500 anëtarë aktivë dhe 800 pjesëtarë rezervë dhe ushtrinë e bën funksioni dhe kompetencat. Këto mund t'i bëjmë qysh sot dhe mund t'i bëjmë, madje, teoritikisht...

(Ndërprerje nga regjia)

KRYESUESI: Zoti Bulliqi e ka fjalën dhe të tjerë nuk ka.

SHPEJTIM BULLIQI: Faleminderit, zoti kryesues!

Të respektuar deputetë të Kuvendit,

Të respektuar qytetarë të Kosovës,

Arsyeja pse desha ta marr fjalën është shqetësimi lidhur me mënyrën e organizimit të testit të maturës.

Siç jemi në njohuri, para pak ditësh u bë organizimi i testit të maturës në nivel të Kosovës dhe përkundër premtimeve nga ana e Ministrisë së Arsimit, se çdo gjë do të jetë në rregull dhe siguria dhe mbarëvajtja e këtij procesi do të jetë në nivelin më të lartë, prapëseprapë praktika na tregoi se në terren na rrodhën probleme, ku rasti më eklatant ishte që në shumë shkolla, në nivel vendi, domethënë u lejua që në mënyrë të lirshme nxënësit të përdorin mjetet e ndryshme, siç është rasti me telefonat dhe format tjera të kopjimit gjatë këtij testi.

Meqë gjatë krejt kësaj faze, nga Ministria e Arsimit na është premtuar që Kosova do të jetë një shtet i dijes, unë e shtroj një pyetje, me këtë dije kah do të shkojmë dhe cila do të jetë mënyra dhe forma e punës së Ministrisë së Arsimit, që në të ardhmen të mënjanohej të gjitha këto probleme.

Ne jemi dëshmitarë që, faktikisht, në të gjitha rrjetet sociale gjatë krejt këtij procesi arritën të barten pyetje të ndryshme të testit të maturës dhe në njëfarë forme, faktikisht, u mundësohet një kopjim masiv i nxënësve dhe sigurisht, se rezultatet të cilat do të dalin, do të jenë rezultatet të pavlefshme, për faktin se kemi lëshime gjatë procesit të realizimit të këtij testi të provimit.

Atëherë, të gjitha këto, mendoj që në fund e obligojnë Ministrinë e Arsimit që në të ardhmen të angazhohet maksimalisht, që të shkohet drejt procesit të digjitalizimit të këtij testi të maturës, në mënyrë që të mënjanohej nga praktika këto lëshime, të cilat po bëhen në organizimin dhe mbarëvajtjen e këtij testi të maturës. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Faton je paraqitur me vonesë, por po ta jap fjalën. Tre minuta i ke!

FATON TOPALLI: Faleminderit, kryesues!

Në fakt, unë nuk e kisha ndërmend sot të flisja në këtë pikë të rendit të ditës, por kur po shoh karriget e zbrazëta aty ku duhet të ulet Qeveria, shtroj me të drejtë pyetjen për të konstatuar edhe ju si kryesues i mbledhjes, që Qeveria e Kosovës është duke e bojkotuar Kuvendin e Kosovës.

Kjo pyetje shtrohet akoma më shumë pas ftesave të shumta të kryeministrit, që opozita të kthehet në Kuvend dhe kur Lëvizja “Vetëvendosje” kthehet në Kuvend, atëherë kryeministri i Kosovës, së bashku me shumicën e kabinetit të tij qeveritar e bojkoton pikërisht Kuvendin e Kosovës, ashtu siç e ka bojkotuar dhe injoruar edhe në shumë raste të tjera.

Pika e dytë, që dua të shtroj, është ajo që ka të bëjë me punonjës të Fabrikës së Gypave, të cilët janë në grevë në komunë. Ata para më shumë se një viti kanë bërë një kërkesë tek kryeministri i Kosovës, zoti Mustafa, për t’u takuar me të. Merreni me mend, më tepër se një vit ka kaluar dhe kryeministri i Kosovës nuk është në gjendje, që të organizojë një takim të vetëm me punëtorët e Fabrikës së Gypave, të cilët i kanë ndjekur pas gjatë gjithë fushatës zgjedhore dhe u ka premtuar gjatë gjithë kohës, se do ta realizojë vendimin e Gjykatës Kushtetuese dhe të Kuvendit të Kosovës. Por, tash ai po tregon se është vetë “kadi”, vetë “spahi”, që vetë vendos cilat ligje t’i respektojë dhe cilat ligje t’i shkelë.

Pika e tretë, që dua të shtroj para jush dhe para qytetarëve të Kosovës, është një vizitë të cilën kryeministri i Kosovës e bëri në fshatin Zllatar, në vendlindjen e babait tim, javën e kaluar. Desha t'i them kryeministrit, pavarësisht se nuk është këtu, që në Zllatar janë gëzuar shumë, sepse s'kanë pasur asnjëherë kaq shumë mysafirë nga jashtë, sepse ka sjellë shumë me vete për të përuruar një rrugë, e cila është dashur të ndërtohet qysh para dy-trembëdhjetë vjetësh e nuk është ndërtuar deri tani.

Porosia e fshatarëve, banorëve të fshatit Zllatar është: "Kryeministër, nuk ka nevojë të na ndërtoni rrugë dhe t'i prisni shiritat, sepse, në fund të fundit, ato rrugë jemi duke i paguar ne me tatimet tona. Ne kemi nevojë për vende të reja të punës, kemi nevojë për zhvillim ekonomik, kur t'i kemi fabrikat, kur t'i kemi vendet e punës atëherë mund edhe të ndërtojmë rrugë të reja. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Konstatoj se është shteruar pika e parë e rendit të ditës.

2. Koha për pyetje parlamentare

Janë të paraqitura 13 pyetje parlamentare.

Deputeti Ismajl Kurteshi ka pyetje për kryeministrin Isa Mustafa. Kryeministri nuk është këtu. Nëse doni, mund ta lexoni pyetjen? Zoti Kurteshi e ka fjalën!

ISMAJL KURTESHI: Unë nuk do ta kisha lexuar pyetjen për kryeministrin nëse ju më garantoni se kryeministri dhe Qeveria do të ndërpresin bojkotin deri në seancën e ardhshme, por meqë në këtë farë bojkoti të padeklaruar, ata po e kalojnë mandatin, unë do ta lexoj pyetjen për zotin kryeministër.

Zoti kryeministër, që nga shkurti i këtij viti ju bashkë me partnerin tuaj të koalicionit keni paralajmëruar riformatimin e Qeverisë. Keni deklaruar se riformatimit të Qeverisë do t'i paraprijë vlerësimi i punës së ministrave.

Zoti kryeministër, si e vlerësoni angazhimin e ministrave të kabinetit tuaj që me përkushtim janë angazhuar që Kosova të mos pranohet në UNESCO, në UEFA e FIFA, si dhe brohoritjet e tyre gjatë fushatës zgjedhore të Serbisë - "Kosova është zemra e Serbisë", ose angazhimin e tyre për shpalljen e njëanshme të "Zajednicës".

A do të ketë vend për ministra e zëvendëskryeministra të tillë në kabinetin tuaj të riformatuar? Besoj se përgjigjen do ta marr nga kryeministri.

KRYESUESI: Faleminderit! Pyetjen e dytë, është edhe kërkesë juaja që ta kaloni më shpejt. Deputeti Ismajl Kurteshi, pyetje për ministrin Arsim Bajrami. Zoti Kurteshi, e keni fjalën!

ISMAJL KURTESHI: Faleminderit!
Zoti ministër,

Është konstatim i përgjithshëm, me të cilin jeni pajtuar edhe ju si Ministri, se tekstet shkollore për shkollat fillore për shumë arsye duhet të ndryshohen. Megjithatë, kanë kaluar shumë vjet dhe tekstet e njëjta po u ofrohen nxënësve. Po ashtu, për shkollat e mesme profesionale mungojnë shumë tekste.

Zoti ministër, çka keni ndërmarrë konkretisht që tekstet në vitin e ri shkollor të reformohen apo nxënësit do të jenë të obliguar të punojnë me tekste të njëjta shkollore, të cilat kanë plot defekte, e një ndër to edhe është volumi i madh i teksteve dhe çanta shumë e rëndë për nxënës, e po ashtu, a do të ketë tekste të reja për shkollat e mesme profesionale, të cilat mungojnë në masë të madhe. Faleminderit!

KRYESUESI: Zoti ministër Bajrami, e keni fjalën!

ARSIM BAJRAMI: Faleminderit, i nderuar deputet Kurteshi!

Para se të jap përgjigjen, dëshiroj t'i them dy-tri fjalë për atë që foli zoti Bulliqi rreth maturës.

Dëshiroj të theksoj se organizimi i një mature është sfidë jo vetëm për Kosovën, por për krejt shtetet e Bashkimit Evropian, por mund të them që në dhjetë vjetët e kaluara matura e sivjetme është vlerësuar ndër më të suksesshmet, sepse kemi pasur vetëm pak raste të izoluara të denoncuar, për të cilat Ministria ka marrë menjëherë veprime dhe definitivisht po tregohet se me veprimet që ne po i ndërmarrim po vendosim standarde.

Sa i përket pyetjes tuaj që i përmban dy nënpyetje, më lejoni t'ju informoj se Ministria e Arsimit pas shumë kërkesave të prindërve, pas shumë kërkesave të mësimitdhënësve, për herë të parë i është qasur rishikimit të teksteve dhe kam kënaqësinë, zoti deputet, t'ju njoftoj se nga 1 shtatori 86 tekste të arsimit parauniversitar nga klasa e parë deri në klasën e nëntë do të jenë tekste të reja të rishikuara nga grupi i ekspertëve, që janë më tepër se 20 të tillë të fushave të ndryshme, të cilët i kanë rishikuar të gjitha tekstet në nivel deri në 40%, në katër segmente.

E para, janë mënjanuar të gjitha përmbajtjet e papërshtatshme dhe gjuha e papërshtatshme për fëmijë:

E dyta, janë evituar të gjitha gabimet teknike të raportuara.

E treta, janë evituar të gjitha gabimet profesionale dhe shkencore, dhe

E katërta, është lehtësuar çanta e fëmijëve.

Ky është një proces jashtëzakonisht i rëndësishëm që prek 260 mijë nxënës të arsimit parauniversitar dhe është vetëm faza e parë, sepse në fazën e dytë ne do të shkojmë te hartimi i teksteve krejtësisht të reja, në bazë të kurrikulës së re dhe do të promovojmë edhe tekstin digjital.

Pa dyshim se ky është hapi dhe premtimi i mbajtur për ngritjen e cilësisë në arsim, ku tekstet shkollore kanë një rëndësi dhe ne i kemi marrë këto shqetësime që janë dëgjuar dhe kemi vepruar jashtëzakonisht shpejt me një komision profesional të udhëhequr nga zëvendësministri Statovci dhe me një gjithëpërfshirje të gjithë ekspertëve të fushës së arsimit parauniversitar.

Tek arsimi profesional, më lejon të ju njoftoj se për herë të parë kemi autorizuar nisjen e 80 teksteve për shkolla profesionale, që janë ligjërata të autorizuar me mbështetjen e Qeverisë Gjermane dhe nga 1 shtatori për herë të parë do të kemi 180 tekste, në tri drejtime, kryesisht në fushën e bujqësisë, në fushën e mekanikës dhe në fushën profesionale të mjekësisë. Do të kemi tekste të autorizuar dhe, në anën tjetër, kemi marrëveshje të nënshkruara me Qeverinë e Shqipërisë dhe me Ministrinë e Maqedonisë që të marrim të gjitha tekstet profesionale.

Sa i përket arsimit profesional, në nga shtatori 50% të teksteve do t'i ofrojmë në formë digjitale, sepse ekzistojnë standarde ndërkombëtare dhe tekste të licencuara e të patentuara që mësimdhënësit tanë duhet t'i përdorin, sepse ato janë standarde unike, për shkak se bëhet fjalë për tekstet e shkollave profesionale.

KRYESUESI: Faleminderit! Pyetje shtesë, zoti Kurteshi? Urdhëroni, zoti Kurteshi!

ISMAJL KURTESHI: Po! Ajo që dëgjova, zoti ministër, sa u përket teksteve të shkollave fillore kjo është më tepër ndërhyrje teknike se sa ndërhyrje substanciale e teksteve dhe mendoj që nuk duhet humbur kohë dhe do të duhej që ju sa më parë t'i filloni ndërhyrjet substanciale, sepse nxënësit kanë nevojë për këtë çështje. Kurse, sa i përket teksteve për shkolla të mesme profesionale, thatë se një pjesë e teksteve do të ofrohen në mënyrë digjitale.

Nuk jam i sigurt se shkollat tona janë të përgatitura për këtë formë të nxënies së mësimi dhe po ashtu nuk mendoj se të gjithë nxënësit kanë mundësi ose kanë kompjuter që këto libra t'i lexojnë përmes teknologjisë informative, e cila është më se e nevojshme.

Dhe, krejt në fund, sa i përket provimit të maturës, thatë se nuk ka pasur shumë vërejtje....

KRYESUESI: Zoti Bajrami, e keni fjalën!

ARSIM BAJRAMI: I nderuar deputet,

Ka pasur probleme, sidomos në komunën e Gjilanit, dhe ju keni parë që Ministria ka përsëritur testet, ky është një veprim i shtetit ligjor dhe është mesazh që askujt nuk do t'i lejohet fryrja e rezultateve.

Për tekstet në këtë fazë, bëhet fjalë për 86 libra. Pra, librat nga klasa e parë dhe klasa e nëntë dhe secili kemi fëmijë apo nipa dhe do t'i shihni në shtator kur t'i marrin, të gjitha janë shikuar në shkallë deri në 40%.

Disa tekste, me vendimin tim personal, do të rishkruhen, sidomos tekstet e historisë, sidomos të historisë së Kosovës dhe dëshirojmë që historinë nxënësve t'ua shpjegojmë drejt, ashtu siç ka ndodhur, pa fryrje dhe pa politizime dhe me vendimin tim tekstet e historisë që kanë të bëjnë me historinë e Kosovës do të rishikohen.

Nuk është e vërtetë që mësimdhënësit dhe nxënësit tanë nuk janë të hapur ndaj mësimi digjital. Bile, për nxënës as që bëhet fjalë, sepse nxënësit nga klasa e parë kanë qasje në internet dhe kemi një gjeneratë inteligjente. Mësimdhënësit për herë të parë, 24.000 mësimdhënës, në shtator do të hyjnë në testin kombëtar të vlerësimit të performancës. Pra, po shihni çfarë hapa...

(Ndërprerje e incizimit)

KRYESUESI: Faleminderit! Deputeti Abdyl Ymeri, pyetje për zëvendëskryeministrin Kujtim Shala. Ministri nuk është këtu. A dëshironi ta bëni pyetjen? Jo!

Deputetja Alma Lama, pyetje për ministrin Skender Hyseni.

A është Alma këtu? Nuk është!

Deputeti Raif Qela, pyetje për kryeministrin Isa Mustafa.

A dëshironi ta bëni pyetjen? Zoti Raif Qela e ka fjalën!

RAIF QELA: Të nderuar deputetë,
Meqenëse është hera e dytë që dua t'i drejtohem zotit kryeministër me pyetjen dhe këtë herë unë do ta lexoj atë, pavarësisht se ai nuk është i pranishëm.

Pyetja për kryeministrin e Kosovës, zotin Isa Mustafa, është kjo:

Nëse e drejta në pronë është një e drejtë universale, e sanksionuar edhe me Kushtetutën e Republikës së Kosovës, neni 46, ku thuhet se “e drejta e pronës është e garantuar”, pse institucionet e Kosovës nuk kanë ndërmarrë dhe nuk po ndërmarrin asgjë serioze në mënyrë që qytetarëve shqiptarë të dëbuar me dhunë nga pronat e veta nga pjesa veriore e qytetit të Mitrovicës t'u lejohet kthimi në pronat e veta dhe t'u krijohet siguri për banim e jetë të rehatshme?

Zoti kryeministër, edhe nëse nuk është i pranishëm, e ka për detyrë kushtetuese që të angazhohet për qytetarët e vet, në mënyrë që drejtësia të kthehet në vend. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Zonja Blerta Deliu-Kodra, pyetje për ministrin Imet Rrahmani. Nuk është as deputetja, e as ministri këtu.

Deputetja Albulena Haxhiu, pyetje për kryeministrin Isa Mustafa. Zonja Haxhiu, e keni fjalën, nëse dëshironi ta lexoni pyetjen.

ALBULENA HAXHIU: Faleminderit!

Se sa serioze dhe sa e përgjegjshme është kjo Qeveri, e kuptojmë edhe nëse i shohim karriget e ministrave dhe kryeministrit nga 21, sa janë, vetëm 3 qenkan, sepse paska ardhur edhe zoti Abrashi.

Dhe, natyrisht, po duket se kjo Qeveri nuk po e di që Kosova është Republikë parlamentare dhe jo qeveritare, qysh po tenton ta bëjë, ta shndërrojë në Republikë qeveritare.

Domethënë, Qeveria e ka për obligim t'u raportojë këtyre deputetëve dhe këtij Kuvendi.

Na bënin thirrje që të kthehemi në Kuvend! Ku janë tash për të dhënë llogari para të gjitha shkeljeve që i kanë bërë?

Pyetja ime ka të bëjë me një projektligj që u procedua në Kuvend javën e kaluar.

Që nga paslufta, pra në vitin 2011, ndërmjet periudhës 1 dhe 15 prill u bë regjistrimi i popullsisë.

Aso kohe me pompozitet thuhej se regjistrimi do të bëhet në gjithë territorin e Republikës së Kosovës, madje edhe në veri.

Në fakt, ajo çfarë ndodhi, është se regjistrimi i popullsisë nuk u bë në gjithë territorin e Republikës së Kosovës.

Pra, Qeveria sërish u dorëzua para Beogradit.

Dhe, çfarë ndodhi tash, pesë vjet pas? U procedua një projektligj tjetër, siç thuhet, për komunat që nuk kanë marrë pjesë në regjistrimin e popullsisë.

Dhe, pyetja ime është: Pse u procedua ky projektligj, do të thotë për qytetarët që janë qytetarët e Republikës së Kosovës, pra pse ata po tentohet që të duken më ndryshe ose më të veçantë nga qytetarët e tjerë të Republikës së Kosovës, sepse në asnjë vend të pavarur nuk ekzistojnë dy ligje për të njëjtën çështje brenda një territori të njëjtë, siç është fjala për regjistrimin e popullsisë.

Madje, problemi tjetër qëndron se me këtë projektligj po i përjashtojnë nga regjistrimi shqiptarët e dëbuar dhunshëm nga pjesa veriore, kur dihet se shqiptarët e veriut kanë 16 vjet që janë përndjekur nga shtëpitë e tyre dhe nuk janë kthyer më asnjëherë në pronat e tyre. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Deputeti Abdyl Ymeri, pyetje për ministrin Zharku. A dëshironi edhe këtë ta shtyni, apo dëshironi ta pritni ministrin të vijë këtu?

Deputeti Faton Topalli, pyetje për kryeministrin Isa Mustafa.

Faton, a dëshiron ta bësh pyetjen? Zoti Topalli e ka fjalën!

FATON TOPALLI: Faleminderit, kryesues!

Gjatë gjithë kohës, por posaçërisht në korrik dhe gusht të çdo viti dhjetëra-mijëra mërgimtarë bëhen pre e plaçkës në kufi, përmes Kartonit të Gjellbër, që është monopol i mafisë së sigurimeve të makinave.

Në korrik të vitit 2014 ish-kryeministri Thaçi pati deklaruar se kjo çështje do të rregullohet gjatë atij viti.

Gjatë fushatës zgjedhore, po të njëjtit vit, ju premtuat, zoti kryeministër, se çështja e Kartonit të Gjellbër do të rregullohet me të marrë pushtetin. Premtime të ngjashme pati dhënë edhe gjatë vitit 2015. Tani është viti 2016.

Ajo që është parë deri tani është zvarritja e qëllimshme e zgjidhjes së problemit për t'u mundësuar kompanive të sigurimeve që deri më tani kanë përvetësuar në mënyrë të pandershme mbi 200 milionë euro, për ta shtuar fitimin edhe më shumë.

Pas reagimit tonë, më 21 maj 2015 në Kuvendin e Kosovës, Banka Qendrore e Kosovës, duke shfrytëzuar kompetencat e saj ligjore, përgjysmoi për 50% çmimin e policave të sigurimit kufitar. Faktikisht ajo përgjysmoi gjysmën e plaçkës për Kartonin e Gjellbër, por nuk mënjanoi atë, pavarësisht nga fakti se mërgimtarët paguajnë sigurime për makina në vendin nga të cilat vijnë dhe nuk do të duhej të paguanin dy herë, pra dyfish, edhe në Kosovë.

Pyetja ime është kjo: Në emër të gjithë mërgimtarëve të plaçkitur, çfarë hapash keni ndërmarrë ju si kryeministër për t'i dhënë fund kësaj plaçkitje të mbështetur nga institucionet e vendit dhe kur do të mund të udhëtojnë mërgimtarët e Kosovës në vendin e tyre pa u plaçkitur me Kartonin e Gjellbër në kufi.

KRYESUESI: Faleminderit! Zonja Alma Lama, pyetje për ministrin Skender Hyseni, edhe ministri penka këtu.

ALMA LAMA: Faleminderit, i nderuar kryesues!

U bë më shumë se sa një vit që është miratuar Ligji për ndalimin ose parandalimin e pjesëmarrjes së qytetarëve të shtetit të Kosovës në luftëra jashtë vendit, pra për bashkimin në këto luftëra dhe besoj që është kohë e mjaftueshme për të parë se si është zbatuar ky ligj, çfarë ka shkaktuar, domethënë a ka përmirësim të gjendjes, sepse ky ligj është bërë për të sanksionuar një fenomen jashtëzakonisht negativ që lidhet me bashkimin në organizata terroriste, siç është ISIS-i, të disa qytetarëve të Kosovës. Pra, çfarë ka prodhuar ky ligj? Faleminderit.

KRYESUESI: Faleminderit! Zoti Hyseni e keni fjalën.

MINISTRI SKENDER HYSENI: Faleminderit, për pyetjen zonja Lama,

I nderuar kryesues Haliti,

Të nderuar deputetë,

Po, keni të drejtë, tashmë bëhet një vit që ky hy në fuqi ligji, të cilit i referohemi dhe me gjuhën e numrave, brenda kësaj periudhe në pajtim me dispozitat e këtij ligji janë ngritur 33 kallëzime penale. Ndërkohë që mund të themi me bindje të thellë që ligji ka prodhuar konsekuenca shumë pozitive, sepse po e përmbyllim gati muajin e dhjetë që nuk është regjistruar asnjë rast i vetëm i shkuarjes në konfliktet e huaja nga Republika e Kosovës, duke përjashtuar kështu dy tentime në muajin nëntor, të cilat janë parandaluar në mënyrë shumë të suksesshme nga Policia e Kosovës.

Pra, ligji ka prodhuar rezultate, ka dhënë rezultate evidente, sepse flasin për 33 kallëzime penale që përfshijnë më shumë individ se sa 33, por po flasim për 33 kallëzime të veçanta penale. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Pyetje shtesë Alma, a dëshironi. Zonja Lama e ka fjalën.

ALMA LAMA: Po, megjithëse ligji është mjaft i detajuar, megjithatë shpesh në publik nga organizatat të cilat janë marrë me monitorimin e këtij fenomeni është ngrehur edhe çështja e

personave, të cilët mashtrohen, shkojnë, u bashkohen këtyre organizatave ose jo, e kuptojnë realitetin atje që është diçka krejt ndryshe nga sa iu kanë thënë këtu në territorin e Kosovës nga predikuesit dhe kur kthehen pastaj ndëshkohen. A mendoni që është i mjaftueshëm apo ka nevojë për legjislacion shtesë për të sanksionuar raste të veçanta dhe për të mos i futur, si të thuash, të gjithë në një thes, domethënë personat të cilët pendohen që mund të inkuadrohen sërish në shoqëri ose që mund të sjellin informacione të rëndësishme edhe për hetime të tjera për policinë. A mendoni që është e mjaftueshme kjo bazë ligjore, apo ka nevojë edhe për më tutje?

KRYESUESI: Zoti Hyseni, e keni fjalën.

MINISTRI SKENDER HYSENI: Edhe pyetja shtesë, Alma, është thelbësore, sepse nuk mjaftojnë vetëm masat represive, për të qenë krejtësisht në anën e sigurt sa i përket këtij problemi, këtij fenomeni, kërkohet angazhimi i gjithë shoqërisë, i të gjitha kategorive sociale e politike që të ndodhë deradikalizimi atje ku ka radikalizim.

Në Ministrinë e Punëve të Brendshme tashmë kemi filluar një projekt konkret të riintegrimi. Në rend të parë të atyre që pendohen dhe kthehen dhe pjesë e përpjekjeve të përgjithshme për ta parandaluar këtë të keqe për vendin.

Ndërkohë që duhet të vazhdohen projektet e tillë dhe unë besoj që po shohim rezultatet e para.

Vitin e kaluar kemi ndërmarrë një fushatë në secilën komunë të Republikës së Kosovës, po thuaj të gjithë këshillat komunalë, të ashtuquajtur për siguri në bashkësi, dhe kemi folur hapur për nevojën e radikalizmit dhe angazhimit të gjithëve, duke i përfshirë edhe bashkësitë fetare nëpër komuna, duke i përfshirë drejtoritë e shkollave që janë po ashtu thelbësore, për të ndërtuar atë që quhet kundër në arrati ose një kundër mesazh që në esencë ka për synim deradikalizimin.

KRYESUESI: Faleminderit! Zonja Besa Baftiu, pyetje për ministrin Imet Rrahmani, dëshironi ta bëni pyetjen Besa? Zonja Baftiu e ka fjalën.

BESA BAFTIU: Po, faleminderit!

Edhe vërejtja ime shkon për ministrat, të cilët nuk janë prezentë, apo për Qeverinë, të cilët po tregohen të papërgjegjshëm ndaj deputetëve të Parlamentit, konkretisht ndaj qytetarëve të Republikës së Kosovës, sepse shqetësimet të cilat ne i paraqesim janë shqetësime të qytetarëve të Republikës së Kosovës.

Problemin të cilin dua ta paraqes po besoj se ministri i Shëndetësisë është në dijeni, mirëpo arsyeja pse unë këtë po e bëj publike këtë pyetje qëndron në atë sepse ministri ka qenë i ftuar nga këta punëtorë të Spitalit regjional të Gjilanit, mirëpo nuk e ka parë të arsyeshme apo të rrugës, edhe pse çdo ditë vjen në Gjilan, t'i takojë dhe prej dorës së parë të dijë problemin se ku qëndron.

Muajin e kaluar punëtorët e sigurimit të Spitalit të përgjithshëm të Gjilanit kanë qenë në grevë për dy javë dhe ende nuk e kanë ndërprerë, vetëm e kanë pezulluar përkohësisht deri më 10 qershor.

Arsyeja e kësaj greve është se atyre po u shkelen të drejtat e punëtorëve, të cilat ua garanton Ligji i punës.

Këta punëtorë, përveç që marrin një pagë minimale prej 170 euro, edhe këtë nuk e marrin me rregull, nuk u paguhen orët jashtë orarit të punës, nuk u paguhet puna e natës, si dhe festat.

Prej se këta punëtorë kaluan në kompani private, domethënë se 6 vjet nuk iu paguhet as trusti pensional.

Prandaj, në mungesë të këtyre punëtorëve janë rrezikuar pacientët, si dhe është vështirësuar puna dhe siguria e punëtorëve shëndetësorë.

Unë kërkoj nga ministri, thashë në fillim, me siguri e di, që të ndërmarrë masa në drejtim të zgjidhjes së problemeve të këtyre punëtorëve. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Zoti Topalli, pyetje për kryeministrin Isa Mustafa.

FATON TOPALLI: Faleminderit!

Pyetja ime ka të bëjë me një marrëveshje për shitje tokash.

Ekspertë të ndryshëm në Kosovë dhe opozita konsiderojnë se marrëveshja për demarkacionin me Malin e Zi është e dëmshme për Kosovën, sepse i fal Malit të Zi tokat të cilat i kanë takuar gjithmonë Kosovës.

Madje, ka zëra nga vetë mazhoranca që e vë në pikëpyetje këtë marrëveshje.

Ju keni arsyetuar se kufiri është përcaktuar në bazë të të dhënave kadastrale, pra aty ku përfundojnë pronat e regjistruara të qytetarëve të Kosovës.

Doli që edhe nga ana e Malit të Zi ka pjesë të tokave që nuk janë të regjistruara. Megjithatë, kufiri është caktuar aty ku përfundojnë pronat e regjistruara në Kosovë, po jo aty ku përfundojnë pronat e regjistruara në Mal të Zi.

Pyetja ime është kjo: Pse jeni përcaktuar si Qeveri për zgjidhjen që dëmton Kosovën? Cili është arsyetimi i juaj për këtë zgjidhje dhe na thoni edhe një herë, në cilësinë e kryeministrit, a qëndroni edhe më tutje për këtë zgjidhje apo keni ndonjë opsion tjetër për ta ndryshuar marrëveshjes, sidomos edhe për faktin që shteti fqinj i Malit të Zi, me të cilin natyrisht dëshirojmë të kemi raporte të mira, marrëdhënie të mira, është treguar i gatshëm për të rinegociuar këtë marrëveshje.

KRYESUESI: Faleminderit! Deputetja Besa Baftiu, prapë pyetje për ministrin Imet Rrahmani.

BESA BAFTIU: Faleminderit!

Pyetja ka të bëjë me sigurimet shëndetësore, se është bërë një tabu temë tash e 10 vjet, që iu premtohet qytetarëve të Republikës së Kosovës se do të kenë sigurime shëndetësore.

Qysh nga viti 2007, ku për herë të parë është aprovuar në Kuvend Ligji për sigurime shëndetësore, qytetarëve iu është përmendur shumë data për fillimin dhe zbatimin e tij.

Derisa në atë kohë dihen shkaqet pse nuk janë nënshkruar nga shefi i UNMIK-ut, tani që kaluan dy vjet prejse ky ligj ka kalua në Kuvend, ende nuk po zbatohet, e këtë më së shumti po e ndjejnë shumica e qytetarëve të Kosovës, sidomos kategoria e pensionistëve, familjet me asistencë sociale, familjet e dëshmorëve, invalidëve dhe veteranëve të luftës.

Pyetja ime është për ministrin, është shumë konkrete. Kur qytetarët e Republikës së Kosovës do të kenë sigurime shëndetësore dhe shërbime më të mira shëndetësore?

KRYESUESI: Faleminderit! Deputeti Salih Salihu, pyetje për ministrin Lutfi Zharku.

SALIH SALIHU: Përshëndetje, kryesues!

Çështja është, zoti ministër, është thënë që autostrada Prishtinë - Hani i Elezit është duke u ndërtuar sipas standardeve të Bashkimit Evropian për infrastrukturë rrugore.

Ky investim do t'i kushtojë Kosovës diku rreth 600 milionë euro. Po ashtu është thënë se qytetarët do të përfitojnë, e po ashtu edhe ekonomia, për arsye që do të ketë lidhje më të mirë me shtetet fqinje.

Pyetja është: Zoti ministër, a mund të na informoni si është e mundur që komuna e Vitisë, e cila i ka rreth 60 mijë banorë, të mos ketë lidhje me autostradën Prishtinë-Hani i Elezit, por duhet të kthehen qytetarët rreth 3 kilometra mbrapa nga linja kyçe e sotme në Gërlicë.

Pra, si deputet i kësaj zone, kërkoj të shqyrtohet mundësia e një lidhjeje, jo të nivelit të unazës siç është edhe siç po bëhet në Fushën e Pajtimit, në mënyrë që edhe komuna e Vitisë të lidhet me autostradën më afër në Gërlicë, sepse është me interes ekonomik për qytetarët e komunës së Vitisë. Besoj që do të marr përgjigje nga ministri. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Nuk ka pyetje të tjera. Konstatoj që edhe kjo pikë e rendit të ditës është përfunduar.

3. Miratimi i procesverbaleve nga seancat e mëparshme

Pyes nëse keni vërejtje në procesverbalet e seancave të mbajtura më 28 e 29 prill, 18 e 25 maj, si dhe më 25 maj. A ka vërejtje? Nuk ka vërejtje.

Zonja Albulena Haxhiu e ka fjalën.

ALBULENA HAXHIU: Faleminderit!

Si Grup Parlamentar kemi një propozim si pikë të rendit të ditës, ka të bëjë me zëvendësimin e anëtarëve të komisioneve parlamentare.

Ne si Grup Parlamentar kemi dorëzuar këtë vendim në Kryesinë e Kuvendit, mirëpo ende nuk është futur në rend dite, propozoj që edhe kjo pikë sot të futet në rend të ditës dhe natyrisht që të votohet nga Kuvendi.

KRYESUESI: Besoj që s'ka askush kundër kësaj pike të rendit të ditës. A jeni dakord, është formalitet.

Futet në rend të ditës si pikë e fundit sot.

4. Shqyrtimi i Projektligjit për ratifikimin e Konventës për heqjen e kërkesës për legalizim të dokumenteve zyrtare të huaja më 5 tetor 1961

Komisioni për Punë të Jashtme ka shqyrtuar Projektligjin dhe Kuvendit i ka rekomanduar për miratim.

Ftoj, tani kush është raportues për këtë, ftoj ministrin Abrashi të autorizuar nga Qeveria që ta arsyetojë projektligjin.

ARBAN ABRASHI: Faleminderit, kryesues,

Ministra, deputetë,

Të nderuar qytetarë,

Kam nderin të parashtoj për aprovim Projektligjin për ratifikimin e Konventës për heqjen e kërkesës për legalizim të dokumenteve zyrtare të huaja, konventa Apostile e datës 5 tetor 1961.

Ky zhvillim vjen si rezultat i përpjekjeve që më 6 nëntor të vitit 2015 Republika e Kosovës, përmes rrugëve diplomatike ka depozituar në Ministrinë e Jashtme të Mbretërisë së Holandës instrumentin e aderimit në këtë konventë.

Ministria e Punëve të Jashtme të Mbretërisë së Holandës, në këtë rast si shtet depozitues, ka njoftuar se ka pranuar instrumentin e aderimit dhe konform kësaj, duke u bazuar në nenet e konventës, kanë konfirmuar se për Republikën e Kosovës konventa duhet të hyjë në fuqi më 14 korrik 2016.

Më lejoni të nënvizoj që përmes aderimit në këtë konventë Republika e Kosovës e fuqizon subjektivitetin e saj në arenën evropiane dhe ndërkombëtare dhe njëkohësisht hap edhe një shteg të pjesëmarrjes në forume shumëpalëshe.

Përveç kësaj, kjo konventë dhe anëtarësimi i vendit tonë në të sjell avantazhe konkurrense, sepse do të lehtësohen dhe thjeshtësohen procedurat paraprake, shpesh edhe të gjata, të formaliteteve burokratike për qytetarët dhe bizneset nga shtetet anëtare të Konferencës së Hagës për të Drejtat Ndërkombëtare Private që të dëshmojnë vërtetësinë e dokumenteve zyrtare të tyre.

Po ashtu anëtarësimi shënon edhe mënjanimin apo heqjen e procesit të gjatë dhe kompleks të legalizimit të dokumenteve publike, duke zëvendësuar atë me një proces të shkurtër dhe më të thjeshtë.

Me këtë hap, edhe kësaj radhe institucionet e vendit, në veçanti Qeveria e Republikës së Kosovës po e shënon një të arritur të rëndësishme në funksion të realizimit, të objektivit strategjik që është zhvillimi i vazhdueshëm ekonomik dhe rritja e investimeve të huaja direkte në Republikën e Kosovës.

Vlerësojmë që me këtë anëtarësim komuniteti sipërmarrës i huaj dhe ai vendor do të inkurajohet akoma më shumë që në të ardhmen të projektojë thellimin e partneritetit dhe të realizojë idetë e tyre biznesore në Republikën e Kosovës.

Është e një rëndësie unik që ky anëtarësim po vjen në momente kur komuniteti biznesor dhe jo vetëm ai në vend dhe i huaj është duke shfaqur interes në rritje për projekte investuese që i kontribuojnë zhvillimit ekonomik dhe punësimit dhe në këtë kuadër rrjedhimisht kjo arritje na inkurajon që ne si Qeveri e Republikës së Kosovës të vazhdojmë me intensitet ndjekjen e caqeve strategjike që lidhen me zhvillimin dhe forcimin e subjektivitetit tonë ndërkombëtar.

Të nderuar deputetë,

Në emër të Qeverisë së Kosovës kërkojmë që të aprovoni Projektligjin për ratifikimin e Konventës për heqjen e kërkesës për legalizimin e dokumenteve zyrtare të huaja, Konventa apostile e datës 5.10.1961, për të proceduar më tutje sipas legjislacionit në fuqi. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Radha është e zëvendëskryetares së Komisionit Funksional, zonjës Rugova, për arsyetimin e raportit me rekomandime. Zonja Teuta Rugova e ka fjalën.

TEUTA RUGOVA: Faleminderit!

Të nderuar deputetë,

Komisioni për Punë të Jashtme, në mbledhjen e mbajtur më 25 mars 2016 ka shqyrtuar Projektligjin për ratifikimin e Konventës për heqjen e kërkesës për legalizim të dokumenteve zyrtare të huaja.

Komisioni gjatë shqyrtimit të projektligjit konstatoj se ky projektligj ka për qëllim ratifikimin e Konventës për heqjen e kërkesës për legalizimin e dokumenteve zyrtare të huaja, duke depozituar nga Republika e Kosovës instrumentin e aderimit në Konventën për heqjen e kërkesës për legalizimin e dokumenteve zyrtare të huaja më 6 nëntor 2015, pranë Ministrisë së Punëve të Jashtme të Mbretërisë së Holandës, si shtet depozitues i kësaj konvente.

Komisioni, duke vlerësuar se përmes aderimit në këtë konventë Republika e Kosovës e avancohet statusin e saj në arenën ndërkombëtare dhe thjeshtëson procedurat paraprahe të gjata të formaliteteve burokratike që obligojnë qytetarët dhe bizneset për të dëshmuar vërtetësinë e dokumenteve zyrtare të tyre, duke zëvendësuar atë me një proces të shkurtër dhe të thjeshtë, ka rekomanduar miratimin e Projektligjit për ratifikimin e Konventës për heqjen e kërkesës për legalizim të dokumenteve zyrtare të huaja. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit!

Përfaqësuesit e grupeve parlamentare. Në emër të PDK-së, a ka dikush që do të diskutojë? Zonja Deliu e ka fjalën.

BLERTA DELIU-KODRA: Faleminderit, zoti Haliti!

Projektligjin për ratifikimin e Konventës për heqjen e kërkesës për legalizim të dokumenteve zyrtare të huaja, natyrisht që është i një rëndësie të veçantë.

Komisioni për Politikë të Jashtme e ka shqyrtua dhe ne e kemi kaluar si Komision.

Po ashtu, ajo që duhet të theksohet është që përmes këtij projektligji, do të thotë, mënjanohej proceset e gjatë dhe burokratike po ashtu edhe komplekse legalizimit të dokumenteve publike, duke u zëvendësua me një proces tejet të shkurtë dhe tejet efikas.

Mendoj që si projektligj është tejet i rëndësishëm për forcimin e subjektivitetit ndërkombëtar të Kosovës dhe kërkoj nga deputetët që ta votojnë, sepse përfitimi i shtetit po ashtu do të jetë në marrëdhëniet shumëpalëshe. Kur ne si shtet do të arrijmë që të fokusohemi më tepër në investimet e huaja në Kosovë.

KRYESUESI: Faleminderit! E tha Teuta, në rregull është. Zoti Konjufca, në emër të Grupit Parlamentar të “Vetëvendosjes”.

GLAUK KONJUFCA: Ne mendojmë që kjo konventë ndërkombëtare është shumë me rëndësi për t’u ratifikua në Kuvendin e Republikës së Kosovës, por mos harroni një gjë.

U përmendën këtu edhe vulat apostile dhe ju keni pas edhe në media javën e kaluar raportime se ka keqpërdorime në Republikën e Kosovës në këtë aspekt. Pra, dokumentet e Republikës, në të cilat garanci është shteti Republika e Kosovës dhe të cilat shkojnë jashtë, për të kryer punë të ndryshme që iu duhen qytetarëve të Kosovës.

Ka dyshime dhe indicie se në Ministrinë e Punëve të Brendshme ka manipulime. Bile, ka pasur raportime që vula apostile edhe blihet në Republikën e Kosovës, kjo shumë turp për këtë Qeveri, sepse ka pasur reagime të zyrtarëve gjermanë dhe austriakë, të cilët thonë që vula apostile në Kosovë është e pasigurt, që rrjedh prej vetë institucioneve të Republikës së Kosovës.

Kjo mendoj që e ka dëmtuar procesin dhe miratimi thjesht i një konvente nuk është që e zgjidh krejt këtë problem, ka punë edhe Prokuroria, me siguri.

KRYESUESI: Faleminderit! Zoti Simiq, në emër të Listës serbe.

SLAVKO SIMIĆ: Hvala predsedavajući!

Poštovane dame i gospodo,

Narodnih poslanici,

Poštovani građani,

Poslanička grupa Srpske liste pažljivo je razmotrila Nacrtzakona o ratifikacije Konvencije ukidanju potreba za legalizaciju stranih javnih isprava.

Ako ovaj Zakon se ratifikuje, Konvencija o ukidanju zahteva za legalizaciju stranih javnih isprava od dana 5 oktobra 1961. godine.

Delokrug ovog Zakona je upravo ratifikovanje one konvencije usvojena na inicijativu Vlade Kosova kao i deponavanjem instrumenata za pristupanje Ministarstvu inostranih poslova kraljevine Holandije.

Pod toga Poslanička grupa Srpske liste daje podršku ratifikacije ove konvencije. Mi ćemo glasiti za. Hvala!

KRYESUESI: Faleminderit! Zoti Ćerim Bajrami, në emër të Grupit Parlamentar “6+”.

ĆERIM BAJRAMI: Zahvaljujem predsedavajući:

I Parlamentarna grupa “6+” je razmatrala Nacrt zakona o ratifikaciji konvencije za povlašćenje zahteva za legalizaciju stranih zvaničnih dokumenata, i dala svoj doprinos u Komisiji i glase će za ovaj predlog Zakona. Hvala!

KRYESUESI: Faleminderit! Nuk ka të tjerë deputetë të paraqitur. A kemi kuorum në sallë. Kemi 84 deputetë. A ka dikush që është pa kartelë dhe do të votojë. A i mungon dikujt kartela? Jo!

85 deputetë u bënë. Lus regjinë dhe deputetët të përgatiten për votim, votojmë tani: Faleminderit!

Atëherë për kanë votuar 83 deputetë. Në votim kanë marrë pjesë 84, një nuk ka votuar. Kundër nuk ka. Një ka abstenuar.

Konstatohet që Kuvendi miratoi Ligjin për ratifikimin e Konventës për heqjen e kërkesës për legalizim të dokumenteve zyrtare të huaja më 5 tetor 1961.

5. Shqyrtimi i Projektligjit për ratifikimin e Marrëveshjes për hua ndërmjet Republikës së Kosovës dhe Bankës Evropiane për Rindërtim dhe Zhvillim për rehabilitimin e rrugëve rajonale

Komisioni për Buxhet dhe Financa ka shqyrtuar Projektligjin për Ratifikimin e marrëveshjes për hua ndërmjet Republikës së Kosovës dhe Bankës Evropiane për Rindërtim dhe Zhvillim për rehabilitimin e rrugëve rajonale dhe Kuvendit i ka rekomanduar miratimin e tij.

Fjalën e ka zoti Abdullah Hoti, ministër i Financave, që do të paraqesë dhe do ta arsyetojë projektligjin. Zoti Hoti, e keni fjalën.

MINISTRI ABDULLAH HOTI: Faleminderit, kryesues i seancës!

Të nderuar deputetë,

Të nderuar ministra,

Programi qeverisës i Republikës së Kosovës 2015-2018, ndër të tjera synon edhe zhvillimin e mëtutjeshëm të infrastrukturës. Bazuar në këtë Qeveria po merr masa për të krijuar infrastrukturën e nevojshme, e cila kryesisht do të financohet nëpërmjet kredive të buta ose nëpërmjet partneriteteve publiko-private.

Projektligji, të cilin e keni sot përpara jush, përfshin ratifikimin e marrëveshjes për rehabilitimin e rrugëve rajonale që është objektiv i programit qeverisës. Ministria e Financave ka pranuar kërkesën nga Ministria e Infrastrukturës për financimin e këtij projekti, i cili parasheh rehabilitimin e segmentit rrugor Kllokot-Gjilan prej 17 km, dhe zgjerimin e rrugëve në hyrje të qyteteve Gjilan, Ferizaj dhe Prizren. Projekti pritet të kushtojë 29 milionë euro, ne kemi zhvilluar negociata me Bankën Evropiane për Rindërtim dhe Zhvillim dhe kemi nënshkruar marrëveshjen financiare në përputhje me Ligjin për borxhet publike në vlerë prej 29 milionë euro.

Kushtet e kredisë së negociuar janë mjaft të volitshme dhe karakterizohen me një periudhë kthimi prej 15 vjetëve, përfshirë një greis periudhë prej 3 vjetëve. Norma e interesit është 1%, plus euribori 6 mujor, i cili aktualisht është -0,14%. Kosto është mjaft e leverdishme dhe ekziston gjithashtu mundësia e fiksimit të normës së interesit.

Kjo kredi do të jetë pjesë e shpenzimeve përmes klauzolës së investimeve të dakorduar me Fondin Monetar Ndërkombëtar dhe do të përfshihet brenda kufijve të shpenzimeve të Ministrisë së Infrastrukturës. Unë ju falënderoj për vëmendje dhe ju ftoj që ta aprovoni këtë projektligj. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Zoti Naser Osmani, kryetar i Komisionit Funkcional, për arsyetimin e raportit me rekomandime. Zoti Osmani e keni fjalën!

Regjia, zotit Osmani fjalën!

NASER OSMANI: Faleminderit, kryesues!

Të nderuar deputetë,

Projektligji, respektivisht Marrëveshja për hua ka për qëllim Ratifikimin e Marrëveshjes për hua ndërmjet Qeverisë së Republikës së Kosovës dhe Bankës Evropiane për Rindërtim dhe Zhvillim për rehabilitimin e rrugëve rajonale.

Në bazë të marrëveshjes, Qeveria e Kosovës huazoi një kredi prej Bankës Evropiane për Rindërtim dhe Zhvillim për rehabilitimin e rrugëve në shumën prej 29 milionë euro. Projekti parasheh financimin e rehabilitimit të disa rrugëve rajonale në Kosovë. Rehabilitimi i rrugës nga Kllokoti deri në rrugën e Gjilanit, 17 km e gjatë, përmirësimin e rrugës hyrëse të qytetit të Ferizajt 5,6 km e gjatë, përmirësimin e rrugës hyrëse në qytetin e Gjilanit, 2,9 km e gjatë, përmirësimin e rrugës hyrëse në qytetin e Prizrenit dhe mbikëqyrjen e ndërtimit për pjesën A deri në D, domethënë për mbikëqyrjen për të gjitha këto projekte.

Kushtet financiare të huas janë shuma minimale e tërheqjes do të jetë 250 mijë euro, shuma minimale e parapagimit do të jetë 1 milion euro, shuma minimale e anulimit do të jetë 1 milion euro, data e pagesës së interesit do të jenë 15 mars, 15 shtator, të secilit vit dhe huamarrësi do të shlyejë huan në dy këste të barabarta gjysmëvjetore.

Norma e pagesës së angazhimit do të jetë 0,5% në vit. Periudha e kthimit të huas është 15 vjet me një greis periudhë prej 5 vjetëve. Projekti është pjesë e raportit të Qeverisë lidhur me klauzolën për investime siç është paraparë në nenin 22.a pika e 7 e Ligjit nr. 05/L-063 për

menaxhimin e financave publike dhe përgjegjësive dhe sipas Ministrisë së Financave do të përfshihet edhe në buxhetin e vitit 2017 dhe në kornizën e ardhshme buxhetore.

Komisioni për Buxhet dhe Financa e ka shqyrtuar marrëveshjen dhe ka ardhur në përfundim që një kredi e tillë është e mirë dhe i fton deputetët që ta përkrahin këtë ratifikim. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Zonja Demi e ka fjalën, në emër të Grupit Parlamentar të PDK-së.

LABINOTË DEMI-MURTEZI: Faleminderit, për fjalën kryesues!

Grupi ynë parlamentar mbështet Projektligjin nr. 05/L-097 për ratifikimin e Marrëveshjes për hua ndërmjet Republikës së Kosovës dhe Bankës Evropiane për rindërtim dhe zhvillim për rehabilitimin e rrugëve rajonale. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Zoti Beqiri, në emër të Grupit Parlamentar të LDK-së.

ISMET BEQIRI: Po, edhe ne si Grup Parlamentar i Lidhjes Demokratike të Kosovës mbështesim këtë projektligj dhe do të votojmë pro. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Zoti Visar Ymeri, në emër të Grupit Parlamentar “Vetëvendosje”.

VISAR YMERY: Faleminderit! Edhe Grupi Parlamentar i Lëvizjes “Vetëvendosje” do ta votojë këtë marrëveshje për kredi, por megjithatë i kemi disa çështje që mendojmë që duhet ngritur në këtë pikë.

Së pari, këtu po flasim për një marrëveshje, një kredi që synimin e ka t’i rehabilitojë disa prej rrugëve në Republikën e Kosovës që i lidhin qytetet dhe qytezat e ndryshme të Republikës së Kosovës dhe duke e pasur parasysh që kjo çështje e infrastrukturës ose investimet në infrastrukturë kanë qenë për një kohë të gjatë edhe çerdhe e korrupsionit njëkohësisht, edhe në fakt çka ndodh është që për shkak të korrupsionit këto rrugë për çdo herë e më keq po ndërtohen dhe të ndërtuara me materiale të dobëta për çdoherë e më shpesh po prishen.

Dhe, kështu ne rrezikojmë të futemi në njëfarë vorbulle të marrjes së vazhdueshme të kredive për rehabilitim të rrugëve, të cilat pastaj prapë po kërkojnë rehabilitim të pafund edhe të shpeshtë, pikërisht për shkak të korrupsionit në të.

Çështja e dytë që dua ta ngre për këtë marrëveshje konkrete është se te përshkrimi i projektit që e kemi te Shtojca 1, ku jepen domethënë pesë rrugët që do të ndërtohen, të gjitha prej këtyre rrugëve janë të përafërta në gjatësinë e tyre. Pra, thuhet që rehabilitimi i rrugës nga Klllokoti deri në rrugën e Gjilanit është 17 km, pjesa B është pastaj përafërsisht 5,6 km, pjesa C po ashtu përafërsisht 2,9 km, dhe pjesa D rreth 2,7 km. Po mendoj që kjo lloj pasaktësie po na lë edhe neve njëfarë paqartësie në atë se sa dhe çfarë rrugë dhe sa do të shtrohen. Unë nuk mendoj që është mirë të bëhet projekt kur nuk dihet së paku gjatësia e rrugës, që pastaj për t’u ditur edhe vërtet sa fonde kemi nevojë për t’i rehabilituar ato rrugë dhe sa do të kushtojë ajo rrugë.

Pra, sa është afër 2,9 km ta zëmë pjesa C.

Për fund, desha ta pyes ministrin për një çështje që nuk lidhet drejtpërdrejt me këtë, por që ka qenë çështje publike për një kohë të gjatë. E ajo, është ministër kur e keni ndërmend ta sillni marrëveshjen për autobusët në këtë formë që ta ratifikojmë në Kuvend?

KRYESUESI: Faleminderit! A po do tash Abdullah, a po do më vonë? Zoti Hoti e ka fjalën.

MINISTRI ABDULLAH HOTI: Faleminderit, zoti Ymeri për çështjen e parë që e ngritët tek Shtojca 1. Ne e nënshkruajmë marrëveshjen për 29 milionë me BERZH-in, po mandej borxhi publik rritet aq sa disporcohen mjetet dhe pagesat bëhen vetëm për punët e kryera. Kjo është vetëm marrëveshje e përafërt, sepse nuk mund t'ia qëllojmë saktë me metra sa do të ndërtohet rruga.

Ne ngarkohemi vetëm për punët e kryera dhe për disporcimin e mjeteve që ne i marrim për ndërtimin e rrugëve. Po saktë, rreth 29 km, ajo është shuma.

E dyta, për autobusët unë jam i detyruar ta zbatoj plotësisht Ligjin për borxhin publik, kam dhënë disa herë edhe sqarime publike për Komunën e Prishtinës, nëse më lejoni shkurt mund t'u jap kronologjinë e kësaj çështje, por që të gjitha çështjet janë të qartësuara tanimë. Nga shtatori i vitit të kaluar deri në janar kemi pritur për këtë çështje, kemi pasur takim me kryetarin e Komunës së Prishtinës, ka kërkuar letër me shkrim, të cilën e kemi dërguar disa ditë pas takimit, janë 11 hapa të ndryshëm prej momentit që negociohet marrëveshja deri në momentin kur disporcohen mjetet, janë kryer tre hapat e parë në shtator të vitit të kaluar, kemi mbetur te hapi i katërt që është garancia e Komunës, i Kuvendit të Komunës së Prishtinës për këtë kredi, sepse kjo kredi për autobusë merret për Trafikun Urban të Komunës së Prishtinës.

Këtë mes ne kemi kërkuar garanci siç e thotë ligji, garanci nga Komuna e Prishtinës si aksionare e qindpërqind e ndërmarrjes publike Trafiku Urban, e cili garanci nuk ka ardhur dhe ju e dini Ligji për pushtetin lokal thotë që rendi i ditës për Kuvendin Komunal bëhet në mes të kryetarit edhe kryesuesit të Kuvendit, asnjëherë nuk ka bërë kërkesë kryetari i komunës që ta fusë rend ditë këtë çështje në Kuvendin Komunal. Dhe unë jam detyruar të shkoj te kryesuesi i Kuvendit dhe t'iu kërkoj këshilltarëve komunalë që të fusin në rend ditës. Kanë pasur gatishmërinë e tyre, është kryer tani kjo çështje, nesër mbaron afati 15 ditor kur vendimi që ka marrë Kuvendi Komunal hyn në fuqi dhe pas kësaj ne menjëherë do të kalojmë te hapi i katërt ligjor.

Kryetari i komunës ka kërkuar që të kalojmë nga hapi i katërt në hapin e tetë, pa i përfillur këta tre hapa. Unë tash në bazë të këtij vendimi e dërgoj poshtë projektligjin në Qeveri, marr autorizim nga Presidenti i vendit për të nënshkruar këtë marrëveshje, pas kësaj unë e përgatis Projektligjin për ratifikimin e marrëveshjes, i cili prapë vjen në Qeveri dhe vjen në Kuvend, ku duhet të votohet me 2/3 e votave të deputetëve, njësoj sikur këto marrëveshje.

Gatishmëria e plotë e Qeverisë qëndron, edhe asnjëherë nuk është kontestuar, por janë hapa ligjorë të cilat unë nuk kam diskrecion t'i kaloj dhe t'ia plotësoj kërkesën as kryetarit të komunës, e as askujt në këtë shoqëri. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Në emër të Grupit Parlamentar Lista serbe, zoti Slavko Simiq.

SLAVKO SIMIĆ: Hvala, presedajući!

Poslanička grupa srpska liste daje podršku ovaj ovom Nacertu zakona, mi smo svoj doprinos i svoju podršku dali u Komisiji za buĎet i financija, tako da ċemo i danas dati podršku prilikom glasanja o ratifikacije ovog sporazuma. Hvala!

KRYESUESI: Faleminderit! Nē emēr tē Grupit Parlamentar “6+”, zotit Damka.

FIKRIM DAMKA: Faleminderit, i nderuar kryesues!

Edhe Grupi Parlamentar “6+” e pērkrah Projektligjin, i cili ēshtē lidhur me ratifikimin e Marrēveshjes pēr hua ndērmjet Republikēs sē Kosovēs dhe Bankēs Evropiane dhe do tē votojē pro.

KRYESUESI: Faleminderit! Fjalēn e ka zoti Zemaj.

ARMEND ZEMAJ: Faleminderit, kryesues!

Zoti ministēr, ne kemi miratuar njē mori marrēveshjesh edhe nē tē kaluarēn qē ka tē bējē me hyrjen nē hua, domethēnē ndērmjet Republikēs sē Kosovēs dhe bankave tē ndryshme.

Ajo ċka mendoj qē duhet t’i sillet Parlamentit ēshtē njē raport mbi borxhin publik edhe mbi kēto hua, edhe ne do ta kemi parasysh apo ta trajtojmē mēnyrēn se si janē trajtuar nē tē kaluarēn edhe tash nga ju si ministri, edhe pse e kemi parē, edhe e pamē edhe nga ajo qē e theksuat qē jeni tē pērkushtuar nē kētē drejtim.

Shumē rrugē, domethēnē shumē pjesē tē Kosovēs janē ndērtuar me kēto hua apo ēshtē dashur qē Kosova tē krijojē buxhet. Unē mendoj qē duhet tanimē pasi po ndērlidhet edhe pjesa e Anamoravēs, mendoj qē pjesa pēr Pejēn duhet tē jetē prioritet, vazhdimi i autostradēs apo i zgjerimit tē rrugēs. Mēnyra se si do ta zgjidhni besoj qē edhe nē kuadēr tē kēsaj mundemi tē bisedojmē, sigurisht do ta keni pērkrahjen e plotē edhe tē Kuvendit, edhe tē deputetēve, pa marrē parasysh rajonin prej nga vijnē.

Ky ēshtē mendimi im dhe kjo ēshtē mē shumē si kērkēsē, edhe pse ēshtē trajtuar ēshtē thēnē disa herē kētu nē Kuvendin e Republikēs sē Kosovēs. Sa i pērket autobusēve ēshtē mirē tē mbyllen gropat njēherē nēpēr qytetin e Prishtinēs, tani tē sillen autobusēt, sepse mund tē prishen shumē shpejt edhe krijohet dēm edhe nē taksat e qytetarēve tē vendit. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Zonja Pantina e ka fjalēn.

SHQIPE PANTINA: Mē shumē ēshtē njē sqarim ndoshta qē duhet ta japē ministri, edhe pse nē dukje tē parē duket mund tē jetē edhe ċēshtje teknike, por ‘djalli fshihet nē detaje’, kēshtu qē nuk e dimē nēse ēshtē problem teknik apo jo.

Nē versionin nē gjuhēn shqipe dhe po ashtu nē atē serbo-kroate, nē faqen e parē ēshtē njē citat ku thotē: “Kjo draft-marrēveshje e huas ēshtē pērgatitur vetēm pēr qēllimet e diskutimit paraprak. Mund tē ekzistojnē marrēveshje shtesē dhe teksti ekzistues mund t’i nēnshtrohet ndryshimit dhe miratimit pērfundimtar nga Banka Evropiane pēr Rindērtim dhe Zhvillim”. Tash a ēshtē kjo

thjesht diçka teknike që ju keni harruar ta fshini, apo nëse ekziston kjo atëherë deri në çfarë mase mund të pësojë kjo marrëveshje ndryshime dhe a e prek substancën e marrëveshjes.

KRYESUESI: Faleminderit! Zoti Konjufca e ka fjalën.

GLAUK KONJUFCA: Kryesues, është vështirë në Prishtinë të mbyllen krejt gropat e Isa Mustafës. Prej 15 mijë sa i ka lënë ai, Shpend Ahmeti i ka mbyllur nga 10 mijë, por edhe nga 5 mijë na kanë mbetur, do t'i mbyllem të gjitha, me siguri.

KRYESUESI: Zoti ministër, e keni fjalën.

MINISTRI ABDULLAH HOTI: Faleminderit, kryesues!

Po i përgjigjem fillimisht zonjës Pantina, deputetes Pantina.

Marrëveshja që e ratifikojmë këtu i parasheh kushtet kryesore dhe kushtet financiare, të cilat janë të panegociueshme pasi të aprovohen në Kuvendin e Kosovës. Por normalisht nga kjo marrëveshje derivojnë marrëveshje të tjera teknike për afatin e disporcimit, cila rrugë ndërtohet e para, përgatitja e projekteve detale që janë çështje krejt teknike, por ne nuk kemi autorizime që t'i prekim ato kushte të kësaj marrëveshjeje që ratifikohet këtu në Kuvend.

E dyta, deputetit Zemaj lidhur me raportimin për borxhin publik, edhe tash për borxhin publik që shkon përmes klauzolës së investimeve. Raporti për borxhin publik është pjesë e raportit financiar vjetor që dorëzohet në Kuvendin e Kosovës. Sivjet kemi përfshirë më shumë informata sesa që kanë qenë më përpara. Unë e informoj Qeverinë dhe Komisionin për Buxhet dhe Financa në baza tre mujore për këtë çështje. Sa i përket raportimit për këtë marrëveshje që e aprovuam sot, që është pjesë e klauzolës së investimeve. Tani është me Ligjin për financat publike që ne çdo 6 muaj, me raport të shkruar, e informojmë Kuvendin për mënyrën se si po shfrytëzojnë këtë pjesën e klauzolës së investimeve për të financuar projekte, për t'u siguruar që shkojnë vetëm projekte kapitale dhe që janë në të mirë të ekonomisë dhe rritjes së punësimit në vend.

Dhe e fundit, rrugën për Pejë jemi duke e finalizuar bisedat me BERZH-in, dhe shpejt di e sjellim edhe atë marrëveshje këtu në Kuvendin e Kosovës për ndërtimin e rrugës nga Kijeva deri në Zahaq apo deri në Pejë, tash varësisht prej ministrit të Infrastrukturës se si i finalizojnë çështjet teknike. Po besoj se është çështje javësh ose muajsh kur ne do ta sjellim edhe atë marrëveshje për të kompletuar edhe këtë çështje të asaj ane të Kosovës në kryeqendër. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Nuk ka tjerë të paraqitur. Në sallë janë 84 deputetë, lus regjinë dhe deputetët të përgatiten për votim. Votojmë tani!

Faleminderit! Me 82 vota, asnjë kundër, asnjë abstenim, konstatoj që Kuvendi miratoi Ligjin për ratifikimin e marrëveshjes për hua ndërmjet Republikës së Kosovës dhe Bankës Evropiane për Rindërtim dhe Zhvillim për rehabilitimin e rrugëve rajonale.

6. Shqyrtimi i Projektligjit nr. 05/L-098 për ratifikimin e Marrëveshjes financiare ndërmjet Qeverisë së Republikës së Kosovës dhe Bankës Evropiane për Investime për projektin e rehabilitimit të linjës hekurudhore 10

Komisioni për Buxhet dhe Financa e ka shqyrtuar Projektligjin për ratifikimin e Marrëveshjes Financiare ndërmjet Qeverisë së Republikës së Kosovës dhe Bankës Evropiane për Investime për projektin e rehabilitimit të linjës hekurudhore 10, dhe Kuvendit i ka rekomanduar miratimin e tij. Ftoj zotin Hoti, ministër i Financave, që ta paraqesë dhe ta arsyetojë projektligjin. Zoti Hoti, e keni fjalën.

MINISTRI ABDULLAH HOTI: Faleminderit, nënkryetar i Kuvendit!

Të nderuar deputetë,

Të nderuar ministra,

Programi i Qeverisë i Republikës së Kosovës për 2015-2018 synon që nëpërmjet bankave zhvillimore të financojmë rehabilitimin e linjës 10 të hekurudhës, e cila mundëson transport të lirë për qytetarët dhe mallrat.

Po ashtu, vendi ynë duhet të përqendrohet në zhvillimin e projekteve që na lidhin me infrastrukturën tjetër në rajonin e Ballkanit Perëndimor. Bazuar në këto orientime, projektligji që keni përpara mbi marrëveshjen për realizimin e projektit të linjës hekurudhore 10, kontribuon në realizimin e këtyre qëllimeve. Projekti parashihet të kushtojë 195.5 milionë euro, përfshirë këtu edhe TVSH-në.

Me miratimin paraprak të Qeverisë, ne kemi zhvilluar negociata me kreditorë dhe donatorë të ndryshëm për gjetjen e fondeve për këtë projekt dhe si rezultat ne kemi arritur të kompozojmë burime të ndryshme të financimit për shumën e kërkuar për këtë projekt.

Ky projekt do të bëjë rehabilitimin dhe modernizimin e linjës hekurudhore që përshkon Kosovën nga kufiri jugor me Maqedoninë, nga Hani i Elezit, deri në kufirin verior me Serbinë në Leshak dhe njëkohësisht paraqet investimin më të madh të bërë ndonjëherë në rrjetin hekurudhor. Kredia me Bankën Evropiane për Investime paraqet një pjesë të financimit të nevojshëm për këtë projekt në vlerë prej 42 milionë euro. Kjo kredi do t'i shtohet financimit të mëparshëm që tanimë e kemi siguruar prej 39,9 milionë euro me Bankën Evropiane për Rindërtim dhe Zhvillim, ndërsa pjesa tjetër pritet të vijë nga fondet e IPA-s dhe kontributi nga buxheti përmes taksave, TVSH-së dhe pjesës tjetër.

Kushtet e kredisë janë mjaft të volitshme, me një periudhë kthimi deri në 25 vjet, përfshirë një greis periudhë prej 4 vjet. Norma e interesit do të jetë 1% plus euribori 6-mujor që momentalisht -0,14%, pra po flasim për një normë reale të interesit prej vetëm 0,86%. Kredia nga Banka Evropiane për Investime do të transferohet tek "Infra Kos" në formë të transferim të kapitalit dhe është pjesë e klauzolës së investimeve bazuar në marrëveshjen që kemi me Fondin Monetar Ndërkombëtar dhe hyn brenda kufijve të shpenzimeve që ka Ministria e Infrastrukturës.

Unë ju falënderoj për vëmendje dhe ju ftoj që ta aprovoni këtë projektligj. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit, zoti ministër! Fjalën e ka zoti Naser Osmani, kryetar i Komisionit Funksional për arsyetimin e raportit me rekomandime.

NASER OSMANI: Faleminderit, kryesues!

Në bazë të marrëveshjes Qeveria merr hua në vlerë prej 42 milionë euro, në fakt, realizimi i projektit për rehabilitimin e linjës hekurudhore 10, kap shumën totale 195,5 milionë euro.

Për financimin e projektit, përveç shumës 42 milionë euro që tani po e diskutojmë, deri më tani kemi ratifikuar edhe një kredi prej 39,9 milionë euro me BERZH-in dhe pjesa tjetër e fondeve për realizimin e këtij projekti është duke u negociuar me Bashkimin Evropian në kuadër të IPA fondeve.

Një pjesë e financimit do të jetë nga participimi prej Buxhetit të Kosovës. Pjesa e mjeteve të kredisë do të huazohet nga Qeveria te kompania "Infra Kos", si implementuese përgjegjëse e projektit. Kushtet e kredisë janë ato, të cilat i tha edhe ministri pak më parë. Kredia është pjesë e shpenzimeve të klauzolës për investime dhe do të jetë pjesë e buxhetit për vitin 2017-2019. Komisioni, duke marrë në konsideratë rëndësinë e projektit, si një ndër projektet më të mëdha kapitale që realizohet në infrastrukturën hekurudhore, konsiderojmë që kjo kredi është e arsyeshme dhe i rekomandon deputetët për votim. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Fjalën e ka, në emër të Grupit Parlamentar të Partisë Demokratike, zonja Labinotë Demi. Regjia, shtype!

LABINOTË DEMI-MURTEZI: Faleminderit, i nderuar kryesues!

Edhe grupi ynë parlamentar mbështet Projektligjin për Ratifikimin e Marrëveshjes financiare ndërmjet Qeverisë së Republikës së Kosovës dhe Bankës Evropiane për Investime për projektin e rehabilitimin të linjës hekurudhore 10. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Zoti Slavko Simiq në emër të Grupit Parlamentar Lista serbe.

SLAVKO SIMIĆ: Hvala, presedajući!

Poslanička grupa Srpska lista podržava ovaj narct zakona, mi smo svoju podršku dali za Komisiju za budet i financije i podržavaćemo i danas. Hvala!

KRYESUESI: Faleminderit! Zoti Visar Ymeri, në emër të Grupit Parlamentar "Vetëvendosje".

VISAR YMERI: Faleminderit!

Këtu tash e kemi një marrëveshje, e cila e fut Kosovën në një borxh më të madh, se ajo paraprakja. Po flitet për diku rreth 80 milionë, pak mbi 80 milionë, për rehabilitimin dhe modernizimin e një prej linjave hekurudhore të Republikës së Kosovës dhe këtu, natyrisht, se zgjohen disa pyetje.

Së pari, mendoj që në përgjithësi prioritetizimi që po i bën Qeveria e Republikës së Kosovës edhe kjo qeveri, do të thosha, sikur ajo e kaluara, është i gabuar. Nëse i marrim, ta zëmë, ankesat që i kanë prodhuesit vendorë, gjithkund në ankesat e tyre në një pikë të lartë të prioritetëve, që ata mendojnë se duhet t'i kemi si ekonomi, është energjia elektrike, furnizimi i rregullt me energji

elektrike. Ndërkohë, që krejt që u ofrohet nga Qeveria është vetëm infrastrukturë transportuese, e cila është e nevojshme, mos më keqkuptoni, edhe e domosdoshme për zhvillimin ekonomik, por ka njëfarë rendi të gjërave dhe ky rend i gjërave po përmbysset, po kthehet kokëposhtë nga kjo Qeveri. Vazhdimisht, është thënë se ne nuk kemi para të investojmë në rehabilitimin, rindërtimin, ose ndërtimin e termocentralit të ri, ndërkohë që shpenzojmë miliarda nëpër rrugë e prapë 17 vjet pas luftës ne nuk kemi furnizim të rregullt me energji elektrike. Dhe, kjo po shkakton kokëçarje të madhe edhe ekonomike, po qe besa edhe të amvisërive në Republikën e Kosovës.

Dhe, jemi në këtë pikë ku jemi, prapë po diskutojmë për një projekt, i cili nuk ka të bëjë fare me energjinë, ndërkohë që kriza energjetike na ka ardhur gati se te dera dhe do të ballafaqohemi me të shumë shpejt dhe në mënyrë shumë të keqe.

Sidoqoftë, po i kthehem marrëveshjes. Kjo marrëveshje për kredi është e varur, me sa kam arritur ta lexoj, nga sigurimi i investimit në tërë linjën 10, e cila një pjesë të hekurudhës e ka në pjesën veriore të Kosovës dhe në këtë drejtim, kjo paraqet një lloj, do të thosha, ose do ta pyetsha mbase edhe ministrin, nëse ky mendon se kjo do të paraqiste një lloj rreziku të implementimit të këtij projekti, duke pasur parasysh gjendjen atje dhe mungesën e shtrirjes dhe pranisë së institucioneve të Republikës së Kosovës në pjesën veriore.

Pra, ministër, siç të kanë bllokuar ty më herët, a ka rrezik që ta bllokojnë edhe realizimin, ose zbatimin e projektit, edhe në atë pjesë, për strukturat paralele të Serbisë, natyrisht, po flas.

Në anën tjetër, që në faqen e parë, pra që në titullin e kësaj marrëveshjeje, kemi një situatë, do të thosha, absurde, sepse kjo kontratë është e nënshkruar, në mes, siç thuhet këtu në gjuhën angleze “Kosovës” me asterisk, pra me atë “fjollën e borës”, që nuk po shkrihet pavarësisht temperaturave dhe Bankës Evropiane për Investim. Dhe pastaj, kjo shpjegohet më poshtë, natyrisht, se çfarë nënkupton kjo “fjolla”. Dhe natyrisht, thuhet ky teksti që e kemi dëgjuar dhe lexuar shumë shpesh, i cili thotë, se “kjo nuk paragjykon statusin e Kosovës, ose pozicionin mbi statusin e Kosovës dhe...”, se në njëfarë mënyre Kosova është edhe nën Rezolutën 1244, edhe sipas vendimit të Gjykatës Ndërkombëtare të Drejtësisë, sa i përket shpalljes së Pavarësisë. Pra, praktikisht, Banka Evropiane për Investim këtu po na thotë, që nuk e ka të qartë me kë po e nënshkruan marrëveshjen, pra nuk po di se kujt po i jep kredi. Edhe këtu krijohet njëfarë situatë absurde, pra po i jep Kosovës së 1244-shit, apo Republikës së Kosovës.

Mendoj, se ky absurditet që po na vjen me këto koncesione ndaj Serbisë, përveçse është shumë i rrezikshëm për vendin, shpeshherë po na bëhet edhe qesharak. Sidoqoftë, Lëvizja “Vetëvendosje” do të abstenojë në këtë marrëveshje, jo pse nuk mendojmë që Hekurudha duhet të modernizohet, por për shkak të këtyre... si të them kështu, klauzolave politike, të cilat për ne janë të papranueshme. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Zoti Fikrim Damka e ka fjalën në emër të Grupit Parlamentar “6+”.

FIKRIM DAMKA: Faleminderit, i nderuar kryesues!

Edhe Grupi Parlamentar “6+” e përkrah Projektligjin për ratifikimin e marrëveshjes financiare ndërmjet Republikës së Kosovës dhe Bankës Evropiane, lidhur me rehabilitimin e linjës hekurudhore. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Fjalën e ka kërkuar zoti Ismet Beqiri.

ISMET BEQIRI: Zoti kryesues!

Në qoftë se, s’ka dakordim të të gjitha grupeve për ta votuar, ose ratifikuar një marrëveshje të tillë, unë kërkoj që të shtyhet kjo, të hiqet, votimi të mos bëhet sot. Ne kemi të drejtë si grup, sepse abstenimi apo mosvotimi i saj, domethënë është fakti që s’kalon dhe ne atëherë duhet ta shtyjme për një tjetër seancë.

KRYESUESI: Unë kam obligim propozimin tuaj ta qes në votim. Kështu që... Atëherë, kemi kërkesën e Grupit Parlamentar për ta shtyrë votimin për seancën e ardhshme, për shkak se një pjesë e deputetëve, të cilët do të bënin kuorumin e plotë, nuk është. Grupi Parlamentar i “Vetëvendosjes” është deklaruar që do të abstenojë nga vendimi, kështu që nuk plotësohet kuorumi për të votuar. Kush është që ta shtyjme për seancën e ardhshme?

Atëherë, konstatoj se shumica janë që kjo pikë e rendit të ditës të shtyhet për seancën e ardhshme. Është shtyrë vetëm për votim, jo për diskutim.

7. Shqyrtimi i dytë i Projektligjit për Agjencinë Kosovare për Krahësim dhe Verifikim të Pronës

Kuvendi në seancën plenare të mbajtur më 25 maj 2016 e ka shqyrtuar Projektligjin për Agjencinë Kosovare për Krahësim dhe Verifikim të Pronës dhe i ka miratuar amendamentet e propozuara 1, 3, 4, 5 dhe 6. Ndërsa, në mungesë të kuoromit për vendimmarrje ka mbetur pa u miratuar amendamenti numër 2 dhe teksti i projektligjit me amendamentet e miratuara.

Me propozim të zëvendëskryeministrit, zotit Shala, procedimi i mëtejshëm i këtij projektligji është shtyrë për seancën e sotme, andaj në seancën e sotme procedoj vetëm me votimin e amendamentit numër 2 dhe të tekstit të projektligjit në tërësi me amendamentet e miratuara. E hedh në votim.

Ju, meqenëse s’keni qenë, jeni të lirë për t’u deklaruar, jo për këtë, por për secilin amendament e drejta për t’u deklaruar është për amendamentin dhe...

Për amendamentin numër 2 mund të diskutoni. Fjalën e ka zonja Albulena Haxhiu, për të diskutuar për amendamentin numër 2.

ALBULENA HAXHIU: Faleminderit!

Për të katërtën herë po e marr fjalën në Kuvend për këtë projektligj, ndonëse jo edhe herën e fundit, sepse s’kemi qenë këtu si opozitë. Thënë të drejtën, nga Komisioni për Legjislacion, ku opozita në atë kohë s’ka marrë pjesë në punimet e atij komisioni, të paktën kam shpresuar, që ndoshta ndonjë amendament më cilësor e bëni, bre. 6 amendamente, 6 amendamente teknike, është Administrata e Kuvendit që bën amendamentet teknike dhe jo Komisioni për Legjislacion.

Komisioni është dashur që të verifikojë bazën kushtetuese ligjore dhe jo të merret, thjesht, me teknikitet të ndryshme, që i kanë propozuar edhe amendamentet këtu.

Dhe, meqë është e katërta herë që ky projektligj na vjen në Kuvend, mua më duhet t'i them fjalët që i kemi thënë edhe më përpara, sa i përket këtij projektligji.

Ne si grup parlamentar jemi kundër këtij projektligji, për faktin se i njëjti derivon nga një marrëveshje në njërën prej raundeve të bisedimeve, e cila ka pasur për qëllim marrjen e kopjeve kadastrale nga Serbia. Pra, po flasim për kopjet e regjistrave kadastralë dhe jo për origjinalin e dokumenteve kadastrale.

Pra, ky është një nënshtrim i ri karshi Serbisë, ashtu sikur ka bërë Qeveria në të gjitha marrëveshjet tjera. Po e quaj kështu, sepse për një shtet normal, për një shtet sovran, si ky projektligj, ashtu edhe agjencia që themelon, janë të panevojshme. Ky projektligj është rrjedhojë dhe e formalizon pranimin kadastral, apo të themi “pranimin kriminal”, që librat kadastralë të Kosovës t'i mbajë Serbia. Është kriminal, pasi që Serbia i ka vjedhur librat kadastralë, i ka plaçkitur librat kadastralë, jo marrë, siç thotë një nen i këtij projektligji.

Pra, përveç kësaj, problemi qëndron edhe tek neni 5 i këtij projektligji, sepse në paragrafin 2 të tij, thuhet se bordi mbikëqyrës përbëhet nga pesë anëtarë, tre nga këta zgjidhen nga përfaqësuesi special i Bashkimit Evropian. Kjo dispozitë bie në kundërshtim edhe me Kushtetutën e Kosovës, por edhe ligjin që e ka votuar ky Kuvend, për përfundimin e pavarësisë së mbikëqyrur. Domethënë, po krijoni ligje, ku po instaloni përfaqësues ndërkombëtar, përveç tjerash, dhe mandej çfarë katrohure jeni duke instaluar në një shtet, siç po e quani “sovran”. Njësoj vlen edhe tek neni 8, paragrafi 2, ku thuhet se Komisioni për Kërkesa Pronësore përbëhet nga 3 anëtarë, 1 emërohet nga Kuvendi dhe 2 të tjerë janë ndërkombëtarë.

Po ashtu, lehet e paqartë se çfarë ndodhë në rastet, kur hasen mospërputhje ndërmjet kopjeve dhe regjistrave origjinalë. Domethënë, ky komision nuk obligohet të marrë për bazë vendimet përfundimtare të institucioneve gjyqësore dhe administrative.

Domethënë, për këto arsye Grupi Parlamentar i Lëvizjes “Vetëvendosje” nuk do ta përkrahë, sepse është e paprecedent për një shtet, që të mos ketë regjistrin historik të evoluimit të transaksioneve pronësore. Me këtë aranzhim të kompletimit të Regjistrit Kadastral shqiptarët rrezikojnë, që prapë t'u merren pronat e tyre, të cilat i kanë blerë dhe paguar më shumë se një herë. Domethënë, unë e di që kjo po i dhemb zotit Zemaj, por problemi është te ai, që s'e ka marrë mundin me i shikua, jo në aspektin politik, se s'pres prej teje që ta bësh një gjë të tillë, por në aspektin kushtetues. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Është lajmëruar, tash për replikë, zoti Zemaj... apo u habite... lëre njëherë... Mirë, Zoti Zemaj, replikë!

ARMEND ZEMAJ: Kryetar,

Projektligji e ka historinë e vet. Domethënë, nga legjislatura e kaluar që një vit është në procedurë. Mendoj që është dhënë maksimumi edhe në bashkëpunim edhe me aktorët e brendshëm dhe të jashtëm. Ata që kanë dashur të punojnë e kanë pasur mundësinë, ata që për

arsye patriotike e kanë bojkotuar me të mirat materiale Kuvendin e Kosovës, e kanë pasur mundësinë që të vijnë të punojnë. Kështu që, ne e përkrahim për arsye që janë më madhore, se sa këto politike apo t'i quaj edhe "populliste".

KRYESUESI: Faleminderit! Fjalën e ka zonja Jasmina Zhivković.

JASMINA ŽIVKOVIĆ: Zahvaljujem predsedavajući!
S obzirom da ste dozvolili...

(Ndërhyrje nga salla)

... debatu, ja ću pokušati da objasnim još jednom zabrinutosti vezane za ovaj nacrt zakona.

Komisija za zaštitu prava i interese zajednica i povratak nije podržala ovaj nacrt zakona i sadržinu ovog nacrta zakona i Poslanička grupa Srpske liste nije takođe neće podržati ovaj nacrt zakona. Pre svega zato što ovaj nacrt zakona, zapravo sadržina ne odražava ono što je dogovoreno u Briselu i ono što treba biti u interesu svih građana na Kosovu, kako većinske tako i Srpske, tako i svih ostalih zajednica. Sadržinom ovog nacrta zakona ne garantuje se ravnopravnost u odlučivanju kada je reč o privatnoj imovini, o privatnoj, komercijalnoj i imovini, koja pripada verskim objektima. Ono što trebalo bi biti osnova i ono što bi trebalo biti polazno, jeste da u tom odlučivanju o privatnim licima i o svim građanima na Kosovu, makar bude zagarantovana ravnopravnost u tim bordovima, bez favorizovanja ijedne zajednice i bez ostavljanja mogućnosti da dođe do malverzacije i iskorišćavanje položaja agencija.

Smatramo a je neophodno da se još uvek radi na nacrtu ovog zakona i da budu uključene sve zainteresovane strane u ravnopravnom položaju. Hvala!

KRYESUESI: Faleminderit! Zonja Lama e ka fjalën.

ALMA LAMA: Faleminderit, i nderuar kryesues!

E pash me rëndësi, pas këtyre diskutimeve që dëgjova këtu, të ndërhyj pak për këtë çështjen e kopjes së regjistrave kadastralë, sepse Kosova dhe Serbia janë ndarë me luftë dhe kur dy shtete ndahen me luftë, është më se e pritshme, që në periudhën e pasluftës gjërat të mos shkojnë vaj, por konflikti të vazhdojë, ndonëse jo me armë.

Për njohurinë tuaj si deputet, por edhe të qytetarëve të Kosovës, Turqia si trashëgimtare e Perandorisë Osmane, e cila ishte pushtuese në Shqipëri, vetëm tani para një viti ia kishte mundësuar Shqipërisë qasjen në regjistrat kadastralë, në dokumentet kadastrale, 100 vjet pas. Kështu që, mendoj se megjithatë Kosova duket pak më me fat në këtë raport, sepse mundësia për të pasur qasje në këto regjistra po më duket pak më e shpejt. Natyrisht, kjo jo për shkak të aftësisë së Kosovës, por për shkak të rrethanave, në të cilat gjendet, për shkak të presionit të Bashkimit Evropian, e të tjerë. Kështu që, unë nuk e shoh aq zi këtë situatë, është jashtëzakonisht... do të ishte shumë, shumë më mirë, që të gjitha dokumentet që Serbia i ka marrë në Kosovë, të gjitha paratë, të gjitha pensionet, dëmshpërblimet e luftës, e tjerë... të gjitha t'i kthejë. Dhe, ky është një proces që duhet të vazhdojë. Mendoj, se Kosova duhet të jetë shumë

këmbëngulëse në këtë çështje, por e konsiderova me rëndësi ta them këtë për çështjen e regjistrave. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Zonja Osmani e ka fjalën.

ALBULENA OSMANI: Dy fjalë rreth marrëveshjes së Brukselit për çështjen e kadastrave.

Është me rëndësi të thuhet në këtë Kuvend, sidomos pas deklarimeve që i dëgjuam pak më herët, që kjo marrëveshje pasi u arrit në Bruksel u shpall kundërkushtetuese nga Gjykata Kushtetuese e Serbisë. Kjo nënkupton që Serbia, lëre që nuk ka marrë mundin që ta implementojmë këtë marrëveshje nga ana e saj, sepse edhe është bilaterale dhe duhet të implementohet nga të dyja palët, jo vetëm nga Kosova, por e ka një vendim të Gjykatës Kushtetuese, që po që se i dëgjoni zyrtarët e lartë politikë nga Serbia, ata thonë “edhe po të donim ne ta implementojmë, nuk mundemi, sepse gjykata jonë kushtetuese këtë marrëveshje e ka shpallur kundërkushtetuese”. Pra, sipas të drejtës ndërkombëtare, kur njëra palë tërhiqet nga implementimi i marrëveshjeve, automatikisht i jep të drejtë edhe palës tjetër, që të mos e implementojë.

Në qoftë se, flasim për mosimplementimi, pra duhet së pari të flasim për qëndrimin që ka mbajtur Serbia deri tani, sa u përket kadastrave, duke mos e kthyer origjinalin në Kosovë. Dhe, pse është me rëndësi që ato të kthehen? Jo vetëm si parim i të drejtës pronësore, por edhe ka të bëjë me çështjen që po diskutohet jashtëzakonisht shumë kohëve të fundit, pra ajo e demarkacionit, sepse në qoftë se, merret parasysh vetëm parimi kadastral për përcaktimin e kufirit apo demaskimin e kufirit me një shtet, atëherë i njëjti parim do të duhej, pas një kohe, të përdoret edhe për përcaktimin e kufirit me Serbinë, kurdo që ndodhë ai. Dhe, këtu do të vijë në shprehje rëndësia e këtyre kadastrave, sidomos origjinalet.

KRYESUESI: Faleminderit! Nuk ka të tjerë për t’u deklaruar.

Atëherë, votojmë amendamentin e dytë të riformuluar nga zëvendëskryetarja e Komisionit Funkcional, zonja Halimi, në seancën plenare më 25 maj 2016. Bëhemi gati për votim. Votojmë tani!

Atëherë, konstatoj që në votim kanë marrë pjesë 73 deputetë, për janë 50 vota, kundër 18 dhe kanë abstenuar 5 deputetë. Me këtë konstatoj që Kuvendi e miratoi Ligjin...

(Ndërhyrje e sekretarit)

Mirë, atëherë votojmë tekstin e projektligjit në tërësi me amendamentet e miratuara. Votojmë tani!

Faleminderit! Konstatoj që me 51 vota për, 18 kundër, 7 abstenime, Kuvendi e miratoi Ligjin për Agjencinë Kosovare për Krahësim dhe Verifikim të Pronës.

8. Shqyrtimi i dytë i Projektligjit për falimentimin

Komisionet parlamentare kanë shqyrtuar Projektligjin për falimentimin dhe Kuvendit i kanë rekomanduar miratimin e tij me amendamentet e propozuara. Ftoj kryetarin e Komisionit Funksional, zotin Muhamet Mustafa, që të paraqesë dhe arsyetojë raportin me rekomandime. Zoti Fatmir, e keni fjalën. A je paraqitur?

FATMIR REXHEPI: Faleminderit, kryesues!

Komisioni Funksional në mes të dy leximeve të këtij projektligji nga 15 marsi, besoj që ka bërë një punë të mirë dhe i ka ofruar Parlamentit versionin përfundimtar, bashkë me amendamentet, duke përfshirë kështu një debat dhe diskutim brenda kësaj periudhe me të gjitha ato institucione dhe grupe të interesit. Por, të njëjtën kohë, vlerësojmë se brenda kësaj periudhe, në këto amendamente, përfshihen dhe adresohen saktë të gjitha autoritetet, procedurat lidhur me Ligjin për falimentimin, i cili ka një rëndësi të veçantë për shoqëri tregtare, kur hyjnë në këtë proces.

Prandaj, ne i kemi dhënë diku rreth 59 amendamente, për të cilat kemi marrë opinionet e komisioneve parlamentare, të cilat i kemi para vetes, por sugjerimi im në emër të komisionit është, që i vetmi ndryshim që duhet bërë, është te amendamenti 42 dhe atë te paragrafi 8.1. Kur të vijë koha, ne do të kemi propozimin, në mënyrë që të merret parasysh gjatë votimit. Për të gjitha amendamentet tjera, nuk kemi vërejtje. Është një përmirësim, i cili duhet bërë. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Zoti Topalli është paraqitur.

FATON TOPALLI: Faleminderit, kryesues!

Ne e kemi shqyrtuar ligjin në Komitetin tonë për ekonomi. Në përgjithësi, Projektligji për falimentimin është në rregull dhe vërehet se kemi të bëjmë me një projektligj, që është përkthyer nga versioni i ndonjë shteti tjetër, unë shpresoj të jetë nga ndonjë version i Bashkimit Evropian.

Për tu përshëndetur është edhe përcaktimi i sponsorizuesit të projektligjit, që gjatë përmbushjes së kërkesave të pasiguruara t'i jepet përparësi obligimeve të dala nga marrëdhëniet familjare dhe nga marrëdhëniet e punës, në raport me obligimet eventuale ndaj Administratës Tatimore të Kosovës.

Më poshtë do të nxjerr disa të gjetura, të cilat kanë nevojë për ndryshime apo ndërhyrje.

Unë shoh hapësirë për intervenime te nenet, që i trajtojnë ndërmarrjet e vogla dhe të mëdha, duke filluar nga vetë definimi i një ndërmarrjeje të vogël apo të madhe e drejt tek procedura lehtësuese për falimentimin e tyre.

Nuk mund të definohet një ndërmarrje e vogël apo e madhe ndryshe, në secilin ligj, meqë në një situatë të tillë e njëjta kompani për nevojat e një ligji mund të kualifikohet si ndërmarrje e madhe, ndërsa për nevojat e një ligji tjetër, si ndërmarrje e vogël.

Po ashtu, mendoj se në rastet e ndërmarrjeve të vogla dhe të mëdha, do të duhej që lehtësirat të nënkuptojnë edhe mundësinë e përshpejtimit të procedurës dhe njëkohësisht minimizim të kostos

administrative të krijuar nga monitoruesi apo administratorët. Për mua, është konfuz edhe neni 22, që ka të bëjë me mundësinë që gjykata të refuzojë kërkesën për inicim të procedurës së falimentimit, meqë këtu në këtë nen thuhet si vijon: “Gjykata e hedh poshtë si të palejueshme kërkesën për inicim të procedurës së falimentimit, nëse Gjykata nuk ka kompetencë, debito...” , kjo është pika 1.1 dhe 1.2. “... debitori nuk është i përshtatshëm për të qenë debitor sipas këtij ligji.”

Projektligji, po ashtu ka nevojë për ndërhyrje në editim, në mënyrë që të evitohen gabimet gjatë përkthimit nga versioni origjinal. Po sjell më poshtë vetëm një shembull, ku krijohet përshtypja se përkthimi është bërë me “google”. “Neni 79, procedurat për propozim të planit, shpалosjet...” Pra, është krejt e pakuptimtë.

Njëjtë duhet të veprohet edhe me gabimet logjike, që janë përvjedhur disa sosh, mbase edhe teknike, por që mund të ndikojnë gjatë implementimit të ligjit. Po ua sjell më poshtë vetëm një shembull, ku shihet paqartësi në formulim. “Neni 89, Shkarkimi i administratorit - Nëse gjykata e sheh të nevojshme dhe të arsyeshme ajo vendos për shkarkimin e administratorit nga rasti konkret.

Pika 2, arsye për shkarkim, sipas këtij ligji konsiderohet, por nuk kufizohet vetëm në të. E kjo është e pakuptimtë, edhe në kuptimin logjik.

Dëshmi se administratori nuk i plotëson kualifikimet sipas nenit 89 të këtij ligji, ose së pari vetëm emërimi i administratorit do të duhej të ishte i pamundshëm pa verifikimin e kualifikimit të tij dhe, së dyti, nuk mund të shkarkohet një administrator me një nen që, duke u thirrur në kushtet e po të njëjtit nen, në fakt, neni 89 nuk parasheh apo liston kushtet e kërkuara për t’u kualifikuar si administrator.

Një vërejtje tjetër serioze të Projektligji, është se shihet dëshira e sponsorizuesit që asgjë të mos jetë e limituar dhe e precizuar.

Në fakt, në shumicën e rasteve ku përcaktohen hapat, procedurat apo limitimet, neni fillon me konstatimin “përveç në rast kur parashihet ndryshe me këtë ligj”, ose “përveç në rastet kur gjykata vendos ndryshe”.

Përmes këtyre ndërhyrjeve, në fakt, mundësohet mosrespektimi i ligjit, i gati secilit kushtëzim eventual të paraparë në ligj.

Krejt në fund, Projektligji në formën e tanishme rrezikon të bëhet i paimplementueshëm për rrethanat e Kosovës, qoftë përmes deficiteve në sistemin gjyqësor të vendit, si rrjedhojë e gjykatave të stërngarkuara dhe lehtësisht të korruptueshme, por edhe nga nevojat për administratorë, ekspertë apo monitorues, përmes të cilëve do të tejkaloheshin kapacitetet ekzistuese në vend. Mbase, sponsorizuesi është dashur të kujdeset edhe për përshtatjen e versionit të përzgjedhur me rrethanat në të cilat operon komuniteti i biznesit në Kosovë.

Si përfundim, Lëvizja “Vetëvendosje” ka gatishmëri ta votojë këtë projektligj, nëse merren parasysh vërejtjet e Grupit tonë Parlamentar.

KRYESUESI: Faleminderit! Unë shpresoj që vërejtjet tuaja janë me vend, por ne e kemi kaluar procedurën e amendamentimit, kështu që kohë ka prapë për të bërë amendamente të reja. Do të thotë, propozimet tuaja janë në kuadër të diskutimit. Urdhëroni, edhe për një sekondë.

FATON TOPALLI: Shikoni! Këtu ka gabime të tilla, të cilat e vështirësojnë implementimin e ligjit. Ka gabime logjike, ka gabime në përkthim dhe për këtë arsye propozoj që kjo pikë të shtyhet për mbledhjen e ardhshme apo pas dy-tri mbledhjeve të tjera të Kuvendit për arsye, thjesht për t'i korrigjuar gabimet që janë bërë. Pra, të shkojë në lexim të tretë. Ne në parim jemi për votimin e ligjit, por këto përmirësime do të duhej të bëheshin.

KRYESUESI: Këto që i the janë shumica çështje më shumë të korrekturës që duhet t'i bëjë një grup specialistësh ose lektorësh të gjuhës, atëherë të bëhet ligji. Zoti Fatmir Rexhepi e ka fjalën!

FATMIR REXHEPI: Faleminderit!

Sa për korrektësi, Komisioni dhe grupi punues që e kemi drejtuar gjatë gjithë periudhës kohore, po them, ka punuar me të gjitha grupet e interesit, me ekspertë, dhe i kemi harmonizuar një paketë amendamentesh, të cilat i kemi para vetes. Asnjëherë diçka nuk mund të bëhet ideale, por unë mendoj se në masën më të madhe do ta kënaqin përmbajtjen e këtij projektligji për synimet dhe qëllimet që i ka ky projektligj.

Vonesat e deklarimeve të tanishme nga kolegët deputetë mendoj se nuk janë të arsyeshme në mënyrën si u thanë, për aq sa u thanë dhe sasinë si u thanë. Prandaj, ne si Komision vlerësojmë se ky projektligj duhet të votohet sot, sepse përmbajtja e re që i është dhënë përmes amendamentimit kënaq qëllimet dhe synimet e këtij projektligji. Faleminderit!

KRYESUESI: Ismet, je paraqitur më parë. Në rregull, urdhëroni!

ISMET BEQIRI: Zotëri kryesues,

Me gjithë konsideratat ndaj çdo kolegu, unë po të lutem, e njëkohësisht po kërkoj edhe në emër të Grupit, sepse reagimet po bëhen individuale, që kur të hyjmë në leximin e dytë mund të flasim për amendament dhe sinjerisht kjo është edhe e padrejtë dhe e dinë që është joligjore të tentojnë në mënyrën e tillë të tashme ose kundër Rregullores dhe po e them, me gjithë konsideratën nuk është mirë vetëm sa për të thënë diçka sot, por respektojeni Rregulloren, shkojmë tutje, është leximi i dytë, miratojmë ose s'i miratojmë amendamentet dhe është e drejtë e secilit për të votuar, flas për anëtarët e grupeve të caktuara parlamentare, sepse në këtë formë jo vetëm që po e shkelim Rregulloren, por as s'jemi produktivë.

KRYESUESI: Arben, a e do fjalën? Urdhëro! Zoti Gashi e ka fjalën!

ARBEN GASHI: Faleminderit, i nderuar kryesues!

Mendoj se nëse zoti Topalli ka vërejtje konkrete për ligjin mund t'i shndërrojë në formë të amendamentit në seancë dhe seanca mund të marrë vendim. Pra, nëse ka ndonjë vërejtje jologjike për të cilën ai po pretendon.

Përndryshe, jemi në lexim të dytë dhe vazhdon seanca, i trajton problemet që janë dhe ecim tutje. Seanca është ajo që mund të marrë vendim, nëse do të plotësojë ose të mos plotësojë diçka,

mund të marrë vendim ta tejkalojë edhe Rregulloren, por në këtë rast diskutimi i zotit Topalli është diskutim politik dhe jo konkret specifik, për problemet që i ka ligji. Faleminderit!

KRYESUESI: Zoti Topalli e merr edhe një herë fjalën!

FATON TOPALLI: Unë po pajtohem se të gjitha diskutimet këtu janë diskutime politike. Po këtë që i thashë, propozimet që i bëra janë thjesht përmbajtjesore dhe nuk mund të miratojmë një ligj, i cili ka gabime në përkthim, ka gabime logjike dhe nuk mund, pastaj, askush t'i korrektojë gabimet në një ligj, të cilin e ka sjellë Kuvendi i Kosovës, prandaj po mendoj se jemi shumë konstruktivë, po kërkojmë që ligji të përfundojë mirë dhe jemi të gatshëm ta votojmë, por t'i bëjmë këto ndryshime në Kuvend, sepse është Kuvendi ai i cili i bën ndryshimet dhe i miraton.

KRYESUESI: Faton, unë jam dakord, ndoshta ke të drejtë për ndonjë çështje, por jemi me vonesë. Ti e bërë një kërkesë tash për të shkuar në lexim të tretë. Është e drejtë e Grupit Parlamentar në qoftë se të mbështetë e të kërkojë dhe ne të votojmë për ose kundër kërkesës tuaj në seancë.

Përndryshe, ne i kemi 59 amendamente që i ka shqyrtuar Komisioni dhe i ka shqyrtuar, besoj, me përkushtim të madh, kështu që nëse je për ta hedhur në votim propozimin tuaj, unë e hedh për ta çuar në lexim të tretë. Të tjerat gjëra nuk i ke sjellë të shkruara dhe unë s'di çka të qes në votim. Zoti Topalli e ka fjalën!

FATON TOPALLI: Në emër të Grupit Parlamentar të Lëvizjes "Vetëvendosje" kërkoj që të hidhet në votim propozimi ynë.

KRYESUESI: Propozimi ka të bëjë që të çohet në lexim të tretë ligji. Në rregull, ka të drejtë të propozojë.

A jeni që të deklarohemi me votim?

Atëherë, a jeni për propozimin e zotit Topalli që ligji të shkojë në lexim të tretë për shkak të vërejtjeve dhe ato që i tha Topalli?

Kush është për?

Kush është kundër?

Atëherë, nuk miratohet kërkesa e zotit Topalli.

E drejta për të bërë amendamente në ligj është e hapur gjithmonë.

Fillojmë me votimin e amendamenteve.

Amendamenti 1

Kundër? Nuk ka. Abstenim nuk ka. Miratohet.

Amendamenti 2

Kundër? Nuk ka. Abstenim nuk ka. Miratohet.

Amendamenti 3

Kundër? Nuk ka. Abstenim nuk ka. Miratohet.

Amendamenti 4

Kundër? Nuk ka. Abstenim nuk ka. Miratohet.

Amendamenti 5

Kundër? Nuk ka. Abstenim nuk ka. Miratohet.

Amendamenti 6

Kundër? Nuk ka. Abstenim nuk ka. Miratohet.

Amendamenti 7

Kundër? Nuk ka. Abstenim nuk ka. Miratohet.

Amendamenti 8

Kundër? Nuk ka. Abstenim nuk ka. Miratohet.

Amendamenti 9

Kundër? Nuk ka. Abstenim nuk ka. Miratohet.

Amendamenti 10

Kundër? Nuk ka. Abstenim nuk ka. Miratohet.

Amendamenti 11

Kundër? Nuk ka. Abstenim nuk ka. Miratohet.

Amendamenti 12

Kundër? Nuk ka. Abstenim nuk ka. Miratohet.

Amendamenti 13

Kundër? Nuk ka. Abstenim nuk ka. Miratohet.

Amendamenti 14

Kundër? Nuk ka. Abstenim nuk ka. Miratohet.

Amendamenti 15

Kundër? Nuk ka. Abstenim nuk ka. Miratohet.

Amendamenti 16

Kundër? Nuk ka. Abstenim nuk ka. Miratohet.

Amendamenti 17

Kundër? Nuk ka. Abstenim nuk ka. Miratohet.

Amendamenti 18

Kundër? Nuk ka. Abstenim nuk ka. Miratohet.

Amendamenti 19

Kundër? Nuk ka. Abstenim nuk ka. Miratohet.

Amendamenti 20

Kundër? Nuk ka. Abstenim nuk ka. Miratohet.

Amendamenti 21

Kundër? Nuk ka. Abstenim nuk ka. Miratohet.

Amendamenti 22

Kundër? Nuk ka. Abstenim nuk ka. Miratohet.

Amendamenti 23

Kundër? Nuk ka. Abstenim nuk ka. Miratohet.

Amendamenti 24

Kundër? Nuk ka. Abstenim nuk ka. Miratohet.

Amendamenti 25

Kundër? Nuk ka. Abstenim nuk ka. Miratohet.

Amendamenti 26

Kundër? Nuk ka. Abstenim nuk ka. Miratohet.

Amendamenti 27

Kundër? Nuk ka. Abstenim nuk ka. Miratohet.

Amendamenti 28

Kundër? Nuk ka. Abstenim nuk ka. Miratohet.

Amendamenti 29

Kundër? Nuk ka. Abstenim nuk ka. Miratohet.

Amendamenti 30

Kundër? Nuk ka. Abstenim nuk ka. Miratohet.

Amendamenti 31

Kundër? Nuk ka. Abstenim nuk ka. Miratohet.

Amendamenti 32

Kundër? Nuk ka. Abstenim nuk ka. Miratohet.

Amendamenti 33

Kundër? Nuk ka. Abstenim nuk ka. Miratohet.

Amendamenti 34

Kundër? Nuk ka. Abstenim nuk ka. Miratohet.

Amendamenti 35

Kundër? Nuk ka. Abstenim nuk ka. Miratohet.

Amendamenti 36

Kundër? Nuk ka. Abstenim nuk ka. Miratohet.

Amendamenti 37

Kundër? Nuk ka. Abstenim nuk ka. Miratohet.

Amendamenti 38

Kundër? Nuk ka. Abstenim nuk ka. Miratohet.

Amendamenti 39

Kundër? Nuk ka. Abstenim nuk ka. Miratohet.

Amendamenti 40

Kundër? Nuk ka. Abstenim nuk ka. Miratohet.

Amendamenti 41

Kundër? Nuk ka. Abstenim nuk ka. Miratohet.

Amendamenti 42

Për amendamentin 42 nga Komisioni paraqitet Fatmir Rexhepi për fjalë.

FATMIR REXHEPI: Amendamenti 42, në paragrafin 8.1 për shkak të harmonizimit me tërë tekstin në Projektligj duhet të fshihet fjalia “nuk ka” dhe të zëvendësohet me “personat të cilët kanë” dhe vazhdon teksti, “lidhje familjare ose bizneseve të tjera”. Pra, është një gabim që duhet përmirësuar.

KRYESUESI: A jeni dakord me propozimin që e bëri zoti Fatmir?

Atëherë, amendamenti 42 plotësohet me propozimet e zotit Fatmir.

Kundër s’ka.

Miratohet.

Amendamenti 43

Kundër? Nuk ka. Abstenim nuk ka. Miratohet.

Amendamenti 44

Kundër? Nuk ka. Abstenim nuk ka. Miratohet.

Amendamenti 45

Kundër? Nuk ka. Abstenim nuk ka. Miratohet.

Amendamenti 46

Kundër? Nuk ka. Abstenim nuk ka. Miratohet.

Amendamenti 47

Kundër? Nuk ka. Abstenim nuk ka. Miratohet.

Amendamenti 48

Kundër? Nuk ka. Abstenim nuk ka. Miratohet.

Amendamenti 49

Kundër? Nuk ka. Abstenim nuk ka. Miratohet.

Amendamenti 50

Kundër? Nuk ka. Abstenim nuk ka. Miratohet.

Amendamenti 51

Kundër? Nuk ka. Abstenim nuk ka. Miratohet.

Amendamenti 52

Kundër? Nuk ka. Abstenim nuk ka. Miratohet.

Amendamenti 53

Kundër? Nuk ka. Abstenim nuk ka. Miratohet.

Amendamenti 54

Kundër? Nuk ka. Abstenim nuk ka. Miratohet.

Amendamenti 55

Kundër? Nuk ka. Abstenim nuk ka. Miratohet.

Amendamenti 56

Kundër? Nuk ka. Abstenim nuk ka. Miratohet.

Amendamenti 57

Kundër? Nuk ka. Abstenim nuk ka. Miratohet.

Amendamenti 58

Kundër? Nuk ka. Abstenim nuk ka. Miratohet.

Amendamenti 59

Kundër? Nuk ka. Abstenim nuk ka. Miratohet.

Tash votojmë tekstin e Projektligjit në tërësi.

(Ndërrhyrje)

Jo, në seancë s'ka amendamente! Kush?

Po ti, në paq, sille të shkruar, o burrë, ta marrim vesh. Asnjëherë s'kemi miratuar amendament të ri në seancë. Ani, urdhëro, propozoj! Jeni këtu që një orë, ke mundur ta propozosh deri tash, e jo pasi u shqyrtua i tërë ligji po propozon amendament. Urdhëro!

SABRI HAMITI: Kam respekt për drejtues të seancave, sepse i drejtoj shpesh. Nganjëherë lodhesh, njerëzit flasin dhe nuk je në gjendje për t'i përcjellë. Por, komentet në këtë rast nuk të vyejnë asgjë.

Unë e kam lexuar ligjin më mirë se shumica këtu qysh e lexon, edhe amendamentet, dhe kam dëgjuar çka ndodhi sot këtu. Po ju them se jo vetëm ky ligj, por në shumicën e herëve, përqindje s'po jap, se s'kam të saktë, ligjet janë të pasaktë në tri variantet, e ju e dini që në ligjet i bëjmë gjithë në tri variante.

Diskutimi këtu që është bërë nga kolegu Topalli shkon kah ky saktësim i varianteve të tekstit në gjuhë të tjera. Dhe unë propozoj amendamentin 60, nëse doni e votoni, e nëse s'doni s'e votoni, mos u mërzitni, mos merrni siklet. Pra, në këtë tekst një amendament ku do të thotë: Amendamenti 60, unë e propozoj, kurse seanca ka të drejtë të votojë për këtë ligj, në mënyrë specifike, që do të ishte si vijon: "Të bëhet korrektimi gjuhësor dhe i barasvlershëm në tri gjuhët në gjithë tekstin e këtij ligji". Pikë!

Më qartë unë nuk di si të them. Në doni, votoni, në doni mos e votoni!

KRYESUESI: Administrata s'ka të drejtë ta prekë ligjin. Nuk di kush janë ata korrektues, përveç për ta çuar në lexim të tretë. Unë nuk e di kush janë ata korrektues dhe lektorë.

(Ndërhyrje)

Unë jam dakord që të shihen mundësitë, por nuk besoj se do të duhej të ekzistojë amendament që pas Kuvendit ta shqyrtojë një grup që s'di kush janë ata.

Në qoftë se ju jeni dakord për ta vënë në votim, e votojmë.

Atëherë e votojmë tekstin e Projektligjit në tërësi me amendamentet e miratuara.

Lus regjinë dhe deputetët të përgatiten për votim dhe votojmë tash:

58 deputetë kanë votuar. Janë 56 vota për, 2 abstenime.

Atëherë, nuk kalon ligji, por nëse doni ta përsërisim votimin edhe një herë, le t'i thërrasim deputetët.

(Pauzë e shkurtër)

Do ta përsëritim votimin dhe e vëmë në votim tekstin e Projektligjit në tërësi, me amendamentet e miratuara dhe votojmë tash:

Sa për të saktësuar, votimi përsëritet çdo herë kur nuk ka vota të mjaftueshme, s'kalon 61-shi.

Pra, tani në votim kanë marrë pjesë 69 deputetë.

Prandaj, me 67 vota për dhe 2 abstenime, konstatoj se Kuvendi e miratoi Ligjin për falimentim. Faleminderit!

Ju kisha lutur të mos dilni jashtë e të votojmë, sepse kjo është detyrë jona, e pastaj kur t'i kryejmë do të dalim në pauzë.

9. Shqyrtimi i Projektligjit për investime strategjike në Republikën e Kosovës

Komisionet parlamentare e kanë shqyrtuar Projektligjin për investime strategjike në Republikën e Kosovës dhe Kuvendit i kanë rekomanduar miratimin e tij me amendamente të propozuara.

Ftoj kryetarin e Komisionit FunkSIONAL, zotin Muhamet Mustafa, që të paraqesë dhe të arsyetojë raportin me rekomandime.

MUHAMET MUSTAFA: I nderuar nënkryetar i Kuvendit,
I nderuar kryeministër,
Të nderuar ministra,
Kam kënaqësinë që të paraqes raportin mbi ndryshimin e këtij projektligji në Komision.

Mund të themi se ky është një nga ligjet shumë të rëndësishme që e ka propozuar Qeveria për Kuvendin dhe ka zgjuar një interesim të konsiderueshëm jo vetëm te deputetët, por edhe te asociacionet e biznesit, investitorët vendës e të jashtëm, te komuniteti ndërkombëtar. Kemi organizuar shumë debate brenda Kuvendit, jashtë Kuvendit dhe janë bërë edhe shumë propozime nga shoqëria civile.

Pas gjithë kësaj mendoj që me një punë të angazhuar të Komisionit dhe grupit punues është arritur që të tejkalohen disa nga dilemat, të cilat kanë ekzistuar lidhur me faktin se ky ligj për herë të parë i mundëson Qeverisë për investime strategjike dhe investime të rëndësishme dhe të zhvillojnë negociata të drejtpërdrejta për të krijuar kushte për investitorët strategjikë, duke përfshirë edhe dhënien në disponim të pronës në kushte të përcaktuara me ligj.

Amendamentet që i ka bërë Komisioni kryesisht shkojnë në drejtim të forcimit të transparencës, llogaridhënies, trajtimit të barabartë dhe mosdiskriminimit të investitorëve.

Gjithashtu është përkufizuar më mirë statusi i investimit strategjik dhe të investitorit strategjik, që do të thotë investitorët strategjikë janë vetëm ata investitorë, të cilët në rekordin e tyre, në përvojën e tyre biznesore, në referencat e tyre kanë treguar se kanë referenca e prova financiare nga auditorë me renome ndërkombëtare dhe se i zbatojnë parimet etike dhe qeverisjen korporative sipas standardeve të OECD-së.

Gjithashtu në ligj promovohet edhe një qëndrim proaktiv i Qeverisë që t'u mundësohet të gjithë investitorëve të ndërtuar në mënyrë transparente listën e projekteve, e cila shpallet paraprakisht dhe për të cilën konkurrojnë të gjithë ata që janë të interesuar.

Po ashtu, në bazë të kësaj, Komisioni mund të zhvillojë negociata deri te Komisioni ndërministror, por sigurohet një transparencë e vazhdueshme e punës së Komisionit ndërministror, të Qeverisë dhe i gjithë procesit.

Gjithashtu është qartësuar edhe çështja e konfliktit të interesit më mirë, e po ashtu afatet dhe procedurat janë shkurtuar, në mënyrë që ligji të jetë edhe më efektiv në stimulimin e investitorëve për të investuar në investime strategjike.

Janë precizuar shumë kushte, të cilat ligjin e bëjnë më të pranueshëm dhe të zbatueshëm.

Mund të them se për të gjitha këto kemi mbërritur një konsensus në Komision lidhur me Komisionin Evropian, i cili ka prezantuar vërejtjet në emër të aktorëve të ndryshëm ndërkombëtarë dhe duket se janë tejkaluar edhe ato probleme.

I kemi dy alternativa në amendamentin 32 dhe kur të vijmë aty, unë do të sqaroj mendimin, meqenëse është konkret për të.

Prandaj, duke e marrë parasysh punën shumë të rëndësishme që e ka bërë Komisioni dhe Grupi punues, për çka unë i falënderoj, i ftoj deputetët që t'i aprovojnë propozimet e amendamenteve të Komisionit për këtë ligj. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Zoti Beqaj e ka kërkuar fjalën!

BESIM BEQAJ: Faleminderit, i nderuar kryesues!

Të nderuar deputetë,

Kryeministër,

Kabinet qeveritar,

Siç u tha edhe nga deputeti Mustafa, ne kemi punuar gjatë, në bashkëpunim edhe me Qeverinë, në një projektligj i cili është menduar që të jetë hapje e rrugës për investime të rëndësishme së veçantë për shtetin. Normalisht që unë besoj edhe më tutje se nuk është mbërritur ai maksimumi i mundshëm, duke marrë parasysh se është dashur të harmonizohen edhe qëndrimet tona me Komisionin Evropian dhe ta ruajmë konkurrencën, të krijojmë kushte të cilat nuk do të ishin të kthyeshme nga ana e Komisionit, sepse është dashur të merren mendime edhe nga Kuvendi dhe besoj që këtu e kemi bërë një përmirësim substancial, i cili rrit transparencën dhe funksionalitetin, por gjithsesi besoj që ligji në të ardhmen duhet edhe të shihet me akte të tjera nënligjore, të cilat do të duhej ta mundësonin funksionalizimin më të mirë.

Parimisht, ne jemi pajtuar që ta dërgojmë kështu si është dhe do ta përkrahim, por besoj që në të ardhmen do të ketë shumë më shumë përmirësime dhe shpresoj që rezultati do të dalë ai i cili është menduar nga Qeveria.

Unë kam rezervat e mia dhe këto i kam thënë edhe në Komision, por sido që të jetë, do ta përkrahim dhe do t'ia japim shansin që të shihet mundësia e gjetjes dhe thithjes së investitorëve sa më seriozë, sa më strategjikë, të cilët do të krijojnë edhe zhvillim ekonomik, por do të krijojnë edhe mundësinë për punësim. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Atëherë në amendamentin 35 kemi dy propozime, dhe kur të vijmë te ajo do të diskutojmë. Po, kemi të bëjmë me 32-shin, më falni! Po hyjmë në votimin e amendamenteve:

Amendamenti 1

Kundër? Nuk ka. Abstenim nuk ka. Miratohet.

Amendamenti 2

Kundër? Nuk ka. Abstenim nuk ka. Miratohet.

Amendamenti 3

Kundër? Nuk ka. Abstenim nuk ka. Miratohet.

Amendamenti 4

Kundër? Nuk ka. Abstenim nuk ka. Miratohet.

Amendamenti 5

Kundër? Nuk ka. Abstenim nuk ka. Miratohet.

Amendamenti 6

Kundër? Nuk ka. Abstenim nuk ka. Miratohet.

Amendamenti 7

Kundër? Nuk ka. Abstenim nuk ka. Miratohet.

Amendamenti 8

Kundër? Nuk ka. Abstenim nuk ka. Miratohet.

Amendamenti 9

Kundër? Nuk ka. Abstenim nuk ka. Miratohet.

Amendamenti 10

Kundër? Nuk ka. Abstenim nuk ka. Miratohet.

Amendamenti 11

Kundër? Nuk ka. Abstenim nuk ka. Miratohet.

Amendamenti 12

Kundër? Nuk ka. Abstenim nuk ka. Miratohet.

Amendamenti 13

Kundër? Nuk ka. Abstenim nuk ka. Miratohet.

Amendamenti 14

Kundër? Nuk ka. Abstenim nuk ka. Miratohet.

Amendamenti 15

Kundër? Nuk ka. Abstenim nuk ka. Miratohet.

Amendamenti 16

Kundër? Nuk ka. Abstenim nuk ka. Miratohet.

Amendamenti 17

Kundër? Nuk ka. Abstenim nuk ka. Miratohet.

Amendamenti 18

Kundër? Nuk ka. Abstenim nuk ka. Miratohet.

Amendamenti 19

Kundër? Nuk ka. Abstenim nuk ka. Miratohet.

Amendamenti 20

Kundër? Nuk ka. Abstenim nuk ka. Miratohet.

Amendamenti 21

Kundër? Nuk ka. Abstenim nuk ka. Miratohet.

Amendamenti 22

Kundër? Nuk ka. Abstenim nuk ka. Miratohet.

Amendamenti 23

Kundër? Nuk ka. Abstenim nuk ka. Miratohet.

Amendamenti 24

Kundër? Nuk ka. Abstenim nuk ka. Miratohet.

Amendamenti 25

Kundër? Nuk ka. Abstenim nuk ka. Miratohet.

Amendamenti 26

Kundër? Nuk ka. Abstenim nuk ka. Miratohet.

Amendamenti 27

Kundër? Nuk ka. Abstenim nuk ka. Miratohet.

Amendamenti 28

Kundër? Nuk ka. Abstenim nuk ka. Miratohet.

Amendamenti 29

Kundër? Nuk ka. Abstenim nuk ka. Miratohet.

Amendamenti 30

Kundër? Nuk ka. Abstenim nuk ka. Miratohet.

Amendamenti 31

Kundër? Nuk ka. Abstenim nuk ka. Miratohet.

Amendamenti 32

I kemi dy propozime i Komisionit Funksional, pa përkrahjen e Komisionit për Buxhet dhe Financa dhe i Komisionit për Buxhet dhe Financa, pa përkrahjen e Komisionit Funksional.

Për këtë çështje, zonja Bajrami, ministre e Ekonomisë, e ka kërkuar fjalën.

MINISTRJA HIKMETE BAJRAMI: Faleminderit, i nderuar kryesues!

I nderuar kryeministër,

Të nderuar deputetë,

Unë po i referohem amendamentit 32 a për Projektligjin për investime strategjike, i propozuar nga Komisioni Funksional, i cili parasheh që Qeveria e Republikës së Kosovës mund të bartë të drejtën e shfrytëzimit të një prone të paluajtshme për investime strategjike në bazë të Ligjit për shpronësim të pronës së paluajtshme vetëm pasi Kuvendi i Republikës së Kosovës të marrë vendim me shumicë të të gjithë deputetëve të Kuvendit.

Të nderuar deputetë,

Unë ju falënderoj shumë për punën që e keni bërë në avancimin e këtij ligji. Mirëpo mendoj që ky ligj në fakt nuk është në harmoni me objektivat e Ligjit për investime strategjike, sepse i komplikon tepër procedurat, jo që i shkurton procedurat që është objektin e Ligjit për investime strategjike, por i komplikon ato edhe më tepër.

Unë ju rikujtoj se me Ligjin për shpronësimet ne si Qeveri e Republikës së Kosovës nuk kemi nevojë fare të vijmë në Kuvend dhe ta kryejmë shpronësimin, të kërkojmë aprovim për implementimin e një ligji, i cili në fakt është në mandatin e Qeverisë për ta implementuar.

Ju keni kërkuar prej neve që ne të vijmë të kërkojmë aprovimin e Kuvendit dhe mandej t'i ndjekim procedurat e shpronësimit, gjë e cila është komplet në kundërshtim me objektivat e projektligjit, edhe si i tillë, nëse votohet ky amendament, në fakt, ligji mbetet jofunksional edhe nuk mund të pritni nga Qeveria që me të vërtetë të jetë atraktive me vendet e rajonit, të cilat edhe sot e kësaj dite kryejnë procedura të drejtpërdrejta të dhënies së pronës së paluajtshme në shfrytëzim në këmbim të investimeve të mëdha dhe të krijimit të vendeve të reja të punës.

Më lejoni edhe një herë t'ju rikujtoj, e di që kemi marrë vërejtje edhe prej Bashkimit Evropian dhe Komisionit Evropian, mirëpo ju siguroj që Malta, shtet i Bashkimit Evropian, e cila e merr

presidencën e US në vitin 2017 më 1 janar, ajo jua jep drejtpërdrejt pronat e paluajtshme investitorëve dhe këtë konfirmim e kam marrë nga ministri homolog atje.

Kroacia sot e kësaj dite jep tokën në shfrytëzim pa asnjë procedurë, të mos flasim për vendet e rajonit, të gjitha ku kryeministrat e këtyre vendeve ulen edhe bisedojnë me kompaninë me renome përcjellin investime në vendet e tyre.

Andaj, unë propozoj që amendamenti 32 të mos votohet, a të votohet, ose amendamenti i Komisionit për Buxhet e Financa, ose eventualisht të mbetet neni siç ka qenë në projektligj.

Edhe një herë ju falënderoj dhe kërkoj mirëkuptimin tuaj! Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Fjalën e ka zoti Muhamet Mustafa.

MUHAMET MUSTAFA: I nderuar kryesues,

Unë e kuptoj plotësisht frikën e ministres edhe natyrisht që ne në Komision e kemi pasur parasysh gjithë këtë dhe i kemi trajtuar të gjitha aspektet. Në fakt, nëse i analizojmë të dy amendamentet në përmbajtjen e tyre janë shumë të ngjashme, sepse edhe te Ligji i shpronësimit janë të gjitha këto elemente që janë në amendamentin që e ka propozuar Komisioni për Buxhet dhe Financa, duke përfshirë edhe 20% për punëtorët edhe të gjitha ato, domethënë janë shumë të ngjashëm. Këtu kemi pak frikën për procedura, faktikisht nuk shtohet asnjë procedurë, për arsye se në amendamentin që është i Komisionit për Buxhet paraprakisht është një procedurë që duhet marrë leje për të marrë diçka prej Agjencisë së Privatizimit, njësoj prej Kuvendit. Pas kësaj duhet regjistruar në emër të Qeverisë së Kosovës atë pronësi dhe tek pastaj duhet shkuar në negociata me investitorë.

Në fakt, amendamenti që ne kemi, unë mendoj që është edhe më i shkurtër edhe më i thjeshtë, për arsye se vendos Kuvendi dhe menjëherë bëhet shpronësimi në harmoni me negociatat me investitorin, kjo është e para.

E dyta, është një problem që nuk dallojnë këto dy amendamente, dallojnë në esencë vetëm një çështje. Në amendamentin e Komisionit duhet shumica e deputetëve, domethënë 61 deputetë, kurse në amendamentin e Komisionit për Buxhet është shumica e thjeshtë, domethënë këtu dallojnë këto.

Përndryshe, sa u përket procedurave, procedurat ndoshta janë më efikase në amendamentin e Komisionit. Kaq është domethënë sqarimi për deputetë, deputetët le të votojnë qysh të donë, por dëshiroj të theksoj se njëri nga këto dy amendamente duhet të votohet patjetër, sepse propozimi origjinal nuk e ka trajtuar problemin e kreditorëve dhe kjo ka shkaktuar shqetësim te komuniteti ndërkombëtar dhe praktikisht ligji pa atë pjesë nuk mund të shkojë. Domethënë patjetër njëri amendament duhet të kalojë. Nuk mundet të mbetet teksti bazik. Faleminderit!

KRYESUESI: A s'mund të merreni vesh ju cili? Zoti Naser Osmani e ka fjalën, si kryetar i Komisionit Funkcional.

NASER OSMANI: Faleminderit, kryesues!

Ajo që e tha ministrja konsideroj që ka kuptim. Ne duhet të jemi më të thjeshtë dhe më dinamikë, për arsye se nëse nuk e përkrahim amendamentin e Komisionit për Buxhet dhe Financa, atëherë nuk jemi aq dinamikë sa janë të tjerët në regjion, sidomos kur ka të bëjë me prurjen e investitorëve strategjikë.

Jemi munduar që ta bëjmë sa më preciz edhe më të qartë amendamentin në krahasim me Komisionin Funksional, sepse kjo ka të bëjë që e saktëson që obligimet që merr Qeveria ndaj një prone që ka qenë e administruar nga AKP-ja t'i kryejë obligimet ndaj punëtorëve, t'i kryejë obligimet ndaj pronarëve dhe t'i kryejë obligimet ndaj kreditorëve.

Prandaj, kjo e sqaron mirë edhe çështjen e suficitit që duhet të derdhet në Qeveri.

Amendamenti i Komisionit e plotëson edhe kërkesën e Qeverisë, se tek e fundit, politikat strategjike janë politika, të cilat i harton Qeveria dhe Kuvendi vetëm e krijon infrastrukturën ligjore për t'i zbatuar ato politika investive. Konsideroj që ne duhet të merremi vesh.

Meqenëse po e vërej që kryetari i Komisionit Funksional ka pak dilemë që mund të kalojë edhe i Komisionit Funksional, unë iu bëj thirrje që t'i kalojë Komisionit për Buxhet dhe Financa, u bëj thirrje deputetëve që të votohet amendamenti i Komisionit për Buxhet dhe Financa.

KRYESUESI: Faleminderit! Zoti Arben Gashi e ka fjalën.

ARBEN GASHI: Faleminderit, kryesues!

Tash këtu u krijua një huti komplet për këtë nen dhe amendament.

Për pak qartësi unë po e lexoj nenin, se zonja Bajrami tha që qëllimi është që të mos jetë në vendimmarrje Kuvendi dhe të lihet qysh është në ligj.

Unë po e lexoj qysh është në ligj, domethënë neni 22, pika 1. "Qeveria e Republikës së Kosovës mund të bartë të drejtën e shfrytëzimit të një ndërmarrje shoqërore apo ndonjë prone të saj që është nën autoritetin administrativ të Agjencisë Kosovare të Privatizimit dhe pronave shoqërore që janë nën autoritetin administrativ të Agjencisë Pyjore të Kosovës të subjekti investues. Vetëm pasi Kuvendi i Republikës së Kosovës të marrë vendim me shumicë të thjeshtë votash për heqjen e ndonjë ndërmarrje shoqërore apo pronës së saj nga autoriteti administrativ i Agjencisë Kosovare të Privatizimit dhe të autorizojë Qeverinë që të ketë ndërmarrje apo pronë që këtë ndërmarrje apo pronë t'ia bartë në shfrytëzim investitorit për qëllim të zbatimit të ndonjë projekti të investimit strategjik". Ky është ligji bazik, pika e parë. Çka bën Komisioni Funksional?

Komisioni Funksional e ndryshon pikën e parë dhe nuk e lë me shumicë të thjeshtë, po thotë me shumicën e të gjithë deputetëve, që nënkupton se duhen 61 deputetë të votojnë që kjo të ndodhë.

Çka bën Komisioni për Buxhet dhe Financa? Nuk e prek pjesën e parë të Komisionit Funksional, po merret me pjesën e dytë, që do të thotë, prapë Kuvendi është ai që merr vendim, nëse një pronë hiqet nga Agjencia Kosovare e Privatizimit apo nuk hiqet. Kështu që të jemi të qartë në këto tri diskutime dhe nëse ne e votojmë propozimin e Komisionit Funksional, i bie që të shkohet

me 61 vota. Naser, nuk jam duke votuar keq se po thotë “Neni 22, paragrafi 2 ndryshohet”. Ndërsa neni 22, paragrafi 1, nuk preket. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Ministrja Bajrami e ka kërkuar fjalën edhe një herë.

MINISTRJA HIKMETE BAJRAMI: Vetëm zotin Gashi. Unë dola për të sqaruar atë se çfarë ju e ngritën në Projektligjin që ne e kemi sjellë si Qeveri. Normalisht që thuhet që Kuvendi është ai i cili heq pronat prej administrimit të Agjencisë së Privatizimit dhe në këtë rast e autorizon Qeverinë për të negociuar drejtpërdrejt me investitorë.

Komisioni Funkcional ka thënë përmes ligjit të shpronësimit, ju e dini sa procedura ka Ligji i shpronësimit. Është vendimi i parë, elaborati i shpronësimit, vendimi i dytë, e të tjera, domethënë janë procedura me vite, plus paraprakisht e kërkon aprovimin e shumicës së deputetëve të Kuvendit.

Ne kemi kërkuar që të marrim aprovim të Kuvendit, mirëpo të autorizohemi që Qeveria të diskutojë, të mos shkohet përmes Ligjit të shpronësimit, po të jetë procedurë e drejtpërdrejtë. Ku janë, për shembull, atje kufijtë, ku thuhet në bujqësi duhet t’i kenë 10 milionë investim në mënyrë që Qeveria të ketë të drejtën të ulet dhe të negociojë drejtpërdrejt, po nuk thotë thashë t’i përdorim të gjitha ato procedura të gjata.

Unë po them, për të shkuar sipas Ligjit të shpronësimit, ne e kemi të drejtën edhe pa ardhur në Kuvend. Ne kemi dashur t’i shkurtojmë procedurat, t’i bëjmë siç po e bën sot Serbia, siç po e bën Maqedonia, Mali i Zi dhe të gjitha shtetet, edhe Shqipëria.

KRYESUESI: Faleminderit! Zoti Beqaj e ka fjalën.

BESIM BEQAJ: Faleminderit, zoti kryesues!

Dua të tentoj ta sqaroj edhe një herë pse ne e kemi bërë një amendament të tillë. Para së gjithash, kemi të bëjmë me transparencën dhe, e dyta, që është jashtëzakonisht e rëndësishme, Vendimi i Kuvendit për investitorë është vendim i pakthyeshëm, po dalim nga këndvështrimi i një investitori potencial. Nëse vendimi mbetet ekskluzivisht në nivel të Qeverisë, nënkupton që Qeveria tjetër nesër vjen e merr vendimin dhe e heq atë proces. Neni, i cili ka ardhur nga Ministria flet vetëm për pronat e administruara nga AKP-ja, nuk flet për prona të tjera.

Pra, ne kemi dashur ta qartësojmë që çdo vendim, i cili ka të bëjë me dhënie të pronës, e cila është pronë e qytetarëve të Kosovës, të shkojë me vendim të Kuvendit dhe vendimi i Kuvendit është i pakthyeshëm dhe këtu nuk ka asnjë lloj procedure. Procedurat janë prapë të njëjta, vetëm kërkohet vendimi i Kuvendit, i cili do ta bëjë vendimin të pakthyeshëm në kuptimin e investitorit. Duhet t’i pyesni pak edhe investitorët, të cilët presin një vendim të tillë. Nuk do të ketë investitor, i cili vjen të bëjë investime mbi bazën e një vendimit të një Komisioni dhe të Qeverisë, sepse ai mund të kthehet nga Qeveria tjetër. Jemi duke folur për diçka substanciale, e cila e bën ligjin funksional dhe e rrit transparencën në mënyrë substanciale. Nëse një Qeveri nuk i ka 61 vota për ta votuar një vendim të tillë, atëherë është diçka tjetër. Pra, jemi duke folur për gjëra të cilat, nëse flasim për investime strategjike, jemi duke folur për gjëra që janë me të vërtetë të interesit nacional.

KRYESUESI: Zonja Bajrami, prapë e ka fjalën.

MINISTRJA HYKMETE BAJRAMI: Zoti Beqaj, nuk kemi problem të vendimi i Kuvendit. Në të gjitha propozimet është vendimi i Kuvendit, por nuk mund të kesh edhe Ligjin për shpronësim, edhe vendimin e Kuvendit. Nëse po do të bëhemi me Ligj për shpronësim, atëherë nuk na duhet ligji, domethënë ky është argumenti. Nuk kemi nevojë për Ligj për investime strategjike, i cili i thotë Qeverisë zbatoje Ligjin për shpronësim. Ne jemi duke thënë, nëse kemi investitorë, të cilët i kanë paratë e gatshme për të investuar dhe për të marrë asete të ndryshme të Kosovës në shfrytëzim, atëherë po jua japim, edhe kjo është për të rritur transparencën. Vendimi i Kuvendit për çdo pronë që është nën administrimin e AKP-së, neve na duhet vendimi i Kuvendit, se e dimë që është agjenci që i raporton Kuvendit, dhe këtë rregull ne nuk do ta heqim, domethënë jemi këtu për t' i shkurtuar procedurat, për t' i shkurtuar procedurat burokratike.

Për transparencë unë besoj që me ligj është rritur transparenca, nuk e di që dikush ka qenë i kënaqur deri më tani as me procesin e privatizimit dhe as me prokurimin publik në Kosovë që ka ndodhur deri më tani. Tani ne po e ngremë, sepse projektet fillimisht aprovohen nga Kuvendi, janë komisionet e ekspertëve, janë 6 ministra me kryetarin e komunës, ku do të zhvillohet projekti potencial. Këtu domethënë nuk kemi, te Kuvendi nuk kemi asnjë argument, asnjë kundërtënie nuk kemi. Vendimi i Kuvendit le të mbetet vetëm se Kuvendi autorizon Qeverinë të negociojë drejtpërdrejt me investitorë, këtë po e kërkojmë, këtë e kanë vendet e regjionit, të cilat në këtë aspekt janë shumë më atraktive sesa Kosova.

KRYESUESI: Faleminderit! Replikë, zoti Beqaj.

BESIM BEQAJ: Unë zoti kryesues,

Të nderuar deputetë,

Desha ta kursej pak ministren sa i përket Ligjit të procedurave për kalim të pronës, pra të shpronësimeve dhe po jap një detaj për Kuvendin dhe për qytetarët.

Ligji nëse shkon kështu, është në kundërshtim të drejtpërdrejtë me direktivat e Bashkimit Evropian mbi konkurrencën, sepse flet për investime publike.

Shpjegimi ligjor që na ka ardhur nga Ministria e Tregtisë dhe Industrisë ka qenë që ne i kemi të mbuluar dhe Komisioni Evropian, investimet publike mund t'i qojë pa procedura të prokurimit. Të hapet ligji pa procedura të prokurimit për secilin fushë, nënkupton në mënyrë të drejtpërdrejtë jotransparencë. Dhe, çka kemi bërë ne këtu? Kemi mundësuar që përmes Ligjit të shpronësimeve të kalohet kjo procedurë dhe të mos bie ndesh me direktivën. Unë edhe me ministren, po edhe në takimet e tjera kemi pasur sqarime rreth asaj se çka është investim publik dhe çka është investim privat me karakter publik. Janë dy gjëra të ndryshme. Prandaj, unë i bëj ftesë Kuvendit me vullnetin më të mirë të mundshëm që ta votojë amendamentin 32 a qysh ka thënë Komisioni, sepse është në harmoni edhe me direktivat e Bashkimit Evropian, edhe hap rrugën dhe nuk krijon burokraci.

KRYESUESI: Faleminderit! Kryeministri e ka fjalën.

KRYEMINISTRI ISA MUSTAFA: Faleminderit, i nderuar kryesues!

Të nderuar deputetë,

Ne e kemi pasur një objektiv të caktuar në momentin kur jemi orientuar ta propozojmë këtë ligj në Kuvend. Qëllimi ka qenë që ne të jemi konkurrentë me vendet fqinje, për arsye se po na shkojnë investimet në vendet e tjera, sepse ato po ofrojnë kushte më të mira, procedura më të thjeshtëzuara dhe po arrijnë që të jenë më tërheqëse për investitorët e jashtëm.

Kështu si është ndryshuar tani me këto propozime, unë dyshoj se ne mund të realizojmë objektivin për të cilën e kemi propozuar ligjin. Prandaj, unë kisha lutur Kuvendin që të shtyhet kjo çështje për një mbledhje të ardhshme të Kuvendit, që të bëjmë përpjekje t'i harmonizojmë dhe të realizojmë objektivin për të cilin ne jemi të përcaktuar dhe në qoftë se mund ta bëjmë atë, në rregull, në qoftë se nuk mundemi, ne Ligjin për shpronësime e kemi si të tillë, mund të veprohet mbi këtë ligj edhe nuk kemi nevojë të mashtrojmë veten se kemi sjellë një ligj, i cili nuk e arrin objektivin për të cilën ne iu kemi adresuar Kuvendit. Faleminderit!

KRYESUESI: Zoti Mustafa, më fal zoti kryeministër, e pate fjalën për këto dy amendamentet, apo për krejt ligjin? Atëherë, unë e hedh në votim propozimin e atij që e ka propozuar, e ka sjellë ligjin në Kuvend, që ligji të kthehet edhe një herë në komision dhe të shqyrtohet në komisionet përkatëse.

Kështu është bërë kërkesa, është propozim i tij, e drejta është ta tërheqë ligjin, e drejta është të dërgohet në lexim të tretë, por për t'i shkurtuar procedurat unë po besoj që dy komisionet: Komisioni për Zhvillim Ekonomik dhe Komisioni për Buxhet dhe Financa, mund ta rregullojnë ligjin edhe një herë ta shohin.

A jeni për? Kundër a ka? Jo! Atëherë, konstatoj që me kërkesë të Kryeministrit të Qeverisë së Kosovës, zotit Mustafa, dhe me votim të njëanshëm të të gjithë deputetëve të kthehet për rishqyrtim në dy komisionet përkatëse dhe pastaj të vijë në shqyrtim në Parlament.

Atëherë, a po e bën kërkesën, Adem, zyrtarisht? Zotit Grabovci e ka fjalën.

ADEM GRABOVCI: Faleminderit, kryesues!

Për hir të kohës kisha propozuar ndryshimin e pikave të rendit të ditës, meqë kemi tash pikë të rendit të ditës votim të fshehtë dhe kemi votimin elektronik, propozoj që të kalojmë në votim elektronik, pra të votojmë Komisionin e Konkurrencës, ndërsa këtë votimin e fshehtë ta lëmë pas këtij, se fitojmë në kohë për deputetët do të jetë më mirë.

KRYESUESI: Armend, a je paraqitur. Atëherë e hedhim në votim propozimin e zotit Grabovci. Kundër? 2 vota kundër. Miratohet propozimi.

11. Shqyrtimi i Propozim-vendimit të Qeverisë së Republikës së Kosovës për emërimin e anëtarëve të Komisionit për Mbrojtjen e Konkurrencës

Komisioni për Zhvillim Ekonomik e ka shqyrtuar propozim-vendimin e Qeverisë së Republikës së Kosovës për emërimin e kryetarit, zëvendëskryetarit dhe tre anëtarëve të Komisionit për Mbrojtjen e Konkurrencës dhe Kuvendit i ka rekomanduar për mosmiratim. Nuk e di a më dëgjuat, Komisioni për Zhvillim Ekonomik ka kërkuar që të mos miratohet.

Radha e diskutuesve, Qeveria nuk e di a do dikush të diskutojë për këtë çështje. Zoti kryeministër, kemi këtë problemin e Komisionit për Mbrojtjen e Konkurrencës, Qeveria është propozuese, duhet ta marrë fjalën, edhe thashë që komisioni ka rekomanduar që të mos miratohet. Tani, ju e keni fjalën, cili është qëndrimi i Qeverisë.

KRYEMINISTRI ISA MUSTAFA: Faleminderit, zoti kryesues!

Tash ne e kemi dhënë propozimin tonë, edhe gjatë procesit të propozimit ne kemi ndërhyrë dy herë në këtë propozim.

Një herë kemi ndërhyrë me dy ndryshime, të cilat i kemi bërë në Qeveri, sepse kemi ardhur deri te të dhënat që dy anëtarët që janë propozuar mbi bazën e ligjit mund të kenë konflikt të interesit, sepse kanë qenë bashkëpronarë ose bashkaksionarë të firmave, edhe i kemi nxjerrë i kemi tërhequr nga propozimi dhe kemi bërë propozime të tjera dhe po ashtu e kemi ndryshuar një propozim të tretë për të cilin kemi konstatuar se ai në pikëpamje profesionale nuk është i profilit që është i paraparë me Ligjin për konkurrencë.

Ne jemi të bindur se anëtarët, të cilët janë propozuar, i plotësojnë kushtet formale dhe mbi bazën e kushteve formale ne i kemi propozuar. Tani ne nuk kemi bërë ndonjë intervistë ose ndonjë vlerësim të performansës së tyre, sepse ajo nuk është e paraparë në bazë të ligjit që të bëhet, por jemi nisur nga kushtet formale dhe kushtet formale 7 vjet përvojë pune në profesion, të gjithë i kanë, diplomat i kanë, ato që janë të parapara me Ligjin për konkurrencën, ndërkaq është mjaft subjektive që ne të themi se sipas mendimit tonë dikush prej tyre mund të jetë i aftë ta bëjë atë punë.

Në qoftë se kemi vlerësime të tilla individuale ato mund të thuhën këtu në Kuvend, por ne si të tilla nuk e kemi bërë, sepse ligji nuk na detyron edhe ajo që s'na detyron ligji, natyrisht që s'kemi qenë të autorizuar ta fillojmë dhe ta bëjmë një procedurë tillë. Unë i propozoj Kuvendit që Kuvendi ta aprovojë, sepse kemi ngecur mjaft shumë me këtë propozim dhe në këtë organ që është shumë i rëndësishëm për ne. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Fjalën e ka kryetari i Komisionit FunkSIONAL, zoti Mustafa, për arsyetimin e raportit me rekomandime.

MUHAMET MUSTAFA: Raportin e keni, me shumicë votash është votuar ky rekomandim. Natyrisht që edhe komisioni ka konstatuar që këta kushtet formale ligjore i përfaqësojnë. Dilema e një pjese të komisionit ka qenë që kanë mjaft preferenca për ta kryer atë punë. Kaq!... por Kuvendi vendos, natyrisht.

KRYESUESI: Faleminderit! Përfaqësues të grupeve parlamentare, zoti Qela e ka fjalën në emër të grupit.

RAIF QELA: Jo në emër të grupit, por personal.

KRYESUESI: Zoti Qela e ka fjalën, a po e tërheq fjalën. Unë po ia jap fjalën, ai s'po flet...

RAIF QELA: Të nderuar deputetë,

Meqenëse nuk po flas në emër të grupit parlamentar, por në emër personal, prandaj i thashë po deklarohej në emër personal.

Të gjithë jemi gëzuar kur Kryeministri i Kosovës është zotuar këtu para këtij Parlamenti se do ta sjellë së shpejti listën për anëtarët e Komisionit të Konkurrencës. Por, kur është sjellë ajo listë, për një pjesë të madhe të konsiderueshme tonën ajo ka qenë befasuese. Komisioni për Zhvillim Ekonomik pavarësisht se publikisht është ndarë me vota, në thelb, secili prej anëtarëve të komisionit e ka pasur vërejtjen e madhe se detyra e madhe e këtij Komisioni të Konkurrencës nuk mund të kryhet nga këta persona, të cilët janë të propozuar.

Pse po e them këtë, përderisa tregu kosovar po mbulohet prej monopolit, po e përsëris këtë, ky komision e ka një detyrë shumë të madhe që ta rregullojë këtë treg dhe për ta rregulluar këtë treg, duhet që anëtarët e komisionit të kenë përgatitje të lartë profesionale dhe të kenë integritet të fortë moral. Presioni që do ta kenë këta anëtarë të komisionit prej monopoleve do të jetë i hatashëm dhe këta persona nuk do të mund ta kryejnë atë. Jam shumë i sigurt se nuk do të mund ta kryejnë si duhet. Prandaj, është e nevojshme që kryeministri dhe Qeveria herëve të tjera të sjellin persona, të cilët do të mund ta kryejnë si duhet. Nga ana formale juridike këta i plotësojnë kushtet, por do ta shohin edhe vetë se sa do të jenë në gjendje ta kryejnë këtë detyrë.

Nuk kam asgjë personale kundër asnjërit, sepse asnjërin nuk e njoh. Porse, nuk mjafton vetëm një diplomë që ta rregullosh një treg kaq të problematizuar. Nuk mund të rregullohet tregu me persona vetëm pse kanë diploma, apo pse i plotësojnë anët formale juridike. Do të ishte dashur të jenë persona me shumë më shumë integritet moral dhe shumë më shumë kompetencë profesionale. Jo se këtyre iu mungon, sepse ata mund të kryejnë punë të tjera, por jo për këtë çështje, pavarësisht se ligji u jep të drejtë që të konkurrojnë edhe të zgjidhen. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit, zoti Qela! Nuk ka tjerë të paraqitur, nga grupet parlamentare s'do askush në emër të grupit të flasë.

Atëherë, vazhdojmë me votimin e propozim-vendimit të Qeverisë së Republikës së Kosovës për emërimin e kryetarit, zëvendëskryetarit dhe tre anëtarëve të Komisionit për Mbrojtjen e Konkurrencës si në vijim.

Valon Prestreshi, kryetar, Ahmet Krasniqi, zëvendëskryetar, Fatime Haziri, anëtare, Muhamet Krasniqi, anëtar, Shaqir Morina, anëtar. Lus regjinë dhe deputetët të përgatiten për votim. Votojmë tash!

Kanë marrë pjesë në votim 61 deputetë. Për janë 43, kundër 8, 10 kanë abstenuar. Andaj, konstatoj që Kuvendi e emëroi kryetarin, zëvendëskryetarin dhe tre anëtarët e tjerë të Komisionit për Mbrojtjen e Konkurrencës.

Kemi pauzë tani për drekë deri në orën 15:00.

* * *

Vazhdimi i mbledhjes, pas pauzës

Mbledhjen e drejton nënkryetari i Kuvendit, z. Xhavit Haliti.

KRYESUESI: Të nderuara zonja dhe zotërinj,

Po e vazhdojmë seancën, meqenëse nuk kemi akoma kuorum për të votuar, po i diskutojmë një pjesë të raporteve që janë dhe kur të kthehen të gjithë, atëherë po hyjmë në procedurë të votimit.

13. Shqyrtimi i raportit të punës së Agjencisë Kosovare të Privatizimit për vitin 2015

Komisioni Funkcional e ka shqyrtuar raportin vjetor të Agjencisë Kosovare të Privatizimit për vitin 2015 dhe Kuvendit i ka rekomanduar miratimin e tij bashkë me rekomandime. Gjithashtu, edhe Komisioni për Buxhet dhe Financa e ka shqyrtuar raportin vjetor financiar të Agjencisë Kosovare të Privatizimit për vitin 2015 dhe Kuvendit i ka rekomanduar për miratim.

Kryetari nuk është, e ka autorizuar dikë? Zonja Gaxherri e ka fjalën në emër të Komisionit Funkcional.

BESA GAXHERRI: Faleminderit, zoti kryesues!

Të nderuar kolegë deputetë,

Agjencia Kosovare e Privatizimit ka dorëzuar në Kuvend raportin vjetor financiar për vitin 2015, ashtu siç kërkohet me Ligjin për Agjencinë Kosovare të Privatizimi.

Raporti pasqyron të dhënat me buxhetin e miratuar, ndryshimet që kanë ndodhur gjatë vitit, si dhe të dhëna për shpenzimin e buxhetit sipas kategorive dhe nënkategorive ekonomike dhe krahasimet me vitin paraprak. Po ashtu, raporti përmban të dhëna për fondet në mirëbesim dhe transferin e mjeteve që u janë bërë Qeverisë apo buxhetit të Kosovës.

Buxheti i aprovuar i AKP-së për vitin 2015 ka qenë 10 211 383 euro dhe është financuar nga të hyrat e dedikuara 6 811 383 euro, si dhe nga grandit Qeveritar 3 400 000 euro. Ndërsa, me rishikim buxheti i AKP-së ka qenë 8 657 896 euro, ndërsa buxheti përfundimtar i AKP-së ishte 6 822 356 euro. Buxheti i shpenzuar është 5 970 268 euro apo 87,51%. Buxheti i shpenzuar sipas kategorive ka qenë: paga dhe mëditje 98,93%; mallra dhe shërbime 64,88%; shpenzimet komunale 86,71%. Sa u përket fondeve në mirëbesim gjatë vitit 2015 kanë qenë 486 890 000 euro.

Pasi është formuar, Bordi AKP-ja ka bërë transferimin e fondit tepriçë në Buxhetin e Qeverisë së Kosovës dhe sipas vendimit të Bordit Buxhetit i janë transferuar 61.3 milionë euro. Si detyrim ligjor i agjencisë i këtyre fondeve, pasi që vendosën ndërmarrjet janë vendosur ndërmarrjet në likuidim. Në gjendjen e llogarisë bankare në fund të vitit 2015 ka qenë 486 000 000 euro.

Komisioni për Buxhet dhe Financa, në mbledhjen e mbajtur më 17. 5. 2015, pasi që shqyrtoi raportin e Agjencisë Kosovare të Privatizimit për vitin 2015 vlerësoi se raporti përmbush obligimet ligjore për raportim, që dalin nga Ligji për Agjencinë Kosovare të Privatizimit dhe Ligjin për menaxhimin e financave publike dhe përgjegjësitë dhe i rekomandon Kuvendit për miratim të këtij raporti. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Zoti Osmani, a është këtu! S'është. Dikush tjetër në emër të Komisionit për Buxhet dhe Financa, a është i autorizuar të flasë? Jo!

Kryetarët e grupeve parlamentare, ose përfaqësuesit? Abdyl Ymeri në emër të Grupit Parlamentar të PDK-së e ka fjalën.

ABDYL YMERI: Faleminderit, nënkryetar!

Të nderuar kolegë deputetë,

Nëse rimëkëmbja e ekonomisë së shkatërruar të Kosovës është e lidhur ngushtë me fillimin e procesit të privatizimit në Kosovë, i cili është vlerësuar edhe nga ekspertë të ekonomisë si një nga detyrat më të rëndësishme për ngjalljen e kësaj ekonomie, po ashtu në fillim ka qenë një vlerësim i përgjithshëm, se nevojitet një kapital serioz për rimëkëmbjen e ekonomisë së Kosovës, i cili vështirë se do të sigurohet pa privatizimin e ndërmarrjeve ekonomike shoqërore dhe publike në Kosovë. Ndërsa, sot me të drejtë shtrohet pyetja pas gjithë këtyre viteve, cilat efekte janë arritur me këtë proces, cilat objektiva janë realizuar dhe çfarë impakti ka pasur privatizimi i ndërmarrjeve shoqërore në zhvillimin ekonomik të vendit.

Nga ajo që po shihet, nga raportet dhe ekspertizat e bëra nga profesionistë të fushës dhe ekonomisë, nuk mund të thuhet se procesi i privatizimit të deritanishëm është ndonjë storie e suksesit, përpos në raste të caktuara, sepse këtë proces e kanë përcjellë mjaftë parregullsi. Nuk ka rezultuar me gjenerim më të madh të vendeve të punës, por me shkurtim të vendeve të punës si dhe nuk ka dhënë ndonjë efekt pozitiv në zhvillimin ekonomik, të cilin të gjithë ne e kemi pritur dhe cilësuar si hap i një rëndësie të veçantë për nxitjen e zhvillimit ekonomik të vendit, që në fakt këto pritje nuk janë edhe aq inkurajuese.

Shumë ndërmarrje të privatizuara nuk janë në funksion, sepse pronarët e rinj nuk kanë bërë investime, përkundrazi shumë prej tyre u është ndërruar edhe destinimi. Nga fabrika që ishin, janë shndërruar në depo të materialeve ndërtimore apo në qendra tregtare. Mijëra hektarë të tokave të privatizuara kanë mbetur djerrinë apo janë parcelizuar. Disa ndërmarrje të privatizuara si "Ferronikeli", përkundër zhurmës së madhe që është bërë në atë kohë për mënyrën dhe formën e privatizimit, u funksionalizua dhe hyri në prodhim, u punësuan rreth njëmijë punëtorë, mirëpo sot është në gjendje jo të mirë dhe buzë falimentimit dhe nëse vazhdon kështu, atëherë me të drejtë shtrohet pyetja: Çka do të ndodhë me punëtorët e "Ferronikelit", të cilët mbajnë anëtarët e familjeve të tyre me punën që bëjnë aty.

Prandaj, edhe Qeveria dhe ky Kuvend duhet të ketë parasysh këtë dhe duhet ndërmarrë diç në vënie në funksion të këtij gjiganti. Raporti në tërësinë e tij është shumë i përgjithësuar, por nëse bëhet një krahasim me raportin e vitit 2014, është më përmbajtjesor dhe pasqyron punën e agjencisë. Meqenëse, tani kemi Bordin e ri të AKP-së, kërkoj që të përshpejtohet procesi i privatizimit dhe të përmbillet sa më shpejt që është e mundur, të jetë edhe më transparent për publikun. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Zoti Blerim Grainca, nga Grupi Parlamentar i LDK-së.

BLERIM GRAINCA: Në emrin personal, jo në emër të grupit!

Zoti kryesues,

Të nderuar kolegë deputetë,

Raporti që kemi para vetes pasqyron gjendjen aktuale dhe momentale në Agjencinë e Privatizimit. Sikur e dini, kjo agjenci për një kohë të gjatë ka ushtruar veprimtarinë e vet pa kompletimin e Bordit dhe si e tillë kjo është manifestuar edhe në punët e agjencisë praktike dhe ditore.

Gjithsesi, nëse shikojmë raportin përbrenda dhe u referohemi të dhënave, atëherë padyshim se është një raport që në parim duhet ta përkrahim dhe ta kalojmë, por vërejtjet e mia kanë të bëjnë kryesisht me trendin e punëve në këtë agjenci dhe do të ishte mirë, që edhe Kuvendi dhe institucionet tjera të punojnë më shumë për ngritjen e kapaciteteve të agjencisë, sepse nëse Agjencia e Privatizimit, atëherë AKP-ja, është themeluar në gusht të vitit 2002 dhe në bazë të trendit të privatizimit deri më tani janë shitur vetëm 43% të aseteve dhe kanë mbetur edhe 57% pa u shitur, kjo i bie që kjo agjenci nuk do të arrijë të përfundojë punën e tij, së paku edhe për 20 vjetët e ardhshme.

Në një situatë të tillë, kur edhe një numër i madh i lëndëve janë nëpër gjykata, shtrohet pyetja e koordinimit të punëve në mes agjencisë, Gjykatës Supreme dhe gjykatave themelore, sepse kemi me mijëra lëndë që janë në konteste nëpër këto gjykata dhe kjo i bie, që po ashtu do humbim edhe dhjetëra vjet të tjera për përfundimin dhe përmbylljen e procesit. Kur gjithë kësaj i shtojmë edhe deklaratimet e Qeverisë për nevojën e mbylljes së procesit të privatizimit sa më shpejt, atëherë në mënyrë imediate shtrohet nevoja për koordinimin e këtyre proceseve në mes vetë subjekteve dhe në mes vetë institucioneve vendore, në mënyrë që ky proces të përfundojë një herë e më shpejt.

Unë kam edhe disa shqetësime të tjera, që lidhen edhe me vetë procesin e privatizimit e në veçanti me spin-off-et speciale, për arsye se kemi një numër të madh të kompanive, që nuk i kanë përmbushur obligimet e veta në kuadër të spin-off-it dhe shtrohet pyetja, se a janë mbikëqyrë si duhet këto kompani gjatë procesit të privatizimit.

Është për t'u përgëzuar aktiviteti dhe angazhimi i fundit i agjencisë rreth lirimit të pronave të uzurpuara, andaj mendoj se pavarësisht gjithë këtyre, agjencia ka sjellë një raport të kompletuar dhe si i tillë duhet të votohet. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Zoti Topalli e ka fjalën.

FATON TOPALLI: Faleminderit, kryesues!

Të nderuara kolege deputete,

Të nderuar kolegë deputetë,

Derisa pasojat e veprimit të Agjencisë Kosovare të Privatizimit për shumicën e qytetarëve të Kosovës vërehen çdo ditë, jo vetëm në kuptimin e humbjes së vendeve të punës së mijëra qytetarëve, por edhe në kuptimin e mosshfrytëzimit të një pasurie të krijuar bashkërisht, Kuvendi i Kosovës ka një herë në vit këtë rast për të marrë një raport, i cili në mes rreshtash, ndoshta në mënyrë të pavetëdijshme, tregon se sa i fuqishëm është krimi në Kosovë, sa ngushtë është i lidhur me pushtetin dhe sa i madh është dëmi që pushteti ia ka shkaktuar qytetarit të Kosovës.

Raporti na sjell të dhëna për volumin e punës së AKP-së, shitjet, shpenzimet. Nuk është ndonjë problem shumë i madh volumi i punës, që ka bërë AKP, respektivisht punonjësit e saj, sepse në fund të fundit puna e tyre është e matshme. Dhe, unë besoj se në mes tyre ka shumë punëtorë të vyeshëm dhe qytetarë të ndershëm. Gjithashtu, nuk është ndonjë problem i madh, po qe se kanë shfrytëzuar pak më pak apo pak më shumë mjete për telefonata apo karburante. Problemi është krejt politika e cila është implementuar përmes AKP-së. Mbi të gjitha, janë fijet e krimit të organizuar ekonomik, të cilat AKP-ja ose i ka fshehur, ose i ka heshtur, ose është bërë bashkëpjesëmarrëse nëpërmjet vendimeve të saj.

Dhe, këtë nuk e thotë Lëvizja “Vetëvendosje”, e thotë vetë raporti vjetor i Agjencisë Kosovare të Privatizimit, e kanë thënë edhe raportet tjera të mëhershme e po e thotë edhe raporti i vitit 2015. Nëse 43% e gjithë pasurisë së Kosovës është shitur vetëm për 733 milionë euro, në kohën kur vetëm një fabrikë në rajon është shitur për 500 milionë euro, atëherë çfarë mund t’i thuhet kësaj pune ndryshe, përveçse krim ekonomik. Në Kosovë janë shitur 28 553 hektarë tokë me një çmim mesatar prej 3 471 eurosh për hektar apo 3,5 euro për m². A nuk është ky një çmim tepër i lirë në një vend, ku toka ka pasur gjithmonë çmim të lartë?

Nuk them se në mes atyre që kanë privatizuar nuk ka qytetarë të ndershëm, dhe se në mënyrë të ndershme kanë fituar e privatizuar asetet e Kosovës. Por, shumë asete janë privatizuar në mënyrë të kundërligjshme, duke falsifikuar dokumente, duke mënjanuar në mënyra të ndryshme kriminele konkurrencën, duke shantazhuar, duke kërcënuar, duke bërë marrëveshje paraprake për çmime. Dhe, të gjitha këto para syve të prokurorëve, me miratim të AKP-së dhe me dirigjim të politikës, që ka lejuar dhe stimuluar diçka të tillë.

Fakti që kemi 29 373 raste gjyqësore të pazgjidhura, tregon që në gjithë procesin e privatizimit janë bërë shumë padrejtësi. Nëse duam mund të themi edhe ndryshe, në 29 000 raste shteti ka dështuar të vejë drejtësi në vend, madje mund të themi se është treguar krejtësisht i pa interesuar dhe nuk është fjala për dhjetë raste, as për 100 raste, as për 1 000 raste, por për 29 000 raste të tilla. Një vend ku nuk ndahet drejtësia, kur për vite të tëra pësojnë qytetarët, bizneset... është vend i padrejtë dhe, ky është vendi i padrejtësisë, sepse në këtë vend sundon një qeveri e padrejtë.

Sipas AKP-së, ne kemi 2 082 ndërtime pa leje në prona të shtetit. Deri më sot janë trajtuar pjesërisht vetëm 128 raste. Unë pyes drejtuesit e AKP-së: Çfarë suksesi është ky, kur prej 2082 rasteve të ndërtimeve pa leje, keni shqyrtuar vetëm 128 prej tyre dhe atë vetëm pjesërisht? Ku është drejtësia këtu? Ku është suksesi në punë? Ku është interesi i vendit? Kush përfiton nga këto ndërtime në prona të shtetit dhe pse nuk publikon edhe listën e ndërtuesve pa leje, respektivisht uzurpatorëve të pronës publike?

Krejt në fund, diçka edhe për prezantimin e sukseseve të AKP-së. AKP-ja e quan sukses përkushtimin e personelit për tejkalimin e sfidave të paraqitura për vitin 2015. Pyetja logjike është: Përse qenka ky sukses? Do të thotë që në vjetët e kaluara personeli nuk paska qenë i përkushtuar!

Sukses quhet edhe shpërndarja e 20% të mjeteve punëtorëve të ndërmarrjeve shoqërore, por kjo shpërndarje vjen me një vonesë prej disa vjetësh dhe nuk ka përfunduar akoma si proces.

Atëherë, çfarë suksesi na qenka ky, t'i mbash paratë për vite me radhë dhe në këtë krizë të varfërisë të mos ua japësh atyre, që edhe ashtu kanë shumë pak para!? Ky është sukses!? Besoni vërtet, që ky është sukses!? Jo, ky është dështim!

AKP e quan sukses edhe trajtimin e aseteve të uzurpuara apo të shfrytëzuara pa bazë ligjore. Unë, si qytetar i Kosovës, detyrohem të pyes, pse u deshën të kalojnë 13 vjet që një institucion kompetent si AKP të trajtojë këtë çështje? Pse kjo vonesë kaq e madhe? Pse nuk i trajtuat, që nga momenti i uzurpimit? Pse bëni lista publike dhe jo padi në gjyq, kundër uzurpatorëve?

Dhe, krejt në fund, si sukses shumë i madh e i arritur dhe si e arritur e jashtëzakonshme është inkasimi gjatë vitit 2015. Po, pse ky të quhet sukses? Atëherë, çfarë suksesi paska pasur në vitin 2014, 2013, 2012? Ju nuk e thoni, por po ua them unë, ju nuk deshët të inkasoni, sepse për ju inkasonte dikush tjetër. Pra, as ky nuk është sukses për një raport, i cili tregon një histori të dështimit për dymbëdhjetë vjet me radhë, një histori të keqpërdorimit, ku politika si kurorë, AKP-ja, institucionet e drejtësisë, mbyllën sytë para merimangës së mafisë, që i ka lëshuar rrënjët në çdo pore të vendit tonë.

Ky raport nuk duhet të miratohet, sepse prezanton dështimin si sukses, sepse nuk është i plotë, sepse ka tendenca mashtrimit, sepse nuk i emëron gjërat ashtu siç janë, sepse shtrembëron realitetin dhe nuk paraqet asnjë përpjekje minimale për ta prezantuar gjendjen ashtu siç është.

KRYESUESI: Faleminderit! Fjalën e ka zoti Fatmir Rexhepi.

FATMIR REXHEPI: Faleminderit, nënkryetar!

Kolegë të nderuar deputetë,

I nderuar zëvendëskryeministër,

Lidhur me raportin vjetor të Agjencisë Kosovare të Privatizimit, në emër të komisionit dhe në mungesë të kryetarit, pra, të Komisionit për Zhvillim Ekonomik, Infrastrukturë, Tregti dhe Industri, më lejoni të paraqes vlerësimin dhe rekomandimet e këtij komisioni.

Bazuar në raportin vjetor të shqyrtuar në komision, duke u nisur nga fakti lidhur me gjithë ecurinë që e ka përcjellë këtë agjenci në vitin 2015, që nga zgjedhja e anëtarëve të rinj të Bordit, pra konsolidimi i Bordit, organizimi i Bordit, menaxhimi dhe kjo pjesë e periudhës së punës së këtij Bordi të AKP-së, rekomandimet tona janë, si në vijim:

Të miratohet raporti vjetor i Agjencisë Kosovare të Privatizimit për vitin 2015 me rekomandimet si në vijim:

1. Bordi i AKP-së të hartojë programin me masat e nevojshme dhe afatin, brenda të cilit do të rumbullakojë procesin e privatizimit, përkatësisht likuidimit dhe do të ofrojë zgjidhje më të mira, që ky proces të zhvillohet në vazhdim, në harmoni me nevojat e rritjes ekonomike dhe stabilitetin makro-ekonomik dhe social të vendit;

2. Në pajtim me normat ligjore dhe rolin e AKP-së të bëhet një auditim edhe më detaj lidhur me ecurinë në zbatimin e kontratave të privatizimeve me spin-off special;

3. Të bëhet një studim fizibiliteti lidhur me çështjet e tokave të pa privatizuara, që janë rreth 22 mijë hektarë, në mënyrë që të propozohen zgjidhjet që janë në funksion të zhvillimit të bujqësisë dhe të nxitjes së investimeve strategjike, sikur që e patëm pak më herët Ligjin për investime strategjike, pasi që ta aprovojmë;

4. Të ndërmerren masa për përsheptimin e likuidimit;

5. Ministria e Drejtësisë, Ministria e Financave, AKP-ja, Këshilli Gjyqësor dhe Gjykata Supreme të analizojë çështjet që kanë të bëjnë me kërkesat e kreditorëve, në mënyrë që të tejkalohet problemi i grumbullimit dhe kohëzgjatjeve së kërkesave; dhe e fundit

6. Ministria e Financave, AKP-ja, Banka Qendrore dhe institucionet tjera të marrin masa për përdorimin ekonomik të fondeve nga privatizimi, për ruajtjen e vlerës së tyre në dobi të investimeve për një rritje ekonomike dhe punësim më të madh në Kosovë.

Prandaj, bashkë me këto rekomandime Komisioni vlerëson, që ky raport vjetor i përgatitur nga Bordi i ri i AKP-së të aprovohet dhe kërkojmë nga deputetët që të aprovohet sot në Kuvend. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Besa Gaxherri e ka fjalën.

BESA GAXHERRI: Faleminderit, kryesues!

Të nderuar kolegë deputetë,

Ne të gjithë pranojmë dhe mendoj se mendojmë njësoj, që vërtetë jemi të dëshpëruar me punën që ka bërë kjo agjenci, që nga themelimi.

Megjithatë, ne sot po shqyrtojmë raportin e vitit 2015, i cili përkundër sfidave, përkundër mospërfitësive, është real, është i hartuar me shifra reale dhe natyrisht që ne duhet të diskutojmë brenda kësaj kornize.

Nëse, fillojmë nga shitja e aseteve gjatë vitit 2015, pra AKP nuk ka realizuar asnjë shitje të aseteve, për shkak të mungesës së Bordit të drejtorëve. Ne e dimë të gjithë, se bordi është zgjedhur këtë vit.

Nëse, lëshohemi në rezultatet e tabelave të numrit të shitjeve, kontratat e nënshkruara dhe totalit të shitjeve nga qershori 2002 - dhjetor 2015, shohim se gjithsej numri i kontratave është 1286 kontrata me shumën totale, ose me të ardhurat e përgjithshme, që janë 660 233 469 euro.

Likuidimi i ndërmarrjeve shoqërore për vitin 2015 është dëshpërues. Numri i ndërmarrjeve shoqërore të mbyllura sipas aktvendimeve të Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme të Kosovës është zero. Numri i raporteve përfundimtare të dorëzuara nga Dhoma e Posaçme për Mbylljen e Ndërmarrjeve të NSH-ve, në pritje të vendimit është zero.

Numri i raporteve të shpërndarjes përfundimtare është zero. Pra, faktikisht likuidimi i ndërmarrjeve shoqërore për këtë vit është me rezultatin zero.

Në qoftë se kalojmë te trajtimi i aseteve të uzurpuara, që ne këto ditë jemi dëshmitarë se vërtet, përkundër pakënaqësive dhe përkundër dështimeve të këtij institucioni, ne po shohim edhe zgjedhjen e re të bordit të ri që vërtet ky bord është përkushtuar dhe po domi të besojmë se vërtet edhe ky institucion po bie në binarë ligjor.

Trajtimin e aseteve të uzurpuara raporti për vitin 2015 e paraqet me 167 uzurpatorë, me gjithsej 270 prona. Dhe në qoftë se këto i ndajmë pastaj në rajone, Prishtina i ka me 23 persona fizikë uzurpatorë, ndërsa 41 persona juridikë, gjithsej 64 uzurpime.

Peja i ka 23 persona fizikë dhe 8 persona juridikë, që do të thotë janë gjithsej 34.

Prizreni me 3 persona fizikë dhe me 24 persona juridikë, gjithsej 27.

Gjilani me 3 persona fizikë dhe 27 juridikë, gjithsej 30.

Mitrovica me vëmendje i ka 78 persona fizikë dhe 37 juridikë, me gjithsej 115 që faktikisht totali i Mitrovicës është më shumë se gati të gjitha rajonet dhe komunat që i bëjmë bashkë.

Kjo na jep të kuptojmë se këtu hyn edhe pjesa veriore e Mitrovicës dhe natyrisht atje kemi probleme, të cilat duhet të fillojmë t'i zgjidhim.

Në qoftë se diskutojmë pastaj për vitin 201... deri më 21 nëntor 2014 shohim se janë inkasuar 8,9 milionë euro prej këtyre marrëveshjeve që janë bërë ndërkombëtare për pagesa të borxheve ndaj ndërmarrjeve shtetërore, ndërsa 4,4 milionë janë inkasuar nga qiradhënësit tjerë.

Pra, vetëm gjatë periudhës 13 mujore dhjetor 2014 deri në dhjetor 2015 janë inkasuar 3.45 milionë euro nga qiradhënia e aseteve apo 77% sa tërë inkasimi i qirasë, pra 4,4 milionë që është realizuar për 12 vjet.

Pastaj vlen për të diskutuar sfidat kryesore që i kanë prezantuar këta, e unë nuk po ndalem në të gjitha, por më vjen mirë që në sfidat e tyre të cilat ata i kanë parashikuar të tashme, bën pjesë kompletimi, normal, i menaxhmentit, menaxhimi i procesit të riorganizimit të agjencisë që kjo natyrisht duhet të ndodhë, rishqyrtimi i rregullativës së shitjes së aseteve në të ardhmen, "Trepça" që duhet të kryhet e mbyllet ky proces, pagesa e mjeteve të shpronësimit nga Qeveria e Republikës së Kosovës për shpronësimet e vendosura në pronat shoqërore.

Për asnjë ndërmarrje shoqërore nuk mund të mbyllet procesi i likuidimit pa u pagua fondet, pra ne e dimë këtë, dhe këtu kur e kemi diskutuar këtë raport në Komisionin e buxhetit një ndër pyetjet e mia ka qenë edhe pyetja për kompensimin e 20% të punëtorëve e që realisht neve na bën përshtypje të gjithëve pagesa e punëtorëve të Fabrikës së Tubave dhe përgjigja nga drejtori i bordit për këtë çështje ka qenë kjo, dhe po e citoj nga procesverbali:

"Për Fabrikën e Tubave, ju them të drejtën, është shumë komplekse dhe hapat që i kemi ndërmarrë deri më tash s'kemi mundur me asgjë tjetër... vetëm interpretime dhe i kemi dy apo tri interpretime ligjore.

Për këtë çështje kemi biseduar me kryeministrin dhe kryeparlamentarin dhe jemi zotuar se diku në qershor do të trajtojmë dhe marrim një vendim”.

Këtë po dua ta theksoj se vërtet ata punëtorë sigurisht e presin një përgjigje sot prej këtij debati.

Çka vlen theksuar, ndër sfidat kryesore në përmbylljen e likuidimit të ndërmarrjeve shoqërore, Agjencia ende nuk i ka shitur edhe 1 685 asete. Janë rreth 29 373 raste gjyqësore. Kjo, vërtet, është e papranueshme.

Rreth 15 000 ankesa, të posaçme të kreditorëve, që shqyrtohen në Dhomën e Posaçme të Gjykatës Supreme të Republikës së Kosovës.

Pra këto janë disa nga sfidat dhe vërtet na jep të kuptojmë se ne na duhet një angazhim shumë serioz për t’i përmbyllur këto procese që janë numerikisht të mëdha e lere më t’i shqyrtojmë.

Diçka lidhur me 20% e punëtorëve. Gjithsej janë paguar 104 245 000 euro, ndërsa për këtë vit janë të ndara edhe 25 milionë euro për t’u paguar dhe u tha më herët se nuk janë shqyrtuar ende të gjitha janë si lëndë në gjykata.

Unë me kaq po e përfundoj, për të mos i përsëritur edhe ato që i thanë kolegët, dhe megjithatë kërkoj nga deputetët që vërtet raportin ta aprovojmë për arsye se raporti i plotëson të gjitha kushtet ligjore dhe paraqet realitetin e hidhur të kësaj agjencie në Kosovë. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Nuk ka tjerë të paraqitur për diskutim.

Në sallë janë 63 deputetë. Lus regjinë dhe deputetët të përgatiten për votim. Votojmë tash!

Po e përsëris edhe një herë votimin dhe në qoftë se ka ndonjë qëndrim për të mos votuar, bile mos të lodhemi duke votuar.

Atëherë, përgatitemi për votim dhe votojmë tash dhe ju lus të votoni, e pastaj të diskutoni.

Po shihet që s’po duan të votojnë, dhe le të kthehet pas ky raport, sepse me këtë ne veten po e qesim në pozitë qesharake, s’po e qesim dikë tjetër.

Atyre që e kanë bërë raportin, kurrë s’po i bëjmë. Të gjithë i lavdëruat se janë mirë, mirë e kanë bërë raportin, e pse të mos votohet.

Atëherë, e përsëris edhe një herë.

Janë të pranishëm 68 deputetë. Votojmë tash!

Nuk miratohet raporti.

14. Shqyrtimi i raportit të punës së Zyrës së Rregullatorit për Ujësjellësin dhe Kanalizimin për vitin 2015

(Ndërhyrje)

Po s'ë di, a kemi kuorum? Mendoj që kjo shpejt kryhet, nuk ka ndonjë problem. Ta kryejmë edhe këtë pikë, e pastaj kthehemi...

Komisioni funksional e ka shqyrtuar raportin vjetor të Zyrës së Rregullatorit për Ujësjellës dhe Kanalizim për vitin 2015 dhe Kuvendit i ka rekomanduar për miratim.

Po ashtu, edhe Komisioni për Buxhet e Financa e ka shqyrtuar raportin vjetor financiar të Zyrës së Rregullatorit për Ujësjellës dhe Kanalizime për vitin 2015 dhe Kuvendit i ka rekomanduar për miratim.

Ftoj kryetarin e Komisionit Funksional që ta arsyetojë raportin. Nuk është këtu. Kush do të flasë në emër të saj?

Atëherë, e ka fjalën zonja Emilia Rexhepi!

EMILIIA REXHEPI: Hvala predsedavajući!

Parlamentarna komisija za poljoprivredu, prostorno planiranje i zaštitu životne sredine je procenila sedmogodišnji izveštaj Regularnog ureda za vodu i kanalizaciju uspešnim i konstatovala da je ovaj autoritet preko određivanja tarifa i drugih zakonskih mogućnosti treba da utiče na globalno smanjenje gubitka vode u našoj državi sa cifrom od 56% posto ali da hitno alarmira na gubitke i javno uputi kritike na račun kompanija za oduzimanje licenci za njihov nerad.

Poštovani kolege poslanici,

Komisija za poljoprivredu je preporučila Skupštini na usvajanje ovog Regularnog izveštaja za vodu i kanalizaciju. Zahvaljujem!

KRYESUESI: Faleminderit! Zoti Osmani, a është këtu? Zonjaj Gaxherri e ka fjalën në emër të Komisionit për buxhet.

BESA GAXHERRI: Faleminderit zoti kryesues!

Zyra e Rregullatorit për Ujësjellës dhe Kanalizim e ka dorëzuar në Kuvend raportin vjetor financiar për vitin 2015, sipas të dhënave të kërkuara.

Raporti pasqyron të dhënat për buxhetin e miratuar, ndryshimet që kanë ndodhur gjatë vitit si dhe të dhënat për shpenzimin e buxhetit sipas kategorive dhe nënkategorive ekonomike dhe krahasimet me vitin paraprak.

Buxheti fillestar, i ndarë për Zyrën e Rregullatorit për Ujësjellës dhe Kanalizim për vitin 2015 ka qenë 382 280 000 euro, ndërkaq buxheti përfundimtar i kësaj zyre ishte 312 083 euro.

Duke përfshirë ndryshimet që kanë ndodhur për rishikimin e buxhetit, dhe shkurtimeve sipas vendimit të Qeverisë, nga kjo shumë janë shpenzuar 292 533 euro, apo 93,73%.

Buxheti i shpenzuar sipas kategorive ekonomike ka qenë: Paga dhe mëditje, 98,18%; mallra dhe shërbime 88,23% dhe shpenzimet komunale 75,22%.

Komisioni për Buxhet dhe Financa, në mbledhjen e mbajtur më 17. 5. 2016, pasi e shqyrtoi raportin vjetor financiar të Zyrës së Rregullatorit për Ujësjellës dhe Kanalizim për vitin 2015, vlerësoi se raporti i përmbush obligimet ligjore për raportim që dalin nga Ligji për menaxhimin e financave publike dhe përgjegjësitë, dhe i rekomandon Kuvendit për miratim. Faleminderit!

KRYESUESI: Përfaqësuesit e grupeve parlamentare e kanë radhën. Në emër të Grupit Parlamentar të PDK-së, Emilija Rexhepi e ka fjalën.

EMILIJIA REXHEPI: Faleminderit, kryesues!

Deputetët e PDK-së e kanë shqyrtuar dhe konsiderojnë që ky raport është pozitiv dhe do ta votojnë për të gjatë miratimit sot.

KRYESUESI: Zoti Adem Salihaj e ka fjalën, në emër të LDK-së.

ADEM SALIHAI: Faleminderit!

Edhe Grupi Parlamentar i LDK-së e ka shqyrtuar raportin e ZRRUK-së dhe ka nxjerr përfundimin se do ta përkrahë këtë raport. Megjithatë, meqë jemi në shqyrtim të tij, unë do t'i them disa fjalë lidhur me të.

Raporti përfshin shërbimet e furnizimit me ujë dhe kanalizimit, për të gjitha kompanitë e ujit dhe kanalizimit në Kosovë dhe ka ofruar shifra dhe statistika të nevojshme se sa realizohet kjo.

Ka probleme serioze. Ndoshta institucionet shtetërore të Kosovës nuk u kushtojnë rëndësinë e duhur por duhet të themi këtu se ka probleme serioze të furnizimit me ujë në qytete të ndryshme të Kosovës dhe kjo nuk është pasojë aq shumë e faktit që nuk kemi resurse të mjaftueshme të ujit por më tepër është pasojë e faktit se kemi humbje të mëdha të sasive të ujit në sistemin e ujësjellësit. Po e zëmë, Prishtina furnizohet me 100%, Gjakova 100%, por Gjilani vetëm 68%, Prizreni 67% dhe Mitrovica vetëm 65% furnizohet me ujë.

Me shërbime të kanalizimit qëndrojnë më mirë Prishtina e Ferizaj, diku me mbi 80%, por Gjilani e Peja qëndrojnë shumë keq, Gjilani me vetëm 51%, kurse Peja vetëm 38% ofron shërbime të kanalizimit.

Pastaj kemi probleme me humbje të ujit. Po e zëmë në Gjakovë, uji i pa faturuar ose i humbur arrin shifrën 48%, në Prishtinë 51% kurse në Pejë 66%. Pra, 66% e ujit në Pejë humbet ose keqpërdoret, pra nuk faturohet fare.

Edhe te arkëtimi kemi probleme të ngjashme. Po e zëmë Gjakova arrin një shifër 83%, përderisa Mitrovica vetëm 56%.

Ne e kemi shqyrtuar në Komision këtë problem dhe Zyra e Rregullatorit të Ujit i ka duart e lidhura dhe s'mund të ndërmarrë asgjë ndaj kompanive të ujit për shkak se ato kanë monopol në furnizimin me ujë. Pra, janë vetëm nga një kompani në çdo komunë që merret me furnizimin e qytetarëve me ujë dhe nëse u hiqet licenca, atëherë vetë qytetarët mbeten pa ujë.

Po ashtu dëshiroj ta shtroj një çështje që është diskutuar edhe në Komision, për rastet sociale, pra te familjet me raste sociale. Është mirë që Qeveria ta gjejë një zgjidhje sikur që e ka gjet me çështjen e pagesës së rrymës për familje të varfra. Pra uji është më i domosdoshëm se rryma dhe është mirë që Qeveria ta gjejë një mënyrë që familjeve që janë në gjendje të keqe sociale t'u paguajë faturat e ujit, përndryshe ato do të kenë tepër vështirë të furnizohen me ujë.

Këto ishin disa nga vërejtjet tona dhe në parim Grupi Parlamentar i LDK-së do ta votojë këtë raport. Faleminderit!

KRYESUESI: Është e vërtet që uji është i domosdoshëm dhe duhet pasur kujdes. Mirëpo, së pari, unë mendoj që Qeveria duhet të ketë parasysh se e gjithë Kosova duhet mbuluar me fabrika që e përpunojnë ujin. Kemi më shumë se gjysmën e Kosovës që pi ujë të natyrës, ashtu siç del i papërpunuar e i papastruar, i pa degelçerizuar, kështu të them, dhe ne duhet marrë masa për të sanuar këtë dukuri dhe unë besoj që nuk duhet paguar me të njëjtin çmim sikur ai që pi ujë me rënie të lirë, sikur ai që pi ujë të përpunuar dhe të pastruar përmes fabrikave që janë të ndërtuara në Kosovë.

Atëherë, meqë nuk ka tjerë të paraqitur, e votojmë raportin. Votojmë tash!

As ky raport nuk kalon.

Tash i kemi dy njoftime, të cilat janë të miratueshme dhe s'kemi përse të ndërhyjmë.

15. Propozimi i GP të Listës serbe për zëvendësimin e anëtarit në Komisionin për Mbikëqyrjen e Agjencisë së Kosovës për Inteligjencë

Grupi Parlamentar i Listës serbe ka propozuar zëvendësim në Komisionin parlamentar, si në vijim:

1. Deputeti Adem Hoxha propozohet anëtar i Komisionit Parlamentar për Mbikëqyrjen e Agjencisë Kosovare për Inteligjencë, në vend të deputetit Nenad Rashiq.

- Propozimi i GP të Lëvizjes “Vetëvendosje” për zëvendësimin e anëtarëve në komisionet parlamentare

Dhe, në pajtim me Rregulloren e Kuvendit, neni 53 pikë 2, Grupi Parlamentar i Lëvizjes “Vetëvendosje” e ka marrë këtë vendim:

1. Në Komisionin për Mbikëqyrjen e Financave Publike e ka propozuar deputetin Faton Topalli.

2. Në Komisionin për Zhvillim Ekonomik, deputeti Visar Ymeri dorëhiqet dhe në pozicionin e tij të zëvendëskryetarit të parë propozohet deputeti Glauk Konjufca.

3. Në Komisionin për Punë të Jashtme, deputeti Glauk Konjufca dorëhiqet dhe për pozicionin e tij propozohet zonja Puhije Demaku.

4. Në Komisionin për Integritet Evropian propozohet zonja Donika Kadaj-Bujupi.

5. Në Komisionin për Buxhet e Financa është e propozuar zonja Shqipe Pantina.

Pra, me një votim formal të deklarohejmë.

Konstatoj se është miratuar.

Tani, i kemi edhe dy pika të rendit të ditës, për të cilat mendova se do të ketë kuorum të mjaftueshëm për t'i votuar.

A doni të shkojmë për votim. Atëherë, propozoni dikush zyrtarisht nga grupet parlamentare. Zoti Grabovci e ka fjalën.

ADEM GRABOVCI: Faleminderit kryesues!

Mendoj që, duke i pasur parasysh rrethanat e krijuara, është e arsyeshme t'i lëmë për seancën e radhës këto dy pika të rendit të ditës.

KRYESUESI: Atëherë, në seancën tjetër i futim këto dy pika.

Prandaj, konstatoj se kjo seancë ka përfunduar dhe mirupafshim në seancën e ardhshme!

*E përgatiti:
Njësia për Transkriptim dhe Lekturë*